

Nëntor 2020
Numri: 152
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



RRUGA DHE UDHËTARËT




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Gjëja më kryesore është “Siratu’l-Mustekim”, që do të thotë “Rruga e Drejtë”. Allahu Teala e ka mësuar njeriun që ta kërkojë këtë. “Rruga” është njëra prej koncepteve kryesore të urtësisë islame. Të gjithë shprehin ecjen dhe vendosin rrugën kryesore, në mënyrë që kjo ecje të kryhet sipas fesë së drejtë.

Nën dritën e kësaj urtësie është thënë: “Rrugë është ajo që të shpie në vendin e duhur.” Gjithashtu është edhe fjala meshreb që do të thotë burim në të cilin pihet ujë. Edhe ai patjetër duhet të jetë i kulluar dhe i pastër. Së fundi njeriu fillon të ecë që pasi të lindë. Ndërsa stacioni i fundit sigurisht që është dera e përhershmerisë. Sipas Islamit sprova e njeriut në këtë botë mblidhet në pikën se si e ka kryer këtë ecje dhe se çfarë ka në defterin e llogarisë.

Njeriu këtë ecje nuk mund ta kryejë i vetëm. Apo të qenët i vetëm është gjendje e veçantë. Njeriu jeton në mënyrë sociale dhe si rrjedhojë edhe udhëtimi drejt përhershmerisë do të ndodhë sipas marrëdhënieve që ka formuar me të tjerët. Ai do të fillojë nga familja në të cilën ka lindur pa pasur mundësinë për të zgjedhur që të lindte në një shoqëri myslimane. Të gjitha marrëdhëniet tregtare, politike, kulturore dhe fetare do të ndikojnë në natyrën e këtij udhëtimi. Asnjë fushë nuk është boshe. Bëhet fjalë për një fushë që quhet inziva (të jetuarit i vetëm duke iu përkushtuar adhurimit dhe duke u larguar nga mëkatet), por kjo është gjendje e veçantë në shoqërinë myslimane.

Njeriu i sinqertë i vendos në funksion mekanizmat e mirëkuptimit dhe mund t’i neglizhojë qëndrimet si qortimi apo largimi për një kohë të gjatë duke menduar: “Ky njeri nuk e shkatërron ahiretin e tij...”, kur i sheh veprimet e njeriut që ka përpara, të cilat dalin në mënyrë të pakuptueshme jashtë kornizës së rregullave. Ky qëndrim nuk bën asgjë tjetër përveçse u zgjat jetën shumë strukturave të devijuara dhe u jep kurajë njerëzve të këqij.

Asnjë marrëdhënie në kontekstin Islam nuk mund të vazhdohet duke e dhënë mendjen me qira apo duke u magjepsur. Nijeti, i cili është esenca e të gjitha ibadeteve, është gjendja më aktive e ndjeshmerisë. Ecja për vite të tëra në një rrugë dhe në fund prishja duke parë falimentimin e personit në krye, është njëri prej shkatërtimeve kryesore të shoqërive tona. Ne nuk duhet të hyjmë në një rrugë pa e besuar në mënyrë absolute se ajo të çon te Zoti (xh.xh.). Haku i rrugës është besimi se në çdo fazë të kësaj rruge i jepet përparësi kënaqësisë së Zotit. Abdulkadir Gejlani thotë: “Njeriu më i keq është ai që fiton diçka nga kjo botë duke shitur fenë.”

Përmbajtja



Kushti i boshtit
Nuredin Jëlldëz

14




12

Të jesh prej të paktëve
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan



Umeti më i mirë
Doç. dr. Harun Emysh

20



8

34

Lumturia Familjare
Osman Nuri Topbash



5 Udhët dhe udhëtarët
Ahmet Tashgetiren

8 Hixhreti si distancim nga e keqja dhe
udhëtim drejt të mirës
Ali Riza Temel

10 Shenjat e dashurisë ndaj Allahut
Xhafer Durmush


16 Një vendosmëri e tillë
Adem Saraç

18 Gjithmonë Elhamdulillah
Doç. dr. Mustafa Khanllë

23 Sprova dhe vuajtja
Ali Byjyçapar

24 Dy fjalë që i do Allahut
Irfan Erturk

26 Islami është çlirimi i zemrave
M. Ali Eshmeli



40


Një Ajet - Një Hadith 32

Mëshira, flladi hyjnor 40
Idris Arpat

Me zemër të pastër
dhe faqe të bardhë
Nurten Selma Çevikollu

"Flamuri i Arbërit" 53
i Jeronim De Radës
Gëzim Puka | Gjovalin Çuni

44



Përse jemi krijuar?
Doç. dr. Mustafa Karabaxhak

Si duhet të reagojmë ndaj provokimeve?
Naim Drijaj

56



Udhët dhe udhëtarët

— Ahmet Tashgetiren —

Gjëja më kryesore është “Siratu’l-Mustekim”, që do të thotë “Ruga e Drejtë”. Allahu Teala e ka mësuar njeriun që ta kërkojë këtë. “Ruga” është njëra prej koncepteve kryesore të urtësisë islame. Të gjithë shprehin ecjen dhe vendosin rrugën kryesore, në mënyrë që kjo ecje të kryhet sipas fesë së drejtë.

Nën dritën e kësaj urtësie është thënë: “Rrugë është ajo që të shpie në vendin e duhur.” Gjithashtu është edhe fjala meshreb që do të thotë burim në të cilin pihet ujë. Edhe ai patjetër duhet të jetë i kulluar dhe i pastër. Së fundi njeriu fillon të ecë që pasi të lindë. Ndërsa stacioni i fundit sigurisht që është dera e përhershmerisë. Sipas Islamit sprova e njeriut në këtë botë mblidhet në pikën se si e ka kryer këtë ecje dhe se çfarë ka në defterin e llogarisë.

Njeriu këtë ecje nuk mund ta kryejë i vetëm. Apo të qenët i vetëm është gjendje e veçantë. Njeriu jeton në mënyrë sociale dhe si rrjedhojë edhe udhëtimi drejt përhershmerisë do të ndodhë sipas marrëdhënieve që ka formuar me të tjerët. Ai do të fillojë nga familja në të cilën ka lindur pa pasur mundësinë për të zgjedhur që të lindte në një shoqëri myslimane. Të gjitha marrëdhëniet tregtare, politike, kulturore dhe fetare do të ndikojnë në natyrën e këtij udhëtimi. Asnjë fushë nuk është boshe. Bëhet fjalë për një fushë që quhet inziva (të jetuarit i vetëm duke iu përkushtuar adhurimit dhe duke u larguar nga mëkatet), por kjo është gjendje e veçantë në shoqërinë myslimane.

Duhet ta themi edhe këtë se, të jesh shoqëri do të thotë që institucionet, organizatat, strukturat apo instancat e tjera çfarëdo që të quhen, të bashkohen në mënyrë të hapur apo të fshehtë. Për shembull, organizatës në përgjithësi i është dhënë një kuptim negativ në disa shoqëri pikërisht si në shoqërinë tonë ngaqë përmendet në lidhje me krimin. Fjala “organizatë” në vetvete nuk shpreh ndonjë strukturim të keq, por ajo është e mirë apo e keqe sipas cilësimit që i bën shoqëria në të cilën formohet.

Në të njëjtën mënyrë, edhe pse ndjejmë afrimet me fjalët “xhemat” dhe “tarikat” nga aspekti kulturor, ato nuk janë të mira kur përdoren vetëm. Edhe këto struktura janë të mira apo të këqija sipas qëllimeve të tyre, sipas metodave që kanë për t’i arritur ato qëllime dhe sipas normave që kanë vendosur përgjatë udhëtimit për të cilin po flasim.

Le ta themi edhe këtë: Edhe konceptet “i/e mirë” dhe “i/e keq” që i vendosim ne sipas nevojës sonë, janë të tilla nëse i vendosim në bazë të rregullave të Islamit. Përndryshe çdo strukturë formon të mirën dhe të keqen e saj dhe përparon. Gjithashtu mund të arrijë edhe një influencë të caktuar.

Në këtë pikë desha të nënvizoj (theksoj) katër-pesë çështje të rëndësishme:

Një: Xhemat, tarikat apo organizatë ka në çdo shoqëri.

Dy: Këto janë të mira apo të këqija (sipas detyrës që ushtrojnë).

Tre: Kjo ka të bëjë me faktin se si konceptohet e mira dhe e keqja.

Katër: Ngaqë ne e shohim këtë brenda shoqërisë islame, kusht për ne është se çfarë thotë Islami për këto lloj strukturash.

Pesë: Rregullat kryesore të Islamit si për individët ashtu edhe për strukturat që formojnë individët janë të caktuara nga Kurani e Suneti si dhe nga krahasimet që nxirren prej tyre. Të mendosh një shoqëri pa xhemat, pa tarikat apo pa ndonjë organizatë është në mospërputhje të plotë me realitetin e jetës.

Këtë mund të dëshirojë ta bëjë një fuqi e shndërruar në përbindësh e cila kërkon ta shkatërrojë shoqërinë dhe ta formojë përsëri. Sidoqoftë edhe kjo është një fuqi me organizata. Emrin mund ta ketë shtet apo diçka tjetër, por edhe kjo fuqi e riformon shoqërinë pas një kohe sipas kriterëve të saj. Turqia e ka dëshmuar një praktikë të tillë. Bashkimi Sovjetik pas reformës komuniste është përpjekur për ta zbatuar një praktikë të tillë. Fuqitë kolonialiste në vendet islame të cilat u futën në statusin e kolonisë si Algjeria, e kanë aplikuar këtë metodë për ta shkatërruar sistemin e shoqërisë islame që gjendej aty. Ndërsa myslimanët kanë dhënë përpjekje të jashtëzakonshme qoftë në Bashkimin Sovjetik apo qoftë edhe në vendet islame që ishin futur në statusin e kolonisë, për t'i mbajtur aktive organizatat e tyre.

Çdo formim njerëzor dhe çdo organizatë nuk është e thënë të jetë në të drejtë apo në të gabuarën qoftë në vende ku është i ndaluar formimi i këtyre bashkimeve, qoftë në vende ku është i lejuar. Nganjëherë struktura që gjyqtari e shikon si organizatë kriminale, nga aspekti i këndvështrim Islam mund të jetë e lejuar. Nganjëherë tjetër ndodh krejt e kundërta: Organizata që gjyqtari e mbron, e ruan dhe mbi të gjitha i jep edhe natyre fetare, nga aspekti Islam mund të jetë një organizatë që përbën kërcënim.

Përveç të tjerash, bëhet fjalë edhe për vende ku është i lirë bashkimi (organizimi) në emër të Islamit. Domethënë, atij që i mbushet mendja mund të tentojë për të hapur një epokë të re në emër të Islamit dhe të mbledhë njerëz përreth vetes. Me kalimin e kohës kjo mund të bëhet një akumulim fuqie humano-materiale që arrin përmasa madhështore. Madje strukturat e tilla mund të arrijnë deri në atë nivel sa që mund të përfaqësojnë myslimanët, madje edhe Islamin për masat e gjera që nuk e mësojnë dot Islamin nga burimet bazë të tij.

Emri i kësaj strukture mund të jetë tarikat, xhemat, organizatë, etj.

Për çdo mysliman është e natyrshme që ta praktikojë Islamin, të ndjejë kënaqësinë shpirtërore të praktikimit të tij dhe të përpiqet ta mbartë atë te

njerëzit e tjerë. Në fakt kjo është një detyrë. Gjithashtu është edhe entuziazëm dhe pasion në vartësi të perceptimit të saj.

Edhe për të tjerët është krejt e natyrshme që me kalimin e kohës të prezantohen me këtë entuziazëm, emocion dhe vetëdije të detyrës.

Kështu lind tarikati, xhemati apo organizata që do të thotë një bashkim i madh apo i vogël njerëzish. Sigurisht që secili ka mënyrën e vet të funksionuarit. Ndërkohë mund të themi se te secila prej këtyre strukturave kanë një njeri në qendër. Ai mund të quhet lider, murshid, sheh apo mund të ketë edhe ndonjë emërtim tjetër. E rëndësishme është që në qendër gjendet një njeri që e drejton punën. Rreth e rrotull këtij njeriu është e pamundur të mos formohen gradat dhe nivelet. Këto janë gjëra të domosdoshme të këtyre lloj organizimesh. Të njëjtën gjë mund ta themi edhe për një kompani. Madje mund të themi edhe këtë: Edhe ata që e kanë nisur rrugën duke thënë se nuk do të bëheshin xhemat, tarikat, organizatë, etj., pas një kohe të shkurtër janë bërë organizatë, pastaj xhemat dhe pastaj janë shndërruar në tarikat në sajë të lidërshpit dhe strukturave të tyre më të poshtme.

Tarikatet në parim shfaqin përpikëri për t'u lidhur me një zinxhir, për ta lidhur atë zinxhir me Pejgamberin, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, dhe transferimi i mëvonshëm të realizohet me ixhazet (autorizim). Kjo është përpikëria për të mos e humbur rrymën kryesore edhe pse në çdo transferim personi që transferohet ka metodën e vet të të punuarit.

Problemet që dalin në pah këtu janë këto:

Një: A funksionon me rigorozitet gjithmonë rregulli i këtij autorizimi?

Dy: Njeriu që e merr detyrën përsipër me autorizim, a mund ta kryejë këtë detyrë në mënyrë të shëndetshme përgjatë gjithë kohës edhe nëse autorizimi vlerësohet si një dokument për aftësinë e tij?

Tre: A mund ta kenë të njëjtën përpikëri ndaj strukturës edhe njerëzit me të cilët punon ky njeri të cilin mund ta quajmë personi në qendër ngaqë struktura rritet në mënyrë absolute për shkak të zgjerimit të fushave shoqërore? A mund ta kenë të njëjtën përpikëri edhe në administrimin e punëve të strukturës?

Katër: Çdo tarikat përbëhet nga njeriu në qendër, ndihmësit dhe vartësit. Besnikëria është baza e punës, sepse tarikatet janë vatrat e edukimit të personalitetit. Njerëzit shkojnë atje në mënyrë vullnetare dhe dëshirojnë që të gjenden aty. Për këtë arsye quhen muridë. Murid do të thotë njeri i cili zgjedh duke përdorur mendjen, që preferon dhe që e hedh hapin pasi të formojë bindjen e tillë: "Këtu është një vend në të cilin besimi im do të thellohet edhe më shumë dhe do të arrijë nivelin prej të cilit Allahu është i kënaqur." Tarikati nuk është një rrugë në të cilën hyhet me shtytje, imponim dhe në mënyrë të verbër. Pyetja është kjo: Muridi pasi të hyjë një herë në tarikat, e



lëshon (dorëzon) veten. Apo thënë me një shprehje më klasike, bëhet si i vdekuri në duart e atij që e lan. Në këtë mënyrë pret që t'i piquet personaliteti. Meqë tarikat do të thotë rrugë, muridi në çdo moment dhe fazë të këtij udhëtimi e përdor mendjen dhe vetëdijen. Ai është i vetëdijshëm për pikën që arrin përgjatë udhëimit. Ai është i vetëdijshëm për pozitën që ka kundrejt Zotit (xh.xh.)... Apo ai e bën këtë udhëtim si një ecje drejt mirazhit?

Të menduarit rreth kësaj pyetjeje është i vështirë, sepse edukimi i besnikërisë dhe nënshtrimit mund ta bëjë muridin më të shpejtë dhe të qëndrueshëm. Prandaj nëpër tarikate i jepet përparësi nënshtrimit, po, të qenët si i vdekuri në duart e larësit. Mund të mendohet se “mendja” e pengon atë për ta dorëzuar veten ngaqë ndoshta i jep një kujdes llogarikërkues, sepse pas një pike të caktuar bëhet fjalë për një rrezik që cilësohet si “dhënia e mendjes me qira”. Të ecurit në këtë rrugë duke e lënë jashtë funksioni vetëdijen, është bërë shkak për daljen në pah të shtjellimit pikërisht të kësaj teme.

Le të mendojmë kështu: Një burrë i lig në pozitën e shehut, xhematit apo liderit të organizatës. Ai merr një iniciativë, e ngre zërin dhe i fton njerëzit. Le të themi se në shoqëri ka njerëz që kërkojnë rrugë. Një pjesë shfaqin interes ndaj këtij zëri dhe lidhen pas tij. Këta bëhen ftuesit e kësaj strukture. Dihet qartazi se brenda strukturave të tilla formohen dallime në sajë të solidarizimit dhe me kalimin e kohës bëhen vatrë interesi. Pasojat që mund të lindin nga nënshtrimi brenda një strukture të tillë nganjëherë arrijnë deri në nivelin e katastrofës. Kur bëhet fjalë për ndonjë gjendje kriminale, atëherë me situatën sigurisht që interesohen instancat e sigurisë së shtetit. Por përtej kësaj, edhe nëse nuk bëhet fjalë për një situatë që përbën problem për instancat e sigurisë së shtetit, kolapsi emocional, lëkundja e besimit dhe vështirimet negative të njerëzve jashtë kundrejt strukturave që formohen rreth boshitit Islam dhe kundrejt myslimanëve, nxjerrin në pah një problem më vete.

Për shekuj me radhë bëhet fjalë për një varrezë të madhe që ka shkaktuar kolapse emocionale të tilla në botën islame.

Kjo nuk është zgjidhje: “Njerëzit të mos i besojnë askujt dhe ta zbatojnë Islamin vetë.”

Njerëzit u drejtohen këtyre rrugëve ngaqë kanë nevojë për diçka të tillë. Ky nuk është një gabim i masave që vjen prej shekujsh.

Kjo është gabim: “Të gjitha strukturat pas një kohe janë të predispozuar për t'u prishur.”

Cila është e drejta?

Njeriu të cilit i është bindur zemra se gjendet në rrugën e drejtë pasi i ka bërë të gjitha sitat, duhet të hyjë në një rrugë ku mund ta mbrujë personalitetin, por mendjen dhe logjikën nuk duhet ta lërë te dera. Ai duhet t'i mësojë rregullat kryesore të Islamit (kriteret e sheriatit, bazat e besimit, marrëdhëniet me Zotin, tevhidin, udhëzimin e të Dërguarit të Allahut, jurisprudencën islame) dhe duhet të bëjë kujdes në këtë çështje. Metoda e bindjes së vetvetes që hyn në funksion më së shumti përgjatë këtij procesi, nuk duhet të arrijë deri në atë nivel sa t'i lërë jashtë funksioni rregullat kryesore. Dhënia përparësi kënaqësisë së Allahut duhet të mbahet mbi çdo gjë. Shehlerët dhe murshidët e singertë në situata të tilla e konsiderojnë ndjeshmërinë e njerëzve besnikë jo si një çështje nënshtrimi, por si një domosdoshmëri e besnikërisë ndaj kësaj rruge. Kjo vetëdije aktive është e rëndësishme: Udhëtimi është për në botën e përhershme dhe atje të gjithë do të japin llogari të vetëm në audiencën e Zotit. Domethënë, edhe shehu, edhe muridi do të jenë në statusin e “robit”. Askush nuk do ta marrë përsipër barrën e dikujt tjetër. Kush mund ta dijë se çfarë do të ndodhë atje? Andaj të gjithë duhet të shohin se “çfarë kanë dërguar për të nesërmen” dhe se çfarë kanë shkruar në librin e veprave të tyre.

Njeriu i singertë i vendos në funksion mekanizmat e mirëkuptimit dhe mund t'i neglizhojë qëndrimet si qortimi apo largimi për një kohë të gjatë duke menduar: “Ky njeri nuk e shkatërron ahiretin e tij...”, kur i sheh veprimet e njeriut që ka përpara, të cilat dalin në mënyrë të pakuptueshme jashtë kornizës së rregullave. Ky qëndrim nuk bën asgjë tjetër përveçse u zgjat jetën shumë strukturave të devijuara dhe u jep kurajë njerëzve të këqij.

Asnjë marrëdhënie në kontekstin Islam nuk mund të vazhdohet duke e dhënë mendjen me qira apo duke u magjepsur. Nijeti, i cili është esenca e të gjitha ibadeteve, është gjendja më aktive e ndjeshmërisë. Ecja për vite të tëra në një rrugë dhe në fund prishja duke parë falimentimin e personit në krye, është njëri prej shkatërrimeve kryesore të shoqërive tona. Ne nuk duhet të hyjmë në një rrugë pa e besuar në mënyrë absolute se ajo të çon te Zoti (xh.xh.). Haku i rrugës është besimi se në çdo fazë të kësaj rruge i jepet përparësi kënaqësisë së Zotit. Abdulkadir Gejlani thotë: “Njeriu më i keq është ai që fiton diçka nga kjo botë duke shitur fenë.”

Fjala e fundit: Të mos i bëjmë zullum as vetes, as fesë duke bërë allishverish nga dyqanet e këtyre njerëzve të këqij...

Hixhreti si distancim nga e keqja dhe udhëtim drejt të mirës

— Ali Riza Temel —

Kuptimi leksikor i fjalës hixhret është të lësh dhe të largohesh. Në përgjithësi kjo fjalë shpreh emigrimin nga një vend jomysliman në një vend mysliman. Ndërsa në veçanti shpreh emigrimin e Pejgamberit dhe sahabëve të tij nga Meka në Medine. Ai që bën hixhret quhet muhaxhir.

Hixhreti është shenja më e qartë e besimit. Nga një aspekt ai konsiderohet si xhihadi. Besimi, hixhreti dhe xhihadi në pesë vende të Kuranit Fisnik janë përmendur njëri pas tjetrit. (Shik. Bekare, 118; Enfal, 72, 74, 75; Teube, 20.) Muhaxhirët dhe ensarët të cilët i mirëpritën ata, kanë një pozitë të veçantë dhe të rëndësishme te Allahu (xh.xh.). Zoti i Lartësuar shprehet siç vijon në lidhje me këtë çështje: ***“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!”*** (Teube, 100)

Myslimanë, të cilët nuk u rezistuan dot më shumë torturave të politeistëve të Mekës, iu dha leja për të bërë hixhret në Abisini, në mënyrë që ta zbatonin më lehtësisht fenë e tyre. Numri i të parëve që bënë hixhret atje ishte pesëmbëdhjetë. Në karvanin e dytë të hixhretit gjendeshin mbi shtatëdhjetë burra e gra. Myslimanët në Abisini u mirëpritën. Nexhashi i cili i ndihmoi ata, më vonë u bë mysliman. I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ia ka falur namazin e xhenazës në mungesë.

Pasi kushtet në Mekë u rënduan edhe më shumë dhe u

bënë të papërballueshme, doli leja për hixhretin në Medinetu'l-Munevvera. Falë besatimeve të Akabesë dhe mësuesve që u dërguan nga Pejgamberi (a.s.), Medina ishte shndërruar në një mjedis Islam. Në vitin 622 (e.s.) kur edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), bëri hixhret, në Medine kaluan realisht predikimi, xhihadi dhe institucionalizimi. Veçanërisht me fuqinë që u formua pas marrëveshjes së Hudejbijes, u çlirua Meka. Ndërkohë që hixhreti nga Meka në Medine më parë ishte farz për ata që kishin mundësi. Pas çlirimit (të Mekës) u hoq ky obligim.

Nëse në një vend gjenden kushtet e Mekës para kohës së hixhretit, ata që kanë mundësi e kanë farz të bëjnë hixhret në vende të tjera, në mënyrë që ta zbatojnë më lehtë fenë e tyre. Arsyetimet që janë bërë nga ata të cilët nuk e përballonin dot mallëngjimin përveç atyre që nuk kishin rrugëzgjidhje, nuk u pranuan nga engjëjt dhe janë qortuar në formën: ***“...A nuk qe Toka e Allahut e gjerë që të mërgonit në të?..”*** (Nisa, 97) Mbi të gjitha, atyre që bëjnë hixhret u është premtuar falje dhe rrësk i madh: ***“Kush mërgon për çështjen e Allahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në tokë. Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t'i vijë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë. Se Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”*** (Nisa, 100)

Siç thuhet në tefsirin e Kurtubiut (5/349-351), emigrimi nga një vend në një vend tjetër bëhet për dy arsye. E para: Për t'u larguar nga e keqja dhe rreziku. E dyta: Për të zbatuar fenë apo për të arritur ndonjë fitim të kësaj bote. Hixhreti në kuptimin e parë është gjashtë pjesë:

1. Emigrimi nga Daru'l-harb (vend i luftës) në Daru'l-Islam (vendin e Islamit apo paqes): Hixhreti i këtij lloji ishte obligim në periudhën e Pejgamberit derisa u çlirua Meka. Heqja e obligimit pas çlirimit të Mekës kishte lidhje me hixhretin që bëhej me qëllimin për të shkuar te i Dërguari i Allahut (a.s.). Nëse në një vend ekzistojnë kushtet e Daru'l-harbit, ky obligim vazhdon të jetë i vlefshëm deri në kiamet.

2. Emigrimi nga vendi ku bëhen bidate: Ibn Kasi-
mi është shprehur se Imam Maliku ka thënë: “Njeriu nuk e ka hallall të qëndrojë në një vend ku ofendo-

hen selefët (të parët tanë).” Edhe Ibn Arabiu e ka mbështetur këtë mendim dhe ka thënë: “Nëse nuk mund ta ndalosh të keqen në një vend, largohu prej aty.” – dhe si argument ka dhënë këtë ajet: **“Kur t’i shohësh ata të nënçmojnë shpalljet Tona, largohu prej tyre, derisa të kalojnë në bisedë tjetër! E, nëse djalli të bën të harrosh, sapo të përmendesh, mos rri me keqbërësit!”** (En’am, 68)

3. Emigrimi nga shoqëria në të cilën sundojnë haramet: Sepse fitimi hallall është farz për çdo mysliman.

4. Emigrimi për shkak të torturave: Allahu ka dhënë leje për një emigrim të tillë. Nëse dikush frikësohet në mos do t’i bëjnë tortura, Zoti i ka dhënë leje të ikë, në mënyrë që të shpëtojë nga ky rrezik. Njeriu i parë që ka vepruar kështu është Ibrahim (a.s.). Kur ai u frikësua nga padrejtësia e popullit të tij, tha: **“...Unë po shkoj te vendi që më ka urdhëruar Zoti im. Ai do të më udhëzojë.”** (Saffat, 99) Zoti na njofton kështu për Musain (a.s.): **“Musai doli prej qytetit i frikësuar, duke pritur se ç’do të ndodhte dhe tha: “O Zoti im, më shpëto prej popullit keqbërës!”** (Kasas, 21)

5. Emigrimi prej frikës së sëmundjes: Emigrimit nga një vend i pashëndetshëm për në një vend të shëndetshëm i është dhënë leje, sepse i Dërguari i Allahut (a.s.), u ka dhënë leje për të emigruar në vende më të përshtatshme derisa të shëroheshin plotësisht çobanëve të cilëve nuk u bëri mirë për shëndetin Medina. Ndërkohë nuk është dhënë leje për të hyrë në një vend me murtajë apo të për dalë jashtë atij vendi me murtajë, në mënyrë që të mos përhapet sëmundja. Kjo dalje është e papëlqyeshme.

6. Emigrimi prej frikës në mos dëmtohen pasuria dhe familja: Siguria e pasurisë për myslimanin është si siguria për jetën. Ndërsa siguria për familjen është më primare.

Ndërsa hixhreti në kuptimin e dytë bëhet për dy qëllime: 1- Qëllim fetar dhe 2 – Qëllim për interesat e kësaj bote. Hixhreti që bëhet me qëllim fetar është nëntë pjesë.

1- Udhëtimi për të nxënë mësim: Zoti i Lartësuar thotë: **“Vallë, a nuk udhëtojnë nëpër botë e të shohin se si kanë përfunduar popujt e mëparshëm? Ata kanë qenë më të fortë se këta dhe tokën e kanë shfrytëzuar dhe punuar më mirë se sa e punojnë këta, e të dërguarit e tyre u kanë sjellë prova të qarta.”** (Rum, 9)

2- Udhëtimi për haxh: Udhëtimi për të marrë mësim është sunet, ndërsa udhëtimi për haxh është obligim për ata që kanë mundësi.

3- Udhëtimi për xhihad: Në lidhje me xhihadin ka shumë dispozita.

4- Udhëtimi për të siguruar të ardhura: Nëse njeriu nuk fiton dot të ardhura në vendin ku gjendet, atëherë e ka farz që të shkojë në një vend ku mund të fitojë mjaftueshëm.

5- Udhëtimi për ekstra fitim dhe tregti: Ky lloj udhëtimi është i lejuar. Madje është lejuar edhe përgjatë haxhit. **“Nuk është gjynah të kërkoni nga Zoti juaj ndonjë të mirë...”** (Bekare, 198) Qëllimi nga e mira në këtë ajet është tregtia përgjatë haxhit.

6- Udhëtimi për të marrë dije: Ky lloj udhëtimi është i njohur dhe i famshëm. Pra, ky është si udhëtimi i Musait (a.s.), me Hizrin.

7- Udhëtimi në vendet e bekuara si Qabeja, Ravza dhe Mesxhidu’l-Aksa.


8- Udhëtimi me qëllimin për të shtuar numrin e ushtarëve që bëjnë rojë në kufi.

9- Udhëtimi për të vizituar miqtë për hir të Allahut. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë në lidhje me këtë çështje:

“Një burrë mori rrugën për të vizituar vëllain e tij në një fshat tjetër. Allahu Teala ngarkoi me detyrë një engjëll në rrugën e atij burrit, në mënyrë që ta vëzhgonte atë. Kur burri arriti te engjëlli, ky i fundit e pyeti: Ku po shkon? Burri iu përgjigj: Në këtë fshatin përpara kam një vëlla në fe. Po shkoj ta vizitoj. Engjëlli e pyeti: A ke ndonjë interes prej atij vëllait? Burri i tha: Jo. Unë e dua atë për hir të Allahut. Për këtë arsye po shkoj ta vizitoj. Engjëlli i tha: Siç e do ti atë, ashtu të do edhe Allahu ty. Unë jam i dërguari që më ka dërguar Allahu Teala për të të dhënë këtë përgëzim.” (Muslim, Birr, 38.)

Edhe pse kalimit nga një vend në një vend tjetër i thuhet hixhret dhe udhëtim, hixhreti i vërtetë është marrja e rrugës duke hequr dorë nga pasuria, nga jeta madje edhe nga familja për të fituar kënaqësinë dhe dashurinë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, për të predikuar të vërtetën, për të ndaluar të keqen dhe për të valëvitur flamurin e tevhidit. Kjo nuk është një vepër që mund ta bëjnë të gjithë. Këtë mund ta bëjnë vetëm ata që zotërojnë besim të fortë dhe që mund ta flijojnë çdo gjë për hir të besimit dhe kauzës së tyre. Ata që nuk mund të zgjohen nga gjumi për ta falur në kohë namazin e mëngjesit, nuk mund ta hedhin hapin nga përcmimi për tek krenaria. Kështu që pranojnë të jetojnë pa personalitet dhe pa nder në vend që të bëjnë një jetë të denjë dhe të ndritur. Një jetë të tillë (pa nder dhe dinjitet) nuk e pranon as Islami, as humanizmi.





Shenjat e dashurisë NDAJ ALLAHUT

— Xhafer Durmush —

Allahu i Lartësuar në shumë ajete fisnike na e bën të qartë se cilat gjëra i do dhe se cilat gjëra nuk i do apo për shkak të cila gjërave dhe veprave do t'i dojë robërit e Tij.¹ Në njërin prej këtyre ajeteve që gjendet në suren Al Imran, thuhet: **“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”.**²

Sipas transmetimeve ky ajet fisnik ka zbritur kur i Dërguari i Allahut (a.s.), e ftoi Ka’b ibn Eshrefin dhe burrat e tij për të besuar dhe ata thanë: “Ne jemi bijtë dhe miqtë e Zotit.”³ Ky ajet fisnik na tregon mënyrën që duhet ta ndjekim për t’u bërë prej besimtarëve që e duan Allahun dhe që Allahu është i kënaqur prej tyre e ua ka falur mëkatet. Pra, kjo rrugë është vetëm pasimi i Resulullahut (a.s.), sepse ata që e duan me të vërtetë Allahun, sigurisht që e ndjekin të Dërguarin e Allahut, alejhi’s-salam. Si rezultat i natyrshëm i kësaj, edhe Allahu i do ata. Gjërat e tjera përveç kësaj, pra dashuria ndaj Allahut dhe të qenët rob i dashur i Allahut (duke mos e ndjekur Pejgamberin), nuk janë gjë tjetër përveçse një pohim i pavlerë.

Siç shprehet qartë në Rudu’l-Bejan, dashuria është anim i zemrës drejt një gjëje te e cila ndjen përsosmëri. Domethënë që zemra i jep më shumë rëndësi asaj gjëje që e afron te i dashuri i saj. Bazuar në këtë, përderisa njeriu ta dijë se përsosmëria e vërtetë i përket vetëm Allahut Teala, edhe dashuria e tij

do të jetë vetëm për Allahun (xh.xh.). Gjithashtu dashuria ndaj gjërave të tjera do të jetë vetëm për hir të Allahut. Natyrisht që edhe kjo kërkon bindje ndaj Allahut dhe dashuri ndaj asaj gjëje që të afron te Ai. Ka edhe prej atyre që kanë thënë se kuptimi i dashurisë është “dëshira për bindjen ndaj Zotit”. Në ajetin fisnik i cili përbën temën tonë bindja ndaj Allahut është lidhur me kushtin e pasimit të të Dërguarit të Allahut (a.s.).⁴

Edhe një ajet fisnik në suren Maide është i rëndësishëm nga aspekti i shpjegimit të temës sonë. Në këtë ajet thuhet: **“O besimtarë! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përlurur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur.”**⁵

Në këtë ajet tregohen cilësitë e atyre që do të sillen në vend të atyre që ia kthejnë kurrizin fesë së Allahut. Këto në të njëjtën kohë janë edhe specifika që e bëjnë njeriun të dashur te Allahu (xh.xh.). Siç shprehet edhe në ajet, robërit që i do Allahu janë të përlurur dhe modestë kundrejt besimtarëve dhe të ashpër e të sertë kundrejt femohuesve. Ata luftojnë në rrugë të Allahut dhe nuk i frikësohen qortimit të asnjë qortuesi. Ata që posedojnë cilësitë e ajetit të dytë duke marrë parasysh kornizën që jepet në

ajetin e parë të cilit ia kemi dhënë përkthimin më sipër, janë prej atyre që i do Allahu Teala. Kushdo që nuk i ka këto apo i ka të mangëta, menjëherë duhet të përpiket për t'i kompensuar dhe plotësuar.

Në një hadith fisnik që transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.), pasi i Dërguari i Allahut (a.s.), shprehet se *“Allahu do t’u shpallë luftë atyre që shfaqin armiqësi ndaj miqve të Zotit të Lartësuar”*, na njofton se *“Ai do të ketë dashuri ndaj robërve të Tij që fitojnë afrimetet shpirtërore me qenien sublime të Tij në saj të farzeve e nafileve dhe se kjo dashuri do të vazhdojë derisa Zoti të bëhet pothuajse syri i robit me të cilin sheh, veshi me të cilin dëgjon dhe këmba me të cilën ec”*.⁶ Po ashtu, në një hadith tjetër që e transmeton Ebu Hurejra (r.a.), është dhënë përgëzimi se Allahu do t’i bëjë edhe banorët e tokës e të qiejve që ta duan atë rob që e do Ai.⁷

Mendoj se këtë temë mund ta përmbledhim siç vijon: Çdo mysliman mund ta mësojë prej ajeteve dhe haditheve se prej cilat gjëra Allahu është i kënaqur dhe se cilët njerëz do. Kështu që mund ta kuptojë krejt lehtë se cilat gjëra dhe cilët njerëz nuk i do. Ata mund të lexojnë librat që janë shkruar në lidhje me këtë çështje dhe t’i mësojnë nga ilmihalet se me çfarë gjërash janë të obliguar. E rëndësishme është që gjithmonë ta mbajmë aktive vetëdijen për zbatimin në jetë të gjërave që i kemi mësuar dhe të duam për të bërë veprat prej të cilave Allahu Teala është i kënaqur. Pastaj të largohemi me përpikëri prej atyre që Ai nuk i do. Domethënë të ndjekim Resulullahun (a.s.), i cili është *“Usvetun hasene”*, pra, she-mbulli më i bukur. Kur të bëhet fjalë për zgjedhje në lidhje me ndonjë çështje, së pari duhet të shohim se çfarë ka thënë dhe si ka vepruar Pejgamberi (a.s.). Disa

prej pyetjeve që duhet t’ia bëjmë nefsit këtu janë: Në çfarë gjendjeje e kemi ibadetin? Në çfarë grade është përpjekja jonë për ta merituar dashurinë hyjnore e cila jepet si përgëzim në hadithin e mësipërm, duke i kryer farzet me përpikëri dhe duke pasur dëshirë për t’i falur edhe nafilet? Sa kemi marrë nga mëshira, mirësjellja dhe hijeshia e të Dërguarit të Allahut (a.s.), për të cilin jemi urdhëruar që ta pasojmë? Sa gjendet në personalitetin tonë sjellja me modesti ndaj besimtarëve dhe me dinjitet kundrejt jobesimtarëve? Cilin vend zë në rendin e ditës sonë përpjekja për të bërë më të mirën për hir të Allahut?

Sa i marrim parasysh edhe pyetjet e tjera që nuk janë parashtruar këtu, në mënyrë që të bëhemi prej robërve që e meritojnë dashurinë e Zotit (xh.xh.)? Veten tonë mund ta testojmë me përgjigjet që mund t’ua japim këtyre pyetjeve dhe pyetjeve të tjera të ngjashme me këto.



DINJITETI DHE QETËSIA

Në ajetet që tregojnë cilësitë e besimtarëve thuhet: *“Robërit e të Gjithë-mëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!”; dhe ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë; dhe ata që thonë: “O Zoti ynë, largoje prej nesh ndëshkimin e Xhehenemit, sepse, me të vërtetë, dënimi i tij është i përjetshëm.”*⁸

Tashmë duam të shtjellojmë dinjitetin dhe qetësinë e cila përmendet në ajetet e mësipërme. Ndërkohë që në këto ajete dhe në vazhdim të tyre radhiten cilësitë të cilat duhet t’i zotërojnë besimtarët në formën: Pendohen, i kërkojmë mbrojtje Allahut nga tmerri i ndëshkimit, bëjnë ibadet natën, japin për hir të Zotit duke u distancuar nga shpërdorimi dhe koprracia, fakti që më në krye përmendet dinjiteti dhe qetësia dhe menjëherë pas tyre kalohet te moszbritja në nivelin e injorantëve sulmues duke thënë *“paqe”*, për mendimin tonë është shumë i rëndësishëm. Sigurish që më në krye të dinjitetit i cili pasqyron personalitetin vjen modestia në të ecur dhe normaliteti në sjellje.

Islami e formon dhe e ndërton njeriun nga koka deri te këmbët. Domethënë, Islami kërkon që virtytet të cilat e zbukurojnë marrëdhëniet njerëzore të shfaqen te personaliteti i njeriut. Islami kërkon që njeriu me uljen dhe ngritjen, ecjen dhe të folurit, qëndrimin dhe fytyrën e qeshur të tij të jetë i vetëdijshëm për mirësitë që ushqehen nga besimi që posedon. Myslimani nuk mund të jetë mendjemadh dhe i pasjellshëm. Ai nuk mund t’u ngajë në asnjë situatë njerëzve të ashpër dhe problematikë.

Nëse është e rëndësishme që ta mbajmë dinjitetin në momente të zemërimit e të gëzimit dhe nëse dinjiteti është shfaqja e personalitetit Islam, atëherë padyshim se ajo që e ushqen atë është vazhdimësia në ibadetin e natës dhe devotshmëri ndaj Allahut.



■ **REFERENCAT:** 1) Për shembull shik. Bekare, 190, 195, 20, 222; Al Imran, 22, 57, 76; Maide, 13, 42 dhe ajete të tjera të ngjashme me këto. 2) Al Imran, 31. 3) Shik. Maide, 18. 4) Ruhul-Bejan, Botimet Erkam, Hejet, vëll. 3, fq. 75. 5) Shik. 5/54. 6) Buhari, Rikak, 38. 7) Muslim, Birr, 157. 8) Furkan, 63-65.

TË JESH PREJ TË PAKTËVE

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Dihet se disa myslimanë janë shumë të aftë / specialistë për sa i përket çështjes së lutjes dhe përgjërimit. Këtyre ua kemi mësuar përkufizimin dhe pozitën e tyre nga hadithi fisnik në të cilin thuhet: *“Esenca e adhurimit është lutja.”*¹ Ndërsa disa myslimanë të tjerë nuk e dinë dot se çfarë duan dhe se si mund ta kërkojnë atë që duan. Për këtë arsye, ata ankohen / vuajnë nga kjo gjendje e tyre. Në të vërtetë, shembujt e lutjeve në ajetet dhe hadithet fisnike ia lehtësojnë punën umetit në lidhje me këtë çështje. Për t'i mësuar ato na duhet dije. Ndërsa për t'i zgjedhur dhe për t'i përdorur sipas vendit të duhur na duhet vetëdije dhe aftësi.

Natyrisht se për pranimin e lutjes e cila është një shenjë e adhurimit, duhet singëritet dhe dëlirësi. Në lidhje me esencën e lutjes dhe praktikimin e saj ka shumë rregulla dhe veçori. Ne këtu dëshirojmë të ndajmë me ju një shembull lutjeje të përjetuar. Ky shembull është një shenjë vetëdijeje dhe shumë interesant (madje mund të thuhet edhe i jashtëzakonshëm). Këtë dëshirojmë ta bëjmë edhe për të marrë mësim, edhe për të parë urtësinë e tij. Ngjarja është kjo:

Një person u lut: “O Zot! Më bëj prej të paktëve!”,

ndërkohë që ishte pranë Omerit, (r.a.). Omeri (r.a.), e pyeti: “Ç’është kjo lutje kështu?” Ai personi i tha: “Kam dëgjuar se Allahu Teala ka thënë: **“...Pak nga robërit e Mi, janë falënderues.”** (Sebe’, 13) Unë në këtë çështje dëshiroj të më bëjë prej të paktëve. Nisur nga kjo Omeri i tha:

“Të gjithë dinë më shumë se Omeri!”² Në këtë mënyrë e vlerësoi vetëdijen dhe botëkuptimin e atij që bëri këtë lutje.

Ajeti fisnik për të cilin flitet në këtë ngjarje interesante është ajeti i 13-të i sures së 34-t e cila është surja Sebe’. Në pjesën e përparme të këtij ajeti përmenden nderimet dhe mirësitë hyjnore që i janë dhënë Davudit dhe Sulejmanit. Pastaj thuhet: **“...O familje e Davudit! Bëni falënderim (për Allahun)!” Megjithatë, pak nga robërit e Mi, janë falënderues.”**

Myслиmanët e ndjeshëm duke filluar me në krye sahabët e nderuar të cilët dëshirojnë ta ndjejnë kënaqësinë e Islamit në këtë botë e në botën tjetër dhe që kërkojnë të marrin mirësitë që u janë premtuar, herë pas here mund të shfaqin kërkesa, sjellje dhe fjalë me të cilat nuk jemi mësuar. Kjo ngjarje është njëra prej këtyre fenomeneve.

Përgjatë lutjes dhe përgjërimit është krejt normale që çdokush t’i parashtrojë kërkesat dhe dëshirat gjatë e gjerë. Kërkesa për të “qenë prej të paktëve” që



mund të parashtrohet përgjatë këtyre momenteve, nuk është diçka që mund të vijë shpesh në mendje. Fakti që gjithë ai kalif i madh u habit dhe tha: “Çfarë lutjeje është kjo kështu?!” , sapo e dëgjoi një lutje të tillë, do të thotë se kjo lutje ishte jashtë perceptimit dhe praktikës së përgjithshme të cilën e theksuam më lart. Ajo me të cilën janë mësuar të gjithë nuk pranohet gjithmonë nga të gjithë si një virtut i përgjithshëm. Shprehjet dhe praktikat që mbartin diçka të ndryshme mund të jenë shprehje e një perceptimi dhe vetëdijeje të mrekullueshme që mbështeten në shkaqe pozitive. Kështu që në të vërtetë, nuk janë gjëra ndaj të cilave duhet të habitemi. Andaj kur Omeri e kuptoi nga përgjigja e atij personit se kjo lutje që iu duk e çuditshme ishte e marrë nga një ajet fisnik ngaqë ai i tha: “Kam dëgjuar se Allahu Teala ka thënë se “...Pak nga robërit e Mi, janë falënderues.” , prandaj dua që të më bëjë prej atyre robërve të Tij që janë “pak”, menjëherë e vlerësoi situatën duke thënë: “Të gjithë dinë më shumë se Omeri.” Në këtë mënyrë edhe e vlerësoi atë myslimanin, edhe i bëri autokritikë vetes duke shfaqur një modesti të madhe. Siç kuptohet, në vlerësimin dhe autokritikën e Omerit (r.a.) një rol të madh po aq sa esenca e kësaj pune ka edhe të shprehurit e atij personi me sinjeritet duke i thënë në mënyrë indirekte “kam dëgjuar” dhe jo duke përdorur një fjali që tregonte se ai ishte i ditur në formën “kam lexuar në Kuranin Fisnik”.

Përtej fjalëve të këtij personi dhe fjalëve të Omerit të cilat janë të mrekullueshme dhe që duhet të merren si shembull, ngjarja nxjerr në pah edhe një të vërtetë tjetër. Ajo është kjo: Falënderimi i myslimanëve të parë nuk ishte me fjalë, por me vepra. Thënë me një shprehje tjetër, ata posedonin perceptimin se “shukri/falënderimi për mirësinë bëhet sipas llojit të mirësisë”.

Me kalimin e kohës perceptimi i këtij shukri/falënderimi të tillë dinamik verbalisht filloi të praktikohet duke u mjaftuar me hmdin/falënderimin në formën “elhamdulil-lah”. Falënderimi për mirësinë është i bukur, por më i bukur është shukri. Ndërsa shukri siç e cekëm edhe më sipër, bëhet sipas llojit të mirësisë. Mesa duket në ajetin fisnik ku njoftohemi për “robërit që falënderojnë” të cilët janë të pakët, synohen këta njerëz të pakët që e bëjnë shukrin me vepra.

Shprehja “agnijau’sh-shekirin / të pasur që e falënderojnë Zotin” që gjendet në kulturën islame, përdoret për të pasurit që japin nga lloji i mirësisë të

cilën e posedojnë, që u bëjnë dobi njerëzve përreth dhe që pastaj e falënderojnë Zotin (xh.xh.). Nëse çështjen e shtjellojmë duke marrë pak parasysht edhe aktualitetin, atëherë, nëse dikush nuk i çon fqinjët qoftë edhe një pjatë ushqim ndërkohë që vetë ha tri pjata me ushqim dhe thotë: “Elhamdulil-lah u ngopëm edhe sot! Falënderimet qofshin për Ty, o Zot!”, teksa mbështetet në kolltuk dhe pi kafënë që ia sjell bashkëshortja, në të vërtetë nuk e ka falënderuar Zotin për mirësinë që i ka dhënë. Në të njëjtën mënyrë, nuk mund ta falënderojmë Zotin (xh.xh.), duke thënë me zë të lartë “elhamdulil-lah” ndërkohë që bëjmë sikur nuk i shohim njerëzit në vende të ndryshme të botës që nuk ushqehen mjaftueshëm, që shtrihen për të fjetur ndërsa janë të uritur, madje që vdesin nga uria. Kështu nuk mund të bëhemi kurrë veçanërisht prej “robërve të Allahut të cilët janë të pakët, por që e falënderojnë me të vërtetë Atë”.

Para pjesës së ajetit fisnik i cili na njofton se janë të pakët robërit që e falënderojnë Zotin, thuhet: “...I’amelu ale Davude shukran / O familje e Davudit! Bëni falënderim (për Allahun)!...” Fakti që shprehet në këtë lloj mënyre nxjerr në pah esencën dhe kornizën e veprës në konceptin “shukr/falënderim” që është përtej të thënë “elhamdulil-lah” në formë verbale.

Padyshim se njeriu ka nevojë për dije, vetëdijesim dhe mirëqenie, në mënyrë që të veprojë sipas virtytit për ta falënderuar Zotin në formë reale për mirësitë që ia ka dhënë. Andaj edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka thënë në një hadith fisnik: “*Allahu kënaqet shumë kur i kërkojnë të mira.*”³ Ndërsa në një hadith tjetër fisnik na jep këtë këshillë: “*Kërkoni të mira për këtë botë dhe botën tjetër nga Allahu!*”⁴

Të kërkuarit e lumturisë së kësaj bote dhe të botës tjetër për ata që dëshirojnë të bëjnë lutje të shkurt-ra, përmbledhëse dhe domethënëse, domethënë të kërkuarit e mirësive duhet të parashtrohen në mënyrë të zgjuar dhe në përputhje me këshillën e Pejgamberit (a.s.). Lutja prej tri kërkesash në formën: “All-llahumme inni es’eluke temame’n-ni’meh ve devame’l-afijeh ve husne’l-hatimeh / o Allah! Të kërkoj mirësi të plota, mirësi të vazhdueshme dhe fund të mirë!”, të cilën e dëgjojmë shpesh nga hoxhallarët e nderuar, përbën një shembull të bukur për atë që thamë më sipër. Atëherë lutja jonë le të jetë edhe kjo që Zoti të na bëjë prej robërve të Tij të pakët që u ka dhënë mirësi!

■ **REFERENCAT:** 1) Tirmidhi, Daavat, 1. Për komentimin shik. Çakan, Hadislerle Gerçekler / Të vërtetat me hadithe, fq. 170-174. 2) Ibn Ebi Shejbe, Musannef, X, 322. Përveç të tjerash shik. Elmallëllë, Hak Dini Kur'an Dili, VI/3953; Bursevi, Ruhul-Bejan, X/4; Kurtubi, el-Xhami, XIV/277. 3) Tirmidhi, Daavat, 101. 4) Buhari, Xhihad, 112, 156, Temenni, 8; Muslim, Xhihad, 20; Ebu Davud, Xhihad, 89; Tirmidhi, Daavat, 84, 101, 128; Ibn Maxhe, Dua, 5; Darimi, Sijer, 6; Ahmed ibn Hanbel, Musned, I, 4, 14, IV, 252. Edhe në ajetin fisnik të cilin e themi pothuajse në çdo namaz, këshillohemi që të lutemi: “O Zot! Na jep të mira edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër!” (Bekare, 201)



KUSHTI I BOSHTIT

— Nuredin Jëlldëz —

Në sipërfaqen e tokës po bëhen punime në emër të Islamit që nga dita kur Kuranit Fisnik na ka ftuar te Allahu duke thënë: “O njerëz!”


Ata që i kanë besuar Allahut dhe ditës së ahiretit duke filluar që nga sahabët e nderuar, janë përpjekur për të bërë atë që u kërkon besimi. Rezultatet e kësaj përpjekjeje mund t’i shohim në çdo vend duke filluar që nga ndërtimi i një xhamie me tulla dheu në një fshat të vogël ku jetojnë besimtarët në Afrikë e deri te themelimi i shumë shteteve islame në Andaluzi dhe vende të tjera të ndryshme.

Nisur nga aspekti i një individi apo grupi që i beson Allahut (xh.xh.), këtë e shohim si një mision për hir të Allahut Teala. Sahabët e nderuar, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre, për këtë mision kanë bërë gjënë më të bukur dhe entuziazmuere që mund të bëhet.

Ata na dhanë shembujt se çfarë mund të bëhet për hir të Allahut dhe si mund të bëhet për hir të Allahut. Shembujt të cilët do të mbestin deri në kiamet. Ata ia dolën mbanë për të ndërtuar për hir të Allahut institucione si individë në vendet ku gjendeshin si individë dhe si grupe në vendet ku gjendeshin të tillë.

Tëksa preokupoheshin me xhematin me identitetin e një myslimani të dorëzuar ndaj Allahut edhe në shtëpi (me ibadet), gjithashtu edhe punonin me identitetin e dorëzuar ndaj Zotit (xh.xh.). Personaliteti i tyre individual dhe ai juridik qëndronte në të njëjtin bosht. Atë që e shikonin si haram për myslimanin, nuk e perceptonin si të lejuar për xhematin. Institucionet islame nuk përfaqësonin fusha të kufizuara vetëm me xhamitë.

Ata e konsideronin ibadet të mbledhurit në emër të Allahut. Kushti i boshtit ishte kushti më



themelor në çdo punë që do të bëhej “së bashku” në këtë union që emrin e përbashkët e ka Umet. Ky bosht ishte boshti për të punuar për hir të Allahut dhe sipas fesë së Allahut.

Çdo bashkim që formohet me identitetin Islam nuk mund të tolerohet për t’u larguar nga principi “i të qëndruarit brenda boshtit Islam”. Çdo tolerim që mund të bëhet, edhe nëse dallohet, edhe nëse nuk dallohet, do të shkaktojë rrëshqitje dhe prishje mbi “identitetin Islam”. Këtë të vërtetë të hidhur nuk mund ta ndryshojnë edhe nëse emrat dhe markat i atribuohen Islamit apo edhe nëse pohimet formohen mbi ideale të mëdha.

Feja e Allahut, Islami është i qartë. Ajo është zbritur në tokë, në mënyrë që të formohet një jetë rreth e rrotull Kuranit Fisnik, në mënyrë që Pejgamberi, alejhi’s-salam, të jetë lideri i vetëm dhe në mënyrë që ata të cilët i besojnë Allahut, domethënë ata që janë në të vërtetën të jenë të nderuar.

Shoqëria në të cilën mund të shkatërrohen haramet dhe nuk përjetohet problem në kryerjen e farzeve është shoqëri islame, apo më e pakta, është një shoqëri që ka një qëllim të tillë. Ata që nuk e kanë problem për t’u bërë tolerime strukturave që i kanë formuar nga parimet për të cilat nuk tolerojnë kur janë vetëm, përjetojnë probleme në pasimin e gjurmëve të brezit të parë të bekuar.

Përderisa të mos qëndrojmë qartazi në boshtin e brezit të parë, markat nuk mund të kenë cilësinë e dokumenteve që vërtetojnë se po bëjmë punë me identitet Islam. Për këtë arsye, një strukturë që nuk e bën princip të parë konsultimin, i cili është një urdhër i qartë i Allahut Teala, do të thotë se po përjeton rrëshqitje në bosht.

Edhe nëse personat që e kanë formuar atë strukturë bëjnë një jetë fetare, prapë se prapë

kjo nuk e bën fetare atë (strukturë). Rruga e cila do të përshkohet deri te një konsultim real dhe i qartë është një rrugë e gjatë.

Nëse një punë apo një fjalë ndaj të cilës qëndrojmë larg në jetën private, kryhet apo diskutohet ndërmjet atyre që kanë bërë një strukturë me emrin Islam, do të sjellë rezultatin e bashkimit në emër të fesë, por të mos qenët sipas fesë. Strukturat tona si myslimanë që jemi duhet të reflektojnë besimin dhe jurisprudencën tonë. Mund të kemi gjëra për të cilat nuk ia kemi dalë mbanë, por nuk jemi edhe pa gjëra që i neglizhojmë.

Fjalët, sjelljet dhe praktikat që mund të rezultojnë në një farë mënyrë me kënaqjen e tekave tona, mund ta pengojnë qëllimin tonë për të arritur kënaqësinë e Allahut (xh.xh.).

Prej dy gjërave themelore mund të kuptohet sesa i qëndrojmë boshtit apo sesa kemi rrëshqitur nga boshti kur të mblidhemi së bashku në emër të fesë. Njëra prej këtyre gjërave është konsultimi.

Strukturat e kufizuara me mendimet e një individi apo të një grupi, nuk reflektojnë umetin. Përderisa të mos reflektojnë umetin, ata nuk janë shpëtimtare sado që t’i vendoset emri Islam.

Ndërsa gjëja e dytë është kjo: Sa është aktiv el-emru bi’l-ma’ruf ve’n-nehju ani’l-munker / urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, i cili është një stil jete që na e ka treguar Kurani Fisnik dhe një lloj vetëkontrolli për umetin?

Nëse kemi probleme në këto dy pika të rëndësishme, atëherë do të thotë se kemi probleme edhe në bosht.

Kjo pamje është argument se idealet e mëdha i kemi burgosur në një vend të vogël. Qëndrimi në boshtin e sahabëve të nderuar është një kusht që nuk mund të neglizhohet.



Një vendosmëri e tillë

(Halid bin Said dhe Zonja Umejme)

— Adem Saraç —

Dhuna dhe torturat e mushrikëve mekas dita ditës po shtoheshin. Këto vuajtje që nuk dinin të përfundonin e as të reshtnin, kur u bënë të parazistueshme, i Dërguari i Allahut (a.s.), u këshilloi myslimanëve që të emigronin në Abisini. Atje do të gjenin prehje.¹

Edhe Halid bin Saidi bashkë me zonjën e tij të dashur, Umejjen, do të emigronin për në Abisini. Mirëpo, papritur i ati i Halidit u sëmur. Ndërkohë që i shtrirë në shtrat dhe i ndezur nga temperatura e lartë që kishte dhe me rënkime të mundimshme, ashtu i shtrirë në atë gjendje madje vazhdonte armiqësinë ndaj Islamit. Gjithnjë të njëjtat çështje diskutonte me të afërmit që vinin ta vizitonin dhe me mushrikët që mendonin njësoi si ai:

- Si je, o Ebu Uhajha?
- A nuk po e shihni se si jam?
- Nuk vdes njeri nga kjo sëmundje, mos u shqetëso!
- Kush po flet për vdekjen?
- Po përse e ke fjalën atëherë?
- E kam fjalën për atë dhe ata!

1. Ibni Hisham, es-Siretun-Nebevije, vol. 1, f. 344.

- Kush është ai dhe ata?
- Ai që thotë se është i Dërguari i Allahut dhe ata që e ndjekin atë!
- Ç'mendim ke ti për atë dhe për ata?
- Më prisni të ngrihem nga shtrati dhe do ta shikoni edhe vetë ç'mendim kam!
- Meqë mendon për t'u ngritur dukesh sikur po përmirësohesh.
- Pa e mundur atë dhe ata nuk do të vdes, jo!
- Mos fol fjalë të mëdha, o Ebu Uhajha!
- E pastaj nëse flas fjalë të mëdha?
- Nejse, mesa duket je më mirë, apo jo?
- Ju thashë, nuk vdes unë pa i mundur ata!
- Mos u nevrikos, o Ebu Uhajha!
- Mos më nevrikosni as ju atëherë!
- Ne që të gjithë jemi në një mendje me ty!
- Mirëpo asgjë s'po mund të bëni!
- Nuk po i lëmë të flasin myslimanët! Po bëjmë që të vuajnë sa më shumë ata. Kudo që të shohim një mysliman menjëherë e sulmojmë! A nuk mjafton?
- Nuk mjafton!
- E çfarë mund të bëjmë tjetër?
- Nëse do të ngrihem në këmbë pasi të shpëtoj nga kjo sëmundje kaq e mundimshme, do ta shikoni që të gjithë se çfarë duhet bërë!

- E çfarë do të bësh?

- Me të gjithë fisin tim do t'i vërsulemi të gjithë myslimanëve, derisa të mos lëmë as edhe një mysliman në Mekë!

- Pasi të vrasim atë person që pretendon se është i dërguar i Allahut, shpërndahen të gjithë!

- Do ta vras!

- Kë?

- Do ta bëj copë – copë atë njeri që thotë se është i Dërguar i Allahut!

- Po mirë, si do të shpëtosh nga duart e gjithë këtyre myslimanëve, me në krye bijtë e hashimive?

- Me zi po pres të ngrihem nga ky shtrat!

- Ti para se t'u vërsulesh atyre, shiko një herë shtëpinë tënde!

- E çfarë ka shtëpia ime?

- Mos bëj sikur nuk e di, o Ebu Uhajha!

- Njeriu që thotë se është i Dërguari i Allahut na ndau edhe ne! Sikur sado pak të më lehtësohet kjo sëmundje, menjëherë do të ngrihem dhe do ta vras atë! Do ta vras atë dhe të gjithë ata që e ndjekin atë! Me zi po pres që të ngrihem!²

I mbushur plot me mllef, fliste aq shëmtuar sa që i biri, Halid bin Saidi nuk e duroi më shumë. Ndonëse i ati e kishte dëbuar nga shtëpia, kishte shkuar për vizitë tek i ati, meqë ai ishte i sëmurë, por i ati jo vetëm që nuk po e respektonte, por edhe po e fyente të birin. Megjithatë, duke thënë që “është babai im”, po përpiquej t'i shërbente. Por, në momentin kur po e tepronte duke i drejtuar fjalë të rënda Resulullahut (a.s.), nuk rezistoi më shumë dhe duke qarë u lut kështu:

- O Allahu im! Udhëzoje babain tim! Nëse nuk do t'i japësh udhëzim, mos e bëj që ai të çohet nga shtrati më! Bëje të mundur që duke i marrë shpirtin atij, t'ia shpëtosh jetën e vëllezërve të mi myslimanë!³

2. Ibni Sa'd, et-Tabakatul-Kubra, vol. 4, f. 94 – 96.

3. Ibnul Esir, Usdul-gabe fi marifetis-sahabe, vol. 2, f. 97 – 98.

Ndërkohë që po përgatiteshin për të emigruar në Abisini në mënyrë të fshehtë, Halid bin Saidi dhe e shoqja, Umejje binti Halid, po bënë gjithashtu kujdes që të mos binin pre e ndonjë kurthi të dinakut Ebu Uhajha.

Me shtimin e sëmundjes, po i shtoej edhe më shumë mosbesimi, por si pasojë e rëndësës së sëmundjes, po ulërinte si qentë e si ujqetë. Sidoqoftë, nuk harronte të kërcënonte e të fyente Resulullahun (a.s.). Në vend që të besonte dhe të meritonte mëshirën e Zotit, ai vazhdonte të mallkohej, nga mallkimi që s'i ndahej nga gjuha! Pa kaluar shumë vdiq me gjithë atë mosbesimin e madh që e pushtoi tërësisht!

Kur dëgjoi Halid bin Saidi (r.a.), që i ati kishte vdekur me fjalë blasfemuese në gojë, iu drejtua Allahut:

- Lavdi qoftë Allahut, i cili m'i mbrojti vëllezërit e mi myslimanë nga e liga e babait tim! O Allah! Jepu iman edhe vëllezërve të mi në shtëpi!⁴

Halidi dhe e shoqja Umejje, punonin me gjithë fuqinë, duke u përballur gjithë vështirësitë. Edhe vëllezërit e Halidit, për të cilët ai përpiquej t'i ndihmonte, kishin hequr mjaft keq nga i ati i tyre. Amri dhe e shoqja e tij, Fatimja patën përqafuar Islamin. Kurse Ebani, Asi dhe Ubejde kishin ndjekur rrugën e babait të tyre, si armiq të Islamit.⁵

Ata përpiqeshin që të jetonin brenda rregullave islame dhe ditë-natë përpiqeshin me përgjegjësi që të kryenin siç duhet kumtin islam. Kur panë që tashmë në Mekë ishte e pamundur që të jetonin, atëherë vendosi bashkë me gruan e tij që të shkonin në Abisini.

Sado e mundimshme qoftë, bashkë me gruan e vet ai ka manifestuar një vendosmëri legjendare. Një vendosmëri tipike e sahabëve.

E po, çdokush që merr shembull të Dërguarin e Allahut, duhet të ketë të njëjtën vendosmëri, apo jo?!

Sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem...

4. Halebi, Insanul-ujun fi siretil-Eminil-me'mun, vol. 1, f. 454.

5. Belazuri, Ensabul-Eshraf, vol. 1, f. 199.



Gjithmonë ELHAMDULILAH

— Doç. dr. Mustafa Xhanllë —

Nga Enesi (r.a.) transmetohet se Profeti (a.s.) ka thënë: *“Kur Allahu i jep robit të Vet një mirësi, dhe ai thotë “Elhamdulillah”, falënderimi i tij është më i vlefshëm se ajo mirësi.”* (Ibn-i Maxhe, Edeb, 55.)

Në këtë hadith fisnik, i Dërguari i Allahut (a.s.), thekson vlerën që ka shprehja “elhamdulillah” tek Zoti ynë i Madhëruar. Kjo shprehje, është fjalë madhështore që përmban kuptime të larta si, falënderim, lavd dhe madhërim.

Komentimi i kuptimit të shprehjes Elhamdulillah:

“E keni parasysh të vërtetën e “hamdit”, të cilën të gjithë e dinë dhe e kërkojnë si shpresën tyre të fundit? Ja pra, ai “hamd”, me të gjitha falënderimet, lavdërimet dhe madje me të gjitha gradët dhe format, i takon vetëm Allahut, është e drejta e Allahut dhe prona e Tij. Kjo, sepse Ai është Allahu!.. sepse... sepse!..” (Elmalili, I, 75.)

Fakti që emri i umetit të Muhamedit (a.s.), në xhenet do të jetë “Hammadun/Ata që falënderojnë shumë”, dhënia e pozitës “Makam-i Mahmud” profetit tonë (a.s.) dhe emërtimi “Livau’l-Hamd”, i flamurit që do t’i jepet atij në mahsher, janë të gjitha në sajë të pozitës së falënderimit.

ELHAMDULILAH, ËSHTË SURJA FATIHA

Surja e parë e Librit tonë të shenjtë, Kur’anit, Fatiha, fillon me elhamdulillah. E gjitha kjo sure, është si një komentim i fjalës elhamdulillah, që është edhe hapja e saj. Shprehja elhamdulillah, është unifikuar aq shumë me suren Fatiha, saqë ndër popull, kjo sure njihet si “el-ham”, që nënkupton “el-Hamd”.

ELHAMDULILAH ËSHTË NAMAZ

Çdo ditë, në pesë kohët e namazit e fillojmë lutjen tonë ndaj Allahut me hamd/falënderim. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Nuk quhet namazi i atij që nuk e lexon suren Fatiha në të.”* (Buhari, Ezan, 94.) Ndërsa në fund të namazit, na ka këshilluar të themi 33 herë elhamdulillah. (shih. Ebu Daud, Vitri,

24.) Në fillim të namazit elhamdulillah, në fund të tij elhamdulillah... Kështu që i gjithë namazi, nga kreu deri në fund është elhamdulillah...

ELHAMDULILAH PËRFSHIN GJITHË JETËN TONË

Në përputhje me sunetin e Profetit tonë (a.s.), në çdo fushë dhe pjesë të jetës sonë të përditshme, që kur zgjohemi nga gjumi, kur shkojmë në shtrat, kur hamë dhe përfundojmë ushqimin apo pijen, kur ligjërojmë, kur teshtijmë, madje edhe pas kryerjes së nevojave personale, e falënderojmë Zotin tonë.

ELHAMDULILAH I SHTON TË MIRAT

Zoti ynë i Madhëruar, ka thënë:

“...Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’ju shtoj edhe më shumë begatitë e Mia...” (Ibrahim, 7.) Pra, besimtari duhet të falënderojë përballë mirësive që i ka dhënë Allahu dhe, duke thënë “elhamdulillah”, Allahu i Madhëruar ia shton edhe më tepër ato mirësi.

ELHAMDULILAH DO TË THOTË TË JESH I KËNAQUR

Profeti ynë dashur (a.s.), ka thënë:

“Shikoni ata që janë më poshtë se ju në mirësi, e jo ata që janë më lartë, sepse po shikuat ata që janë më poshtë se ju, është më mirë për ju, me qëllim që të mos i nënvleftësoni mirësitë që ju ka dhënë Allahu.” (Muslim, Zuhd, 9.)

Për këtë arsye, besimtari duhet të mjaftohet dhe të kënaqet me atë që i ka dhënë Allahu dhe, duke thënë elhamdulillah, duhet ta falënderojë Atë për ato mirësi.

Në një hadith tjetër, Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“Allahu i Madhëruar kënaqet kur robi i Tij thotë elhamdulillah pasi ha apo pi diçka.” (Muslim, Dhikr, 89.) Pra, Allahu i Madhëruar kënaqet me robin që e falënderon.



ELHAMDULILAH, DO TË THOTË TË JESH I KËNAQUR ME ALLAHUN

Të jemi të kënaqur prej Tij në çdo situatë... Edhe kur na jep, edhe kur nuk na jep... Edhe kur na dhuron, edhe kur na privon... Duhet të themi gjithmonë: *“Edhe lehtësia edhe vështirësia që vjen prej Teje është e bukur!”*...Profeti ynë i dashur (a.s.), na tregon një dialog që bëhet midis Allahut dhe melekëve të Tij:

“Kur një robi i vdes fëmija, Allahu i Madhëruar u thotë melekëve:

- Ia morët fëmijën robit Tim, apo jo?

- Po! –thonë melekët.

Allahu urdhëron:

- Ia këputët frutin e shpirtit robit Tim?

- Po! –thonë melekët.

Allahu urdhëron:

- E çfarë tha robi Im në atë moment?

- Të falënderoi Ty dhe tha: “inna lillahi u inna ilejhi raxhiun / Prej Allahut kemi ardhur dhe tek Ai do të kthehem!”

Pas kësaj, Allahu i Madhëruar, urdhëron:

- Atëherë ndërtoni një pallat për robin Tim në xhenet dhe vërfani emrin «pallati i hamdit»” (Tirmidhi, Xhaniz, 36.)

ELHAMDULILAH, ËSHTË MIRËNJOHJE

Në një hadith fisnik, thuhet:

“Falënderimi, është kreu i mirënjohjes. Kush nuk e falënderon Allahun, nuk tregon mirënjohje ndaj Tij.” (Bejhaki, Shuab’l-Iman, IV, 96.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), zakonisht i lutej Allahut në kohën para agimit dhe qëndronte gjatë në kijam dhe në sexhde. Njëherë, në një moment të tillë plot frymëzim, ishte ngritur nga gjumi dhe kishte falur namaz derisa i ishin ënjtur këmbët. Aisheja (r.a.), e cila e vuri re gjendjen e Tij, i thotë Profetit (a.s.):

“Allahu t’i ka falur të gjitha gabimet e shkuara dhe ato që mund të bësh në të ardhmen. Pse e lodh kaq shumë veten?”

Profeti ynë i dashur (a.s.), e ngriti kokën e tij të bekuar dhe nga goja e tij rrodhën këto fjalë:

“O Aishe! A të mos bëhem një rob që është mirënjohës ndaj Allahut për të gjitha këto mirësi?” (Buhari, Tehexhahud, 6.)

ELHAMDULILAH, DO TË THOTË TË MOS BËHESH MOSMIRËNJOHËS

Mosmirënjohja, është një cilësi e keqe që gjendet në potencialin e çdo njeriu. Besimtari, mundohet ta kontrollojë këtë cilësi të keqe me anë të frerëve të vullnetit. Mirëpo, tek njerëzit që nuk ia arrijnë kësaj, shfaqet cilësia e mosmirënjohjes. Për rrjedhojë, ashtu siç nuk e falënderon Krijuesin, njeriun nuk falënderon as njerëzit e tjerë. Lidhur me këtë, Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“Kush nuk falënderon njerëzit, nuk falënderon as Allahun.” (Tirmidhi, Birr, 35.)

ELHAMDULILAH, ËSHTË DUA/LUTJE

Në Kur’an, urdhërohet:

“...lutja e fundit e tyre (banorëve të xhenetit), është: «Falënderuar qoftë Allahu, Zoti i botëve»!” (Junus, 10.)

Ndërsa Profeti ynë (a.s.), thoshte shpesh:

“Elhamdulilah ala kulli hal / Falënderimi i takon Allahut në çdo situatë!” (Ibn-i Maxhe, Edeb, 55.)

ELHAMDULILAH ËSHTË DHIKIR

Elhamdulilah, ashtu siç është hyrja e Librit tonë të shenjtë dhe e namazit, ajo është edhe kreu i çdo pune të mirë. Profeti ynë i dashur (a.s.), ka thënë:

“Çdo fjalë apo punë e kuptimtë që nuk fillon me falënderimin ndaj Allahut, është e pa begatë/pa sukses.” (Ibn-i Maxhe, Nikah, 19.) Në këtë mënyrë, Profeti ynë (a.s.), na e ka bërë të ditur se, nëse besimtari nuk i fillon fjalët dhe punët e tij me falënderim ndaj Allahut, fjalët dhe veprat e tij nuk kanë për të rezultuar të suksesshme.

Besimtari që kthen fjalën “elhamdulilah” në një dhikër të vazhdueshëm, e ndjen entuziazmin e këtij dhikri në thellësi të zemrës së tij kur thotë “elhamdulilah” dhe, më vonë, ky dhikër reflektohet në sjelljet e tij. Për rrjedhojë, ai e sheh dhe e ndjen Allahun në çdo vend, duke u përpjekur të jetojë në urtësinë e këtij ajeti fisnik:

“Lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përgjigjen Atij duke u falur! Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!” (Hixhr, 98-99.)

Të jesh një rob që e falënderon Allahun në çdo moment, në çdo situatë, në çdo vend dhe kohë, në kamje dhe në skamje, është një lumturi e madhe dhe tregues i një morali të lartë.

Zoti ynë na e bëftë të mundur të jetojmë të kënaqur dhe ta falënderojmë Atë gjithmonë!..



Umeti MË I MIRË

— Doç. dr. Harun Êmysh —

Kurani Fisnik i cilëson ithtarët e fesë që ka sjellë i Dërguari i Allahut (a.s.), si “umeti më i mirë”¹, sepse ata i besojnë Allahut Teala dhe dispozitave që Ai ka urdhëruar të besohen dhe e zbatojnë parimin el-emru bi’l-ma’rufi ve’n-nehju ani’l-munker, domethënë, i urdhërojnë njerëzit për të mirën dhe i ndalojnë ata nga e keqja.²

el-Emru bi’l-ma’rufi ve’n-nehju ani’l-munker është një parim shumë përfshirës dhe i gjithanshëm. Ky parim siç përfshin thirrjen e njerëzve për mirësi dhe zbatimin e dispozitave të ndëshkimeve, përfshin edhe ndalimin nga e keqja me anë të rrugëve ligjore. Për këtë arsye ky parim është farz kifaje, domethënë, nëse një pjesë e umetit e kryen, të tjerëve u bie përgjegjësia apo nëse askush nuk e kryen, atëherë të gjithë konsiderohen mëkatarë. Kjo për arsye se ky parim është prej çështjeve që kërkojnë dije dhe autoritet, të cilat nuk i ka çdo individ i umetit. Nëse njerëzit e paditur dhe ata që s’kanë autoritet tentojnë ta kryejnë këtë punë, mund të shkaktojnë gabime të parikuperueshme dhe kaos. Prandaj, pjesën e kësaj pune në lidhje me gjuhën duhet ta kryejnë dijetarët dhe pjesën në lidhje me autoritetin duhet ta kryejnë autoritetet. Në disa ajete para këtij ajeti që e lavdëron umetin, thuhet:

“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.” (Al Imran, 104)³ Megjithëkëtë, ata njerëz që nuk kanë dije dhe autoritet nuk do të thotë që të mos ndalojnë nga e keqja. Edhe këta të paktën duhet ta urrejnë me zemër të keqen, duhet të mbajnë qëndrim kundër saj dhe duhet ta bëjnë të qartë anën e tyre. I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë në një hadith fisnik që është i njohur për ne të gjithë: **“Kushdo prej jush që sheh ndonjë të keqe, le ta rregullojë me dorën e tij! Nëse nuk ka fuqi për ta bërë këtë, le ta rregullojë me gjuhën e tij! Nëse nuk ka fuqi për ta bërë edhe këtë, atëherë le ta urrejë me zemrën e tij! Ndërkohë ky është besimi më i dobët!”** (Muslim, Iman, 78.)

Parimi el-emru bi’l-ma’rufi ve’n-nehju ani’l-munker që mundëson

1. Al Imran, 3/110.

2. Çdo vepër që dihet se është e mirë me mendje apo sheriat është maruf, ndërsa e kundërta është munkër. Shik. Ragib, Mufredatu elfazi’l-Kur’ani’l-Kerim, lënda «arfb».

3. Shik. Bejdavi, Envaru’t-Tenzil ve Esraru’t-Te’vil, (Al Imran, tefsiri i ajetit 104.)

lavdërimin e umetit me cilësinë “umeti më i mirë”, para së gjithash duhet të zbkurohet me mirësinë dhe pastaj dëlirjen nga gjërat e këqija që janë të ndaluara. Nëse dikush urdhëron të mirën ndërkohë që nuk e vepron vetë dhe ndalon nga e keqja ndërkohë që e bën vetë, ai asnjëherë nuk mund të jetë bindës dhe influencues. Ndër të tjera, për ta mbajtur në këmbë këtë parim duhet një shoqëri në të cilën udhëheqësit dhe të udhëhequrit të jenë të bashkuar dhe në të cilën u vihet veshi të diturve, sepse, në ajetet paraardhëse të këtij ajeti që shpreh këtë lavdërim ka shumë specifika që e tregojnë këtë. Ndër këto specifika mund të përmendim: Allahu Teala ua kujton arabëve, të cilët gjendeshin në buzë të greminës së zjarrit për shkak të luftërave ndërmjet tyre, se i shpëtoi nga ai rrezik në sajë të mirësisë së Islamit. Allahu Teala i urdhëron ata që të kapen fort pas fesë së Tij dhe të mos bien në përçarje si umetet e mëparshme. Allahu i Madhëruar i paralajmëron ata se do të marrin dënim të tmerrshëm dhe se do të ndëshkohen në ahiret nëse bien në përçarje, etj...⁴ Për këtë arsye, shkaqeve që e bëjnë këtë umet të meritojë cilësinë “umeti më i mirë” duhet t’i shtojmë edhe unitetin dhe bashkimin.

Mirë, por si do të sigurohet/arrihet mbajtja e unitetit dhe bashkimit? A nuk do të ketë asnjë që do të mendojë ndryshe në këtë umet? Ndërkohë në themelin e ndarjes gjendet diversiteti në mendime dhe orientime. Përderisa natyrat, mendimet dhe këndvështrimet e njerëzve të jenë të ndryshme, rënia e tyre në kontradikta do të jetë e pashmangshme. Edhe sahabët e nderuar të cilët kanë qenë marrësit e parë të këtij lavdërimi hyjnor dhe të cilët e kanë merituar atë siç shprehet në shumë ajete kuranore⁵, kanë pasur kundërshtime ndërmjet tyre në disa tema. Ndër këto tema, për të cilat kanë rënë në kundërshtime, ka pasur edhe çështje të akides si “ru’jetullah/shikimi i Allahut”. Nisur nga këto që thamë, një pjesë e kundërshtimeve mund të tolerohen. Transmetohet se edhe i Dërguari i Allahut, alejhi’s-salam, ka thënë në lidhje me këtë çështje: “Kundërshtimet (ndërmjet besimtarëve) e umetit janë mëshirë.”

Ndërsa në krye të kundërshtimeve të cilat i qorton Kurani Fisnik dhe që na ndalon prej tyre janë kundërshtimet me natyrë përçarëse që e shkatërrojnë unitetin dhe bashkimin. Atëherë le ta shtrojmë pyetjen kështu: Si do të arrihet mbajtja e unitetit dhe bashkimit meqë njerëzit bien në kundërshtime për shkak të mendimeve, orientimeve dhe natyrave të tyre?

Kjo pyetje ka një përgjigje të lehtë: Moskonsiderimi i kundërshtimeve, të cilat burojnë nga natyra



e njerëzve, si shkaqe ndarjeje, do të thotë të mos i përjashtosh ata që mendojnë ndryshe.

Këtu duhet të kujtojmë edhe një cilësi tjetër shumë të lavdëruar me të cilën është cilësuar umeti: Umeti vasat, domethënë, umeti mesatar. Feja e umetit mesatar është larg ifratit dhe tefritit. Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e ka përshkruar këtë fe në formën “feja e pastër tolerante”. Reflektimet më konkrete kundrejt atyre që mendojnë ndryshe i gjejmë në veprimet e Aliut, (r.a.). Aliu, Havarixhëve, që u ndanë prej tij me arsyen se ai pranoi zgjidhjen e gjykatësve për kundërshtimet ndërmjet tij dhe Muavije ibn Sufjanit, u dha leje të luftonin në ushtrinë e tij kundër qafirëve dhe të merrnin pjesë nga plaçka e luftës. Në këtë sjellje të Aliut (r.a.), shihet qartë përpjekja e tij për ta mbrojtur unitetin e bashkimin politik dhe për të qëndruar larg përçarjes duke e lënë mënjane kundërshtimin mental, sepse rreziku më i madh për një shoqëri është largimi nga uniteti dhe rënia në përçarje. Siç e shprehëm edhe më sipër, edhe sahabët e nderuar kanë pasur tema për të cilat e kanë kundërshtuar njëri-tjetrin. Por kur këto kundërshtime në lidhje me xhihadin arritën në një pikë që e lëkundën unitetin dhe bashkimin, atëherë dolën në pah fitne të mëdha si Xhemeli dhe Siffini.

Tani le të shqyrtojmë gjendjen reale të umetit:

Nëse dikush e sheh gjendjen tonë nga jashtë për hir të Allahut, a mund ta pranojë se ky umet është umeti i cilësuar me atributin “umeti më i mirë”? Le ta lëmë mënjane pranimin e kësaj prej dikujt nga jashtë dhe ta shtrojmë pyetjen në këtë mënyrë: Cili

4. Shik. Al Imran, 103-107.

5. Shik. Al Imran, 172-174; Ahzab, 23; Fet’h, 18, 29.

prej nesh mund t'i flasë me krenari për këtë cilësi diku nga jashtë ndërkohë që ne jemi në këtë gjendje? Mos vallë është përgënjeshttrim i Kuranit Fisnik shtrimi i këtyre pyetjeve? Zoti na faltë!

Umeti që Kurani Fisnik e cilëson “më të mirin” dhe “mesatar”, është umeti që i mbart kushtet të cilat i përmendëm më lart dhe jo umeti që mbart vetëm një emër të thatë. Ne sigurisht nuk mund t'i mbyllim sytë ndaj atyre që po ndodhin dhe ta mohojmë realitetin.

Luftërat e sekteve që evropianët i kanë bërë dhe përfunduar në shekujt e mesjetës, ne po i nxisim përsëri në shekullin e 21-të. Le ta pranojmë: Lufta në Irak, Liban dhe veçanërisht në Siri nuk është gjë tjetër përveçse lufta Sunit-Shiite. Një zënkë që ka ndodhur ndërmjet Ali ibn Ebi Talibit (r.a.) dhe Muavije ibn Ebu Sufjanit (r.a.), po e vazhdojmë me këmbëngulje dhe inat edhe pse kanë kaluar afërsisht katërmëdhjetë shekuj nga vdekja dhe kalbja e kockave të tyre.

Kjo ndoshta mund të kundërshtohet në formën: “Kjo nuk ka lidhje me fenë, sepse është përplasje me natyrë politike!” Por edhe nëse është kështu, a nuk është e qartë se në esencën e kësaj çështjeje gjendet përsëri përplasja e sekteve? Po, kjo është një e vërtetë aq e qartë saqë nuk mund ta mohojë askush. Pastaj, sa mund të shqyrtohen ndarazi nga njëra tjetra feja dhe politika në historinë islame? A nuk patën dalë në fillim si lëvizje politike medhabetet e itikadit si Havarixhët dhe Shiizmi?

Myslimanët përgjatë gjithë historisë mendojnë se nuk kanë rënë më poshtë se tani, në këtë kohë

që po jetojmë. Në këtë gjendje kaq të dobët nuk kanë rënë as në kohën e kryqëzatave, as në kohën e pushtimit mongol dhe as në kohën kur u kolonizua e gjithë bota islame dhe u shkatërrua Shteti Osman... Ne tashmë kemi rënë në një gjendje aq të dobët saqë kërkojmë mëshirë nga ndërhyrja e jomyslimanëve.

Nisur nga ato që thamë më lart, tashmë kundërshtimet ndërmjet nesh nuk duhet t'i lejojmë që të nxjerrin përçarje dhe armiqësi. Tashmë duhet t'i kërkojmë dhe t'i gjejmë mënyrat për ta formuar unitetin dhe bashkimin të cilët janë kusht i domosdoshëm për ta zbatuar parimin el-emru bi'l-ma'rufi ve'n-nehju ani'l-munker dhe për t'u bërë umeti më i mirë që e meriton lavdërimin hyjnor. Mënyra për ta arritur këtë nuk është që ta bëjmë sunitin shiit apo shiitin sunit. Në të vërtetë, me imponim as suniti nuk bëhet shiit dhe as shiiti nuk bëhet sunit. Tani po jetojmë në një kohë që duhet ta kujtojmë më së shumti se jemi umeti mesatar, se feja jonë është fe e tolerancës dhe se duhet t'i marrim parasysh më shumë se kurrë veprimet e Ali ibn Ebi Talibit (r.a.).

Unë nuk po them se këto cilësi dhe sjellje të mos i kujtojmë edhe për të tjerët, por sipas jush, a nuk ka një ironi të madhe në organizimin e mbledhjes së dialogut ndërfeetar në Katar ndërkohë që në Siri sipas regjistrimeve janë vrarë mbi njëqind mijë njerëz dhe me miliona të tjerë janë detyruar të arratisen nga vendi i tyre për shkak të kësaj lufte mizore apo masakre barbare që akoma vazhdon dhe që në thelbin e saj ka fanatizmin sektar?





SPROVA DHE VUAJTJA

— Ali Byjyqçapar —

Do të ishte një perceptim i gabuar nëse faktin që mendja është kaq e ngatërruar do ta konsideronim si një veçori e ditëve të sotme. Nëse i studiojmë shoqëritë njerëzore që nga e djeshme e deri te e nesërmja, do të vihet re se ekziston kanali i cili quhet sitaru'l-mustekim / rruga e drejtë. Fenomenet themelore që i kanë nxjerrë në pah leximet të cilat bëhen duke vendosur në qendër pejgamberët janë këto: Ekzistenca, dija dhe morali. Të qenët orientues me mendje, përvojë dhe vizion, që janë koncepte themelore me të cilat është mbrujtur historia njerëzore, nganjëherë u hap derën problemeve të mëdha nëpër rrugë pa krye. Islami është feja e fundit të cilën Allahu e ka dërguar nëpërmjet Pejgamberit dhe ky Pejgamber është Muhamedi. Ata që pranojnë një fe tjetër përveç fesë islame e cila është ndërtuar mbi vlerat e besimit, ibadetit, moralit, drejtësisë, ekonomisë dhe estetikës, nuk mund ta shpëtojnë veten kundrejt përgjegjësisë që kanë ndaj Allahut (xh.xh.). Islami është feja e fundit e Allahut!

Njeriu ka nevojë për ta përvetësuar një fe. Kjo është një domosdoshmëri. Mungesa e fesë është një fatkeqësi që e shkatërron shpirtin. Sa e dhimbshme është mosmarrja në konsideratë e vlerave që kanë lënë religjionet në historinë e njerëzimit! Çfarë do të fitojmë duke mos i marrë në konsideratë strukturat fetare që gjenden para syve tanë duke filluar që nga ato arkitekturoret? A nuk janë shkallët e sprovës së njeriut koha që kalon dhe ndryshimet e pafundme? Këtu shfaqet e fshehta e të qenët Islam emri i parë i përvojës së jetës që shekujt na e kanë sjellë si dhuratë.

Emri i fesë së pranuar te Allahu është Islam! Mirë, por cilat janë veçoritë që ia kanë dhënë Islamit këtë universalitet?

a- Feja islame është feja e fundit. Hebraizmi dhe krishterimi janë fe që e kanë humbur origjinalitetin dhe që nuk mund ta plotësojnë nevojën e njerëzimit. Hebraizmi është feja kombëtare e çifutëve që mbështetet tek themeli i racizmit. Ndërsa krishterimi nuk është një fe që e përfshin të gjithë jetën e njeriut. Krishterimi është një fe e ndërtuar mbi parimin e dashurisë dhe flijimit. Ajo nuk e mbart dot këtë barrë dhe besimi i trinitetit e nxjerr jashtë funksioni mendjen. Ndërsa perdja e fshehtësisë e ka bërë jetën të pajetueshme.

b- Ftesa e fesë islame është e përgjithshme. Prova që do të jepet kundrejt kohës ndoshta shfaqet këtu. Njerëzimi edhe një herë tjetër do të sprovohet me kohën. Islami nuk është feja e një populli të caktuar apo e ndonjë periudhe të caktuar. Ajo është dërguar për të gjithë njerëzit që do të vijnë deri në ditën e kiametit. A nuk është ky shkaku që Pejgamberi u ka dërguar letra e korrierë Egjiptit, Persisë dhe Bizantit? ***“Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë.”*** (Sebe', 28)

c- Islami e ka mbrojtur vazhdimësinë e dijes duke i aprovuar pejgamberët dhe librat hyjnorë të mëparshëm. Në këtë mënyrë e ka vazhduar rrjedhën e dijes.

d- Islami është feja e lehtësimit. Allahu na e ka dërguar fenë jo për të na shtypur dhe dërmuar, por për të na dhënë një jetë më të bukur dhe sublime. Kështu është formuar edhe mistika islame e cila lufton kundër botëkuptimit që e fshin njeriun dhe që nuk ka aspak konsideratë për të. Çmimi i mosmarrjes në konsideratë i rrjedhës së urtësisë që vazhdon për vite të tëra duke dhënë si pretekst disa shembuj të gabuar, është shumë i rëndë. Fusha e psikologjisë fetare në ditët e sotme nuk e përfshin dot të gjithë njerëzimin. Nuk është pa qëllim sjellja në rendin e ditës së kulturave të vjetra për shpirtin çlirues. Patjetër duhet të ketë mësim që mund të nxirren nga konvertimi në shoqata i teqeve që kanë mirëpritur me dhjetëra arte të bukur me në krye muzikën. Sa shumë që ka nevojë njerëzimi në ditët e sotme për fenë islame e cila e mbron mendjen, jetën, pasurinë, nderin dhe mendimin. Të kuptuarit e devijimeve që kërkohet të futen brenda Islamit, i cili e ngjall çdo fushë të jetës nëse i shohim lehtësimet që u janë bërë ibadeteve, është një largpamësi e rëndësishme për besimtarin. ***“Lehtësoni dhe mos vështirësoni! Përgëzoni dhe mos frikësoni!”*** (Buhari)

Dy fjalë që i do ALLAHU

— Irfan Ēzturk —

Në sahihun e Muslimit transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.), se i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ka thënë: *“Ka dy fjalë që janë të lehta për gjuhën, të rënda në peshore dhe të dashura për Allahun Teala. Këto dy fjalë janë ‘Subhanall-llahi ve bihamdihi, Subhanall-llahi’l-adhim”*.

Këto dy fjalë çdo besimtar duhet t'i thotë gjithmonë dhe kuptimet e tyre duhet t'i mbajë në zemër, sepse këto dy fjalë të bekuara kanë brenda dije të begata dhe kuptime të thella.

“Subhanall-llah” do të thotë: “O Allah! Ti je larg çdo gabimi dhe mangësie. Ti nuk ke asnjë gabim dhe mangësi. Të kërkoj mbrojtje Ty nga besimet e devijuara dhe nga besimi i atyre që kanë besime të devijuara.” Duke thënë: “Ve bihamdihi” – jemi shprehur se Allahu Teala, i Cili i ka krijuar të gjitha mirësitë dhe ua ka dërguar ato të gjitha krijesave në këtë botë, është larg cilësive të mangëta dhe se të gjitha atributet e Tij janë të përsosura.

Secila anë e peshores është e madhe sa qielli. Allahu Teala, i Cili është bujar dhe dhurues i mirësive, ka premtuar për të dhënë sevape aq shumë sa për ta mbushur peshoren. Kështu, transmetohet se

Shuajbi, alejhi's-selam, në një lutje të tij iu përgjërua Allahut të Madhëruar që t'i tregonte peshoren. Kur Shuajbi, alejhi's-selam, e pa peshoren madhështore, tha: “O Zot! Kush ka mundësi ta mbushë këtë?” Zoti i botëve, i Cili është bujar dhe i mëshirshëm, i tha:

“O Shuajb! Unë e mbush plot me sevape peshoren kur rob i Im thotë vetëm një herë “Subhanall-llahi ve bihamdihi”.”

O vëlla dhe motër! Preokupoje gjuhën tënde me dhikër të sinqertë e të dëlirë!.. Mbushe peshoren tënde me sevape!..

Përsëri në Sahihun e Muslimit transmetohet se Xhujerija, radijallahu anha, e cila ishte njëra prej bashkëshorteve të sultanit të profetëve, Muhamedit, alejhi's-selatu ve's-selam, ka thënë:

Një ditë, pasi i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e fali namazin e mëngjesit, doli herët nga shtëpia. Paradite u kthye përsëri në shtëpi. Kur u kthye më pyeti: “A je marrë me dhikër këtu që kur u largova prej teje?” Unë iu përgjigja: “Po.” Nisur nga kjo përgjigje, i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, më tha: “Këto katër fjali



që i kam thënë tri herë pasi jam larguar prej teje, nëse do të peshoheshin me dhikrin që ke thënë që nga mëngjesi, do të ishin të barabarta me të nga aspekti i sevapit: Subhanall-llahi ve bihamdihi adede halkihi ve rida nefsihi ve zinete arshihi ve midade kelimatihi / E falënderoj Allahun dhe dëshmoj se Ai është i pastër nga cilësitë që nuk i kanë hije pozitës së Tij si Zot aq sa numri i krijesave të Tij, aq sa Ai kënaqet, aq sa është i rëndë Arshi i Tij dhe aq sa numri i fjalëve të Tij që nuk mbarojnë asnjëherë.” (Muslim, Dhikr, 79.)

Tani myslimanët nuk duhet ta lënë asnjëherë këtë dhikër dhe duhet të fitojnë shumë sevape.

O vëlla dhe motër! Ki kujdes dhe mos e lër këtë mundësi të të ikë! Mos u mposht prej shejtanit të mallkuar!..

Sa shumë mundësi që ka! Ja edhe një mundësi tjetër: Sa’d ibn Ebi Vakkas, radijallahu anh, tregon: “Po qëndronim bashkë me të Dërguarin e Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të. Ai tha: “A jeni të paaftë t’i fitoni çdo ditë një mijë sevape?” Dikush e pyeti: “O i Dërguari i Allahut! Si mund të fitohen një mijë sevape?” Pejgamberi ynë i nderuar tha: “Atij që thotë njëqind herë ‘Subhanall-llah’ i shkruhen një mijë sevape ose i fshihen një mijë mëkate.” (Muslim, Dhikr, 37.)

Përgëzime për atë besimtar që i bën dhikër /e përmend Allahun Teala çdo ditë e çdo natë! Për sa i përket të shprehurit të vlerës së përmendjes së Allahut dhe madhërimit të Tij, tregohet një histori e tillë:

“Hija i kishte thënë pemës: Ne të dyja jemi shoqe. Bashkë kemi ardhur në këtë botë dhe bashkë jemi rritur. A të ka hije që gjithmonë të jesh perde ndër-mjet meje e diellit dhe të më pengosh që të mos e shoh atë? Kurdo që dielli anon nga unë, ti hyn ndërmjet nesh. Përse e bën diçka të tillë?”

Pema iu përgjigj: Jo, unë kurrë nuk jam pengesë për ty. Unë e shoh diellin për shkak se rri në këmbë natë e ditë duke i bërë dhikër Allahut Teala. Ndërsa ti gjithmonë fle gjumë. Atëherë si mund ta shohësh diellin me këtë gjendje që ke?”

O vëlla dhe motër! Hapi sytë! Fuqia e Allahut Teala duket në çdo gjë. Mbroje gjuhën dhe veshët e tu nga gjërat e këqija, në mënyrë që të jesh afër Allahut (xh.xh.).

Në Sahihun e Muslimit transmetohet nga Ebu Dherri, radijallahu anh, se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Secili prej jush duhet të japë lëmoshë për çdo kyç (dhe kockë). Nisur nga kjo, çdo tespîh (subhanall-llah) është lëmoshë, çdo hamd (el-hamdu li’l-lah) është lëmoshë, çdo tehlîl (la ilahe il-la’l-llah) është lëmoshë dhe çdo tekbîr (Allahu ekber) është lëmoshë. Këshillimi për të mirë është lëmoshë dhe ndalimi nga e keqja është lëmoshë. Dy rekatë namaz

që robi mund t’i falë paradite, ua kalojnë këtyre.” (Muslim, Musafirin, 84.)

Ademi, alejhi’s-salam, i tha Zotit:

“O Zot! Ti dëshiron që të preokupohej me punë për të fituar. Atëherë më mëso një fjalë që t’i përfshijë të gjitha falënderimet dhe të zërë vendin e të gjitha tespiheve!”

Allahu Teala i dërgoi shpalljen:

“O Adem! Në mëngjes dhe mbrëmje thuaje këtë tri herë: Elhamdulil-lahi Rabbi’l-alemin. Hamden juvafi niamehu ve jukafi mezideh.”

Kjo fjalë i përfshin të gjitha falënderimet dhe tespihet.

Jahja bin Muadh er-Razi, rahmetullah alejh, iu përgjëronte kështu Zotit në lutjen e tij: “O Zot! Edhe nëse i kryej të gjitha ibadetet, nuk mund ta hap gojën dhe të them ndonjë gjë nëse nuk më jep asnjë sevap për to! O Zot! Nëse do të më pyesësh për mëkatet e mia Ditën e Kiametit, do të të them: “Ku janë thesaret e mëshirës Tënde?” Nëse do të më fusësh në Xhehenem me mëkatarët, aty do të flas për dashurinë ndaj Teje.” Pasi Jahja bin Muadh er-Razi e mbaroi në këtë mënyrë lutjen e tij, dëgjoi një zë që i tha:

“O Jahja! Allahu, xhel-le ve ala, i ndan miqtë nga armiqtë e Tij. Ndërsa miqtë i nderon.” Pasi Jahja e dëgjoi këtë, menjëherë doli nga shtëpia, shkoi në qytet dhe filloi të bërtiste:

“Sado që të jem mëkatar, nuk e shpëtoj shpresën nga mëshira e Allahut Teala. Unë e kam mik Atë. Edhe Ai më ka mik mua.”

Transmetohet se një njeri i prishur dhe mëkatar u sëmur një ditë. Ai e kuptoi se po vdiste. Atij iu shfaq libri i veprave. Ai vuri re se nuk kishte asnjë mirësi, por përkundrazi e kishte të mbushur plot me mëkate. Për këtë arsye, u pendua dhe nxori një rënkim të sinqertë nga shpirti e zemra duke thënë: “Ah!” – dhe pastaj u shpreh:

“Nëse njeriu bën një mëkat, duhet të pendohet një mijë ditë,

Unë kam një mijë mëkate, o Zot, por asnjë ditë nuk jam penduar..

O poseduesi i kësaj bote dhe i botës tjetër! Fale këtë robin Tënd të varfër që s’ka pasur gjë në këtë botë dhe nuk do të ketë gjë në botën tjetër!..”

Ai ndërroi jetë në këtë mënyrë. Në mbrëmje, banorët e Basrës panë në ëndërr se në filan vend kishin ndërruar jetë një mik i Zotit. Në ëndërr iu tha: “Kushdo që e fal namazin e xhenazes së tij, do t’i falen të gjitha mëkatet dhe do t’i pranohen të gjitha adhurimet.” (Historia e Alltënparmakut)



Islami ËSHTË ÇLIRIM i zemrave

— M. Ali Eshmeli —

Në esencën e të gjitha çlirimeve që kemi bërë përgjatë historisë ka një mesazh: Përgëzimi i Pejgamberit (a.s.). Të mos harrojmë se çdo përgëzim ka edhe një kusht: Personaliteti i Pejgamberit (a.s.). E fshehta e atij personaliteti është feja e qartë, Islami. Ndërsa e gjithë shfaqja e Islamit është çlirimi i zemrave. Ja, zemrat që u përsosën duke e kuptuar këtë të fshehtë dhe që iu drejtuan çlirimeve të mëdha me këtë pjekuri sublime, u bënë çliruese në kuptimin e vërtetë, sepse ato e morën mesazhin e çlirimit nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Atë e bënë qëllim dhe dashuri. Këtij qëllimi dhe kësaj dashurie nuk i shtuan asnjë pikë tjetër të ndryshme dhe flijuan jetët e çdo gjë të tyre për t'i realizuar ata me pastërti shpirtërore, sepse ata e perceptuan se çlirimi i zemrave është specifika më e rëndësishme në mesazhin e çlirimit. Për këtë arsye, qëllimi i atyre asnjëherë nuk ka qenë një luftë e thatë. Ata nuk kanë hyrë në beteja të përgjakshme. Gjithashtu nuk u bënë kurbane të dëshirës së zjarrtë për të mos lënë gurë mbi gurë dhe kokë mbi supë.

Ata gjithmonë e kuptuan saktë mesazhin e çlirimit. Në sajë të kësaj, shkruan legjenda të mëdha me perceptimin se çlirimi nuk është vrasje por gjallërim. Shtetet dhe kontinentet që i panë ata, nxituan për t'u futur në Islam. Kështu është bërë myslimane Afrika, kështu është bërë myslimane Andaluzia, kështu është bërë mysliman Turkistani, kështu është bërë mysliman Anadoli, kështu është bërë mysliman

Ballkani dhe kështu është bërë Stamboll / qyteti i Islamit Kostandinopoja. Kështu kanë arritur të zgjerohen kufijtë e gjeografisë sonë deri në njëzet e katër milion kilometra. Ndërsa kufijtë tanë shpirtërorë kështu e morën në vete të gjithë botën, sepse qëllimi gjithmonë ishte zemra, gjithmonë ishte në zemër dhe gjithmonë ishte prej zemrës. Sepse kjo ishte edhe e fshehta e çlirimit në përgëzimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.) edhe e vërteta. Për këtë arsye, shumë herë në historinë e Islamit, faqet e vetme që duhet të shihen për ta parë dhe kuptuar qartë esencën e të gjitha çlirimeve, në të cilat është arritur edhe e pamundura, janë fletë të arta e të pashoqe të mbushura plot me çlirimet shpirtërore të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, që nuk mund të fshihen nga historia, sepse edhe luftërat e atij (a.s.), në të vërtetë ishin të stolisura nga fillimi e gjer në fund me çlirimin e zemrave.

Kur të shtjellohen me kujdes kujtimet e shenjta të atij (a.s.), në çdo luftë, do të shihet qartë se edhe fitorja në Bedër ishte çlirim i zemrave. Edhe përvoja në Uhud ishte çlirim i zemrave. Edhe suksesi në Hendek ishte çlirim i zemrave. Edhe legjenda në Hajber ishte çlirim i zemrave. Edhe durimi dhe vendosmëria madhështore në Tebuk ishte çlirim i zemrave. Ndërsa marrja e Mekës realizoi një çlirim plotësisht tjetër të zemrave. Për sa i përket Medines, ajo në të vërtetë, krejtësisht ishte çlirim i zemrave.

*Kurani Fisnik filloi t'i
hynte në zemër. Drita
e udhëzimit i reflektoi
edhe në shpirt, edhe në
fytyrë. Andaj tha me një
entuziazëm dhe admirim
të madh: "Sa fjalë e bukur
dhe sublime që qenka kjo!
Çfarë duhet të bëj për të
hyrë në Islam?"*

Sahabi i ri, Mus'abi (r.a.), i cili shkoi në Medinë me urdhrin e të Dërguarit të Allahut, alejhi's-salam, për t'ua predikuar dhe mësuar Islamin banorëve të saj, arriti begati të mëdha dhe u bë shkak për përhapjen e Islamit. Një ditë shkoi në bahçen e Beni Zaferëve bashkë me Es'ad ibn Zuraren, në shtëpinë e të cilit rrinte. Ndërkohë që ata po bisedonin në krye të pusit, Sa'd ibn Muadhi, i cili ishte prej Beni Abduleshhelëve, i tha Usejd ibn Hudajrit: "O Usejd! Ti je një njeri që nuk ke nevojë për ndihmën e të tjerëve. Edhe punën tënde di ta bësh mjaft mirë. Andaj, shko te ata burra që kanë ardhur në lagjen tonë për t'u ndryshuar besimin të dobëtëve tanë dhe largoji nga aty! Këtë mund ta bëja edhe vetë, por siç e di, Es'adi është i afërmi im."

Usejdi u nxit nga fjalët që dëgjoi. Andaj, menjëherë e mori heshtën, u hodh në këmbë, shkoi te ata dhe u foli më shumë zemërim dhe kërcënim: "Çfarë pune keni ju këtu? O Es'ad! A na e ke sjellë këtë të huaj që të prishë besimin e të dobëtëve ndërmjet nesh? Bëj kujdes dhe asnjëherë mos tento ta bësh edhe një herë diçka të tillë! Nëse nuk doni të vdisni, largohuni menjëherë nga ky vend!" Mus'abi (r.a.), i cili ishte i urtë dhe i zgjuar, iu përgjigj me qetësi: "A nuk dëshiron të ulesh dhe të dëgjosh ato që do të të them? Me sa shoh, keni një personalitet me mendje të shëndoshë. Dëgjo! Nëse nuk i pëlqen ato që do të të them, mos i prano! Ti mund t'i pranosh ato vetëm nëse i pëlqen!" Usejdi u qetësua dhe i tha: "Kjo që më the është një qasje e logjikshme dhe e drejtë." Pastaj e nguli në tokë heshtën që kishte në dorë, u ul dhe filloi ta dëgjonte. Mus'abi, radijallahu anh, ia shpjegoi Islamin duke i lexuar Kuran. Usejdi u zbut prej atyre që dëgjoi. Kurani Fisnik filloi t'i hynte në zemër. Drita e udhëzimit i reflektoi edhe në shpirt, edhe në fytyrë. Andaj tha

me një entuziazëm dhe admirim të madh: "Sa fjalë e bukur dhe sublime që qenka kjo! Çfarë duhet të bëj për të hyrë në Islam?" Pastaj mori gusull ashtu siç e mësoi Mus'abi dhe Es'adi. Po ashtu veshi edhe roba të pastra. Pastaj tha plot sinqeritet edhe shehadetin. Pastaj filloi namazin dhe fali dy rekatë. Pastaj tha:

"Atje pas gjendet një njeri që nëse lidhet me ju, asnjë prej fisit të tij nuk do të kundërshtojë. Ai është Sa'd ibn Muadhi. Menjëherë po shkoj te ai dhe po e dërgoj te ju." Edhe Sa'd ibn Muadhi ishte mjaft i zemëruar kur shkoi atje. Por pasi e dëgjoi në të njëjtën mënyrë Mus'abin, edhe ai besoi duke e pranuar Islamin me gjithë zemër. Menjëherë pasi e pranoi Islamin, e mblodhi fisin e tij dhe i pyeti të gjithë pjesëtarët e fisit: "Si më njihni mua, o Beni Abduleshhelë?" Të gjithë iu përgjigjën: "Ti je i nderuari ynë. Edhe nga aspekti i mendimit je prijësi ynë dhe më i zgjuari prej nesh." Atëherë Sa'di u bëri këtë deklaratë: "Unë nuk do të flas as me gratë dhe as me burrat tuaj derisa ju t'i besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij duke thënë shehadetin." Në këtë mënyrë, deri në mbrëmje të gjithë pjesëtarët e këtij fisi hynë në Islam atë ditë. (Ibn Hisham, II, 43-46; Ibn Sa'd, III, 604-605; Ibn Esir, Usdu'l-Gabe, I, 112-113.)

Për shkak të këtyre çlirimeve shpirtërore, i Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, tha: "*Medina është çliruar me Kuran.*" (Bezzar, Musned, nr: 1180; Rudani, nr: 3774.)

Ja edhe një shembull tjetër i çlirimeve shpirtërore të veçanta po nga epoka e lumturisë: Umejri ibn Vehbi... Umejri ibn Vehbi ishte i njohur me torturat dhe vuajtjet që ua shkaktoi të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe sahabëve të tij në periudhën e Mekës. Ai ishte një politeist djallëzor prej të parëve të kurejshëve. Biri i tij Vehbi pati rënë rob në luftën e Bedrit. Kur një herë po bisedonin për ato që kishin ndodhur në Bedr, miku i tij, Safuan ibn Umejje i tha Umejrit: "Betohem se është e kotë të jetojmë pas kësaj gjendjeje!" Umejri u acarua dhe tha: "Betohem se kjo që the është e drejtë. Po të mos kisha borxhet dhe familjen për të cilën kam frikë se vdesin nga uria pas meje, patjetër do të ngrihesha menjëherë dhe do të shkoja për ta vrrarë Muhamedin. Mbi të gjitha, kam edhe një pretekst që ata e vlerësojnë. Atyre mund t'u them se kam ardhur për birim tim që e kanë zënë rob. Përveç të tjerash, kam dëgjuar se biri im mund të dalë jashtë." Safuanit i qeshi fytyra prej këtyre fjalëve të Umejrit. Andaj i tha: "Mos u shqetëso! Borxhi yt tashmë është borxhi im. Do ta paguaj të gjithin. Edhe jeta e familjes tënde përderisa të jetojë më përket mua bashkë me

të familjes sime.”

Pasi Umejri e mori këtë besë, e mprehu shpatën e tij dhe e leu me helm. Mori ushqimin që ia përgatiti Safuani, i hipi kafshës së tij dhe shkoi drejt e te Xhamia e Pejgamberit. E mori shpatën dhe e lidhi devenë. Sapo Umeri e pa atë, mendoi: “Ky është armiku i Allahut, Umejri! Ardhja e atij këtu për Zotin është vetëm për ndonjë të keqe. A nuk ishte ai që na ngatërronte me kurejshit? A nuk ishte ai që e llogariti numrin tonë ditën e Bedrit dhe u tregoi kurejshëve politeistë?” Pastaj menjëherë shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe e njoftoi duke i thënë: “O i Dërguari i Allahut! Armiku i Allahut, Umejri është këtu. Mbi të gjitha, ka edhe shpatën të varur për qafe.” I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “*Sille pranë meje!*” Umeri (r.a.), e kapi atë për këllëfi të shpatës dhe e solli. Edhe ensarëve që gjendeshin aty u tha që të bënin kujdes duke u shprehur: “Rrini pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe mbrojeni atë nga ky njeri i keq! Padyshim se këtij pisi nuk i besohet!” Por i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte i qetë dhe i tha: “*O Umer! Mos e pengo atë! O Umejri! Eja pranë meje!*” Pastaj e pyeti Umejrin për shkakun e ardhjes së tij. Umejri i dha përgjigjen që kishte planifikuar: “Biri im është rob te ju. Unë kam ardhur për atë. Shpresoj që të shfaqni mirësi ndaj tij.” I Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti përsëri: “*Nëse është ashtu, përse e ke këtë shpatë në qafë?*” Umejri përsëri iu përgjigj siç e pati planifikuar: “Allahu i mallkoftë shpatat! Çfarë dobie kemi pasur prej tyre?!” I Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti përsëri: “*Më thuaj të vërtetën! Cili është shkak që ke ardhur këtu?*” Umejri këmbënguli në pretekstin e tij: “Nuk kam ndonjë shkak tjetër. Biri im është rob te ju. Unë kam ardhur vetëm për atë.” Këtë herë i Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti kështu: “*Atëherë më thuaj! Çfarë kushti i ke vënë Safuanit në Hixhr?*” Umejri u zu në befasi dhe tha: “Çfarë kushti i paskam vënë unë atij?” Së fundi i Dërguari i Allahut (a.s.), ia tregoi të gjitha fjalët një për një që ata të dy i patën bërë bashkë dhe i tha: “*Allahu i Lartësuar ndërhyri ndërmjet teje dhe asaj që deshe të bëje dhe të ndaloj.*”

Zemra e Umejrit u mbush plot me dritën e besimit kundrejt kësaj shfaqjeje. Umejri tha: “Unë dëshmoj

se me të vërtetë je i Dërguari i Allahut! O i Dërguari i Allahut! Ne gjithmonë e kemi mohuar se ty të zbret shpallje dhe të vijnë lajme nga qielli, por ja që ato paskan qenë të vërteta, sepse këtë çështje nuk e ka ditur askush përveç meje dhe Safuanit. Betohe se vetëm Allahu të ka njoftuar për këtë çështje. Falënderimi i përket Allahut që më solli këtu dhe më nderoi me Islamin në audiencën tënde.” Nisur nga ky rezultat i mrekullueshëm, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha: “*Mësojani mirë Islamin vëllait tuaj të ri! Këtë bëjeni duke i lexuar Kuran! Ndërkohë, lirojani edhe birin e tij që gjendet rob tek ne!*” Ky urdhër i të Dërguarit të Allahut (a.s.), u zbatua menjëherë dhe me përpikëri. Pastaj Umejri (r.a.), kërkoi leje duke u shprehur: “O i Dërguari i Allahut! Deri më tani u kam bërë shumë tortura të rënda besimtarëve dhe jam përpjekur për ta shuar dritën hyjnore. Tani më jep leje që të shkoj në Mekë dhe këtë herë të derdh djersë për t’i ftuar politeistët e atjeshëm te Allahu dhe i Dërguari i Tij, domethënë në Islam. Ndoshta Allahu i udhëzon edhe ata.” I Dërguari i Allahut (a.s.), i dha leje kësaj dashurie që sapo gjelbëronte në rrugën e Allahut Teala.

Ndërkohë Safuan ibn Umejje, i cili nuk dinte asgjë nga ato që kishin ndodhur, u jepte përgëzime politeistëve të Mekës duke u thënë: “Edhe pak ka ngelur, edhe disa ditë. Ka për të ardhur një lajm që do të gëzoheni të gjithë. Ai do të jetë një lajm aq i madh, saqë do t’ju bëjë ta harroni dhimbjen e Bedrit!” Ai pyeste çdo karvan që shikonte. Më së fundi, nga një kalorës erdhi lajmi se Umejri ishte bërë mysliman. Ndërkohë edhe Umejri u kthye në Mekë dhe filloi të predikonte Islamin. Ata që deshën ta ndalonin, nuk ia dolën dot mbanë. Në sajë të përpjekjeve të tij largpamëse dhe guximtare, shumë zemra u udhëzuan. Një ditë kur ishte në Qabe, u takua me Safuanin. Atij i thirri menjëherë: “O Safuan! Ti je prej të parëve tanë. A nuk e shikon se këto gjëra që i adhurojmë dhe për të cilat therim kurbane nuk janë tjetër veçse gurë të thatë?! A bën një fe e tillë?



Dëshmoj me plot bindje se nuk ka zot tjetër përveç Allahut! Gjithashtu, dëshmoj me plot bindje se Muhamedi është robi dhe i dërguari i tij!” Safuani heshti. Nuk tha dot asnjë fjalë. (Ibn Hisham, II, 306-309; Vakidi, I, 125-128; Ibn Sa’d, IV, 199-201.)

Ja, kështu u ngjall te i Dërguari i Allahut (a.s.), Umejri (r.a.), i cili shkoi për ta vrarë atë, sepse Pejgamberi (a.s.), i çliroi zemrën. Edhe Umeri (r.a.), u ngjall kur pati shkuar për ta vrarë të Dërguarin e Allahut (a.s.). Edhe mekasi i quajtur Fedale ishte njëri prej atyre që shkoi për ta vrarë të Dërguarin e Allahut (a.s.), por që u ngjall te ai...

Përgjatë çlirimit të Mekës Fedale iu afrua shumë të Dërguarit të Allahut (a.s.), me qëllimin për ta vrarë. I Dërguari i Allahut (a.s.), e dinte nijetin e keq të tij, por nuk shfaqti asnjë shqetësim apo zemërim. Vetëm hapi fletët e dhembshurisë e mëshirës dhe e pyeti: “Ti je Fedale, apo jo?” Fedale iu përgjigj: “Po.” I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “O Fedale! Pendohu dhe kërkoji falje Zotit për ligësinë që ke planifikuar brenda teje!” Pastaj i Dërguari i Allahut (a.s.), ia ledhatoi kraharorin Fedales me duart e tij të bekuara. Menjëherë Fedales i iku nga mendja ai mendimi i keq që kishte më parë, zemra iu ngroh dhe shpirti iu mbush me dritën e udhëzimit. Në këtë mënyrë, Pejgamberi u bë njeriu më i dashur për të. (Ibn Hisham, IV, 37; Ibn Kethir, es-Sire, III, 583.)

Ja çlirimi shpirtëror! Ja Islami! Ja udhëzimi!


Përsëri ishte dita e çlirimit të Mekës. Politeistët mekas që i patën bërë të Dërguarit të Allahut (a.s.), çdo lloj torture e padrejtësie dhe që i patën shkak-tuar atij shumë vuajtje e probleme, atë ditë çlirimi gjendeshin përpara tij të turpëruar. Të gjithë i kishin kokat të ulura, sepse meritonin ndëshkimet më të rënda. Ndërsa disa prej tyre meritonin vetëm dënimin me vdekje. Ata që e patën përzhënë të Dërguarin e Allahut (a.s.), nga ky qytet, tashmë kishin ardhur për të kërkuar mëshirë nga ai po në këtë qytet. Të gjithë ishin të turpëruar përpara jetimit që dikur e patën nënçmuar dhe torturuar. Tashmë po kërkonin dhembshuri nga jetimi që dikur nuk patën mëshirë

për të. Tashmë po kërkonin mirësi dhe falje nga i varfri i mjerë që dikur e patën lënë të uritur pa i vrarë aspak ndërgjegjja. Fati i të gjithëve ishte i lidhur me vendimin që do të jepte ai. Andaj po prisnin me zemra të shqetësuara, me sy të brengosur dhe me fjalë shprese. Vallë çfarë do të bëhej me ta? Të gjithë po heshtnin. Madje, mezi po merrnin frymë. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, filloi të fliste:

“O Mekas! Edhe unë po ju them siç iu tha Jusufi (a.s.), vëllezërve të tij: “**...Sot s’ka qortim për ju; Allahu ju faltë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!**” (Jusuf, 92) Hajt shkoni të sigurt! Tashmë të gjithë jeni të lirë... Sot është dita që Allahu i Lartësuar i ka forcuar kurejshët dhe i ka lartësuar me Islam...” Ja çlirimi shpirtëror! Ja Islami! Ja udhëzimi! Atë ditë zemrat vrapuan në besim dhe Islam grupe-grupe, karvanë-karvanë prej këtij çlirimi shpirtëror. (Shik. Ibn Hisham, IV, 32; Vakidi, II, 835; Ibn Sa’d, II, 142-143.) Ja, ky është çlirimi shpirtëror!

Përsëri ishte dita e çlirimit të Mekës. Ebu Sufjani ishte ulur në Qabe dhe ishte zhytur në mendime të thella. Hodhi një vështrim. Përpara ishte i Dërguari i Allahut (a.s.). Ndërsa myslimanët ecnin pas tij. Nga brenda e nxiste diçka: “Vallë, a të formoj përsëri ndonjë ushtri tjetër kundër Muhamedit? A thua të luftoj përsëri me atë?” Pikërisht në ato momente i Dërguari i Allahut (a.s.), shkoi drejt tij, iu afrua, e preku me dorën e tij të bekuar ndërmjet dy shpatullave dhe i tha: “Atëherë edhe Allahu do të të bëjë ty një të mjerë të poshtëruar.” Ebu Sufjani u tremb dhe e ngriti kokën. Kur e pa të Dërguarin e Allahut (a.s.), pohoi: “Deri më tani nuk isha i bindur plotësisht se je pejgamber. Ndërsa tani pendohem sinqerisht te Allahu për mendimet e këqija që kam pasur në mendje. Atij i kërkoj falje dhe mëshirë.” (Ibn Kethir, el-Bidaje, IV, 296.)

Ja Islami! Ja çlirimi shpirtëror! Ja çlirimi i një zemre të fituar duke duruar ndaj të gjitha armiqësive dhe sulmeve për një kohë të gjatë njëzet e një vjeçare. Padyshim se madhështia e këtij çlirimi buronte nga një pjekuri shpirtërore që mund ta realizojë atë. Kjo është një pjekuri shpirtërore që nuk e humb veten dhe durimin as në kohëra të vështira



dhe as në betejat më të përgjakshme. Gjithashtu, kjo pjekuri shpirtërore gjithmonë bëhet shkak për udhëzimin e njerëzve. Kjo është një pjekuri shpirtërore që i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ua ka mësuar shokëve të tij. Shembujt janë të shumtë:

Në çlirimin e Hajberit i Dërguari i Allahut (a.s.), ia dha flamurin Aliut (r.a.) dhe i tha: *“Ec Ali, përparo! Mos shiko djathtas e majtas derisa Allahu të të japë fitoren!”* Aliu (r.a.), u hodh përpara, por një moment ndaloi dhe e pyeti Pejgamberin pa e kthyer kokën pas: *“O i Dërguari i Allahut! Për çfarë të jetë lufta ime kundër atyre?”* I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, i tha: *“Lufto me ata derisa të thonë: ‘Nuk ka zot tjetër përveç Allahut! Muhamedi është i Dërguari i Allahut!’ Kur ta thonë shehadetin, përderisa nuk i shkelin ndalesat e fesë, i kanë të mbrojtura jetën dhe pasurinë e tyre nga ti. Atëherë i takon Allahut që ta bëjë llogarinë e atyre. (Në këtë çështje) mos nxito! Shko te ata plotësisht i qetë! Së pari ftojti në Islam! Nëse me këtë ftesën tënde një njeri bëhet mysliman, kjo është më e mirë për ty se sa të të jepen deve të kuqe!..”* (Buhari, As’habu’n-Nebi, 9; Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 32-34; Hejsemi, VI, 151.)

Ja çlirimi shpirtëror! Ja udhëzimi i Islamit!

Ja kështu çliruan ata! Ata fituan zemra pa e përzier kurrë nefsin në këtë çështje, sado që të ishte i shtrenjtë çmimi që paguan. Ata asnjëherë nuk harruan se zemra është zemër vetëm nëse nuk përzihet nefsi. Sahabët e nderuar u edukuan me mësimin e përvojën e kësaj dhe arritën pikat më kulmore. Kur Aliu (r.a.), po e vriste kundërshtarin e tij në një betejë të përgjakshme, menjëherë hoqi dorë nga vrasja e tij kur e pështyu në fytyrë. Këtë e bëri në sajë të urtësisë që kishte marrë nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Ndërsa tani, lëri mënjane armiqte, por ka disa prej myslimanëve injorantë që i bëhen përbindësh vëllait të tyre me pretekstin dhe zemërimin se ka bërë një vepër që nuk u pëlqen atyre. Për shkak të këtyre po shkatërrohen shumë gjëra në botë dhe veçanërisht në gjeografinë islame. Shumë prej vendeve myslimane po shkatërrohen në duart e armiqve që kanë hyrë nëpërmjet zbrazëtirave që kanë formuar disa prej organizatave viktimë nga aspekti shpirtëror. Le ta shtjellojmë edhe një herë Aliun (r.a.) dhe ngjarjen e famshme duke e hapur pak edhe më shumë:

Aliu (r.a.), e pati shtrirë për tokë kundërshtarin e tij politeist. Pikërisht në momentin kur do t’i ngulte shpatën, armiku e pështyu atë në fytyrë. Sa ofendim i rëndë ishte ajo pështymë për një fytyrë kaq të pastër! Veçanërisht në një betejë për jetë a vdekje. Kjo pështymë ishte si një shigjetë me helm që e

plaste damarin e zemërimit dhe të urrejtjes. Kjo pështymë ishte si e lehura e një qeni të zgjebosur ndaj një ariu, i përbërë i tëri nga drita. Kjo pështymë ishte një shuplakë aq shumë e pistë, saqë mund ta çmendte edhe durimin. Por çudi! Aliu (r.a.), papritur e hodhi shpatën në tokë dhe nuk ia nguli armikut. Çudi! Një sjellje kaq e keqe që ia nxit edhe më shumë zemërimin të gjithëve, atij ia shoi. Çudi! Çfarë ndodhi vallë që poseduesi i Dhulfikarit, i cili ishte rrufe në çdo luftë, këtë herë papritur u shndërrua në një re mëshire? Çudi! Një sjellje përçmuese që i ngushton kraharorët, ia zgjeroi kraharorin Aliut (r.a.). Në këtë mënyrë, ai hoqi dorë nga vrasja e armikut që e pati vënë nën këmbë. Edhe ai i mjerr, i cili u kthye përsëri në jetë pasi e pati humbur shpresën për të jetuar, u habit pa masë. Ai e pyeti Aliun (r.a.): *“O Ali! Përse hoqe dorë pikërisht në momentin kur do të më vrisje? Mos ke për qëllim të ma marrësh jetën pa shpatë?”*

Luani i Allahut, Aliu (r.a.), iu përgjigj: *“O ti që u ktheve përsëri në jetë! Dije se këtë Dhulfikar që e kam në dorë, e përdor vetëm me urdhrin e Allahut Teala. Ndërsa me urdhrin e idhullit që quhet nefsi nuk mund të lëviz as edhe një qime. Duart e mia e shkulën dhe e copëtuan derën madhështore në kalanë e Hajberit vetëm me urdhrin e Allahut. Ndërsa me urdhrin e idhullit nefsi, nuk mund të këpus qoftë edhe një gjethe. Fryma ime i copëton gurët dhe malet e larta duke gjëmuar vetëm me urdhrin e Allahut të Madhëruar. Ndërsa me urdhrin e idhullit nefsi nuk mund të nxjerrë zë as sa fletët e mizës.”*

Domethënë, o njeri! Ty të pata shtrirë për tokë vetëm për Allahun dhe do të të vrisja vetëm për Allahun. Por ti më pështyve në fytyrë. Nefsin tim e vure ballë për ballë me nefsin tënd. Atëherë puna ndryshoi. Tashmë lufta u shndërrua në luftë për fitoren e nefsit. Ndërsa unë menjëherë ia ngula shejtanit heshtën “eudhu” dhe shpatën që do të të godisja ty, ia ngula idhullit nefsi. Siç kam bërë gjithmonë, edhe këtë herë veprova sipas urdhrit të Allahut Teala. Kështu që u përpoqa të merrja vetëm pëlqimin e Tij. Domethënë u përpoqa të bëhesha prej atyre fatlumëve që gjithmonë çlirojnë zemra me një pjekuri të cilën Allahu i Lartësuar e lavdëron kështu në Kuran: ***“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka***

dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.” (Al Imran, 133-134) Për këtë arsye, ti e pe ligësinë të përshtatshme për mua, ndërsa unë pashë mirësinë të përshtatshme për ty. Ti më hodhe ferra, ndërsa unë të dhashë trëndafila. Ti zgjodhe për mua zemërimin dhe ofendimin. Ndërsa unë preferova për ty faljen dhe mëshirën.

Ti tentove të më përçmosh për të më zhytur në humbje, ndërsa unë u solla me një moral të lartë kundrejt teje. Ti dëshirove të më rrokullisje në zjarr, ndërsa unë dëshirova të të tërhiqja drejt xhenetit të Allahut Teala. Ti dëshirove të më njollosje për të më dhunuar, ndërsa unë e shtova dashurinë time ndaj mëshirës së pafundme për të të pastruar ty. Tani, o zemër e plagosur! Çfarë mendon nëse të them që të vish bashkë me mua te ajo dashuri, udhëzim dhe mëshirë? Zemra e burrit armik shpërtheu si lumenjtë prej këtyre fjalëve si perla që i dëgjoi nga morali i pashoq që e përjetoi dhe rrodhi drejt derës së dritës së udhëzimit. Dera e shenjtë u hap. Edhe ai hyri brenda pa u vonuar aspak. Ai nuk dinte çfarë të thoshte:

“O Ali! Nefsi im të paska njohur shumë gabim ngaqë të krahasoi ty me njerëzit e këqij. Diellin tënd nuk arrita ta shikoja për shkak të verbërisë sime. Ti më tregove diçka aq sublime, saqë m'u hapën edhe sytë, edhe zemra. Tashmë e shoh edhe diellin, edhe hënën. Ti u bërë dera e shpëtimit për mua. Në derën tënde hyra me dashuri. Sapo hyra, menjëherë arrita te qyteti fisnik i dijes së vërtetë dhe të pafundme. Pastaj e kuptova se qyteti i asaj dijeje të pashoqe është Muhamed Mustafai (a.s.). Tashmë edhe unë, pikërisht si ti, jam një i dashuruar që e kam lidhur zemrën me atë. Tashmë e kuptova se sulltani i peygamberëve është një dritë e atillë, saqë yjet e pashoqe e të pafundme në qiell shkëlqejnë prej saj. Këtej e tutje, pjesa e jetës që më ka mbetur le të jetë kurban për atë! Ja çlirimi i zemrave! Ja Islami! Ja udhëzimi!

Për ta arritur një çlirim të tillë shpirtëror, është e qartë se duhet të jemi besimtarë të devotshëm, sepse zemrat nuk çlirohen me asnjë urrejtje, zemërim apo padrejtësi. Nisur nga ky këndvështrim, çdo zemër nuk e ka aftësinë

për t'i çliruar zemrat, sepse kjo aftësi është mirësi jo e një jete të devijuar, por e një jete mjaft të pastër. Domethënë, një zemër nuk arrin dot ta realizojë çlirimin shpirtëror në kuptim të vërtetë pa u bërë një pasqyrë e pastër muhamedane në të cilën shikon Zoti (xh.xh.). Ndoshta mund të mbledhë njerëz si ndonjë skuadër apo mund të formojë klientë si ndonjë qendër tregtare, por në kuptimin e vërtetë nuk mund të fitojë zemra, sepse të çlirosh zemra do të thotë që t'i bësh edhe ato pasqyra muhamedane dhe t'i çosh në një pjekuri të atillë, saqë mund t'ia shfaqësh Zotit (xh.xh.). Do të thotë që zemrat me gjemba t'i shndërrosh në trëndafila dhe zemra të xhenetit. Do të thotë që të këqijtë t'i bësh të mirë. Do të thotë që ligësinë ta shndërrosh në mirësi. Do të thotë që ta bësh qafirin besimtar, ta bësh hipokritin të singertë dhe ta bësh vrasësin gjallërues. Nisur nga kjo, çlirimi i zemrave kurrë nuk është mbledhje simpatizantësh me një qasje joshëse mashtruese e të përkohshme që bëhet duke i mbyllur sytë kundrejt gabimeve fatale të njerëzve, duke i lënë ligësitë e tyre ashtu siç janë pa tentuar për t'i rregulluar dhe duke mos nxjerrë zë ndaj devijimeve të tyre që mund t'u shkaktojnë tragjedi. Edhe formimi i masave të gjera nga metoda për t'i shtirë në dorë zemrat e tyre me të njëjtën qasje të ligë, nuk është çlirim shpirtëror. Kjo nuk është gjë tjetër përveçse pushtim i njerëzimit me aftësi djallëzore dhe një lloj tjetër i padrejtësisë.

Andaj, asnjëherë nuk duhet të harrojmë se një i pavendosur që nuk e mposht dot shejtanin asnjëherë nuk mund të fitojë ndonjë zemër. Një i shkujdesur që nuk mund ta mposhtë nefsin e tij asnjëherë nuk mund të çlirojë asnjë zemër. Një mjek apo një i sëmurë që nuk mund ta mposhtë mikrobin, asnjëherë nuk mund ta arrijë fitoren që quhet shërim. Për këtë arsye, çliruesit e vërtetë shpirtërorë para së gjithash e zbatuan Islamin vetë dhe ua mundësuan edhe të tjerëve zbatimin e tij. Ata u lidhën me gjithë shpirt ndaj Allahut Teala dhe të Dërguarit të Allahut (a.s.). Nisur nga kjo, i falën zemrat e tyre dhe çliruan zemrat e të tjerëve. Ja, ky ishte një çlirim i vërtetë. Ja, nga kjo e vërtetë lindën çlirime të mëdha e të qarta. Lindi Stambolli. Përgëzimet u shfaqën njëra pas tjetrës. Për këtë arsye, ata që kërkojnë përgëzim nga i Dërguari i Allahut (a.s.), në këtë botë dhe në botën tjetër, së pari duhet të dinë mirë se si t'ia japin zemrën atij. Edhe Islamin duhet ta zbatojnë në formën më të mirë duke çliruar zemra përgjatë gjithë jetës. Lum për ata që arrijnë ta realizojnë këtë! Të bekuara qofshin përgëzimet për çlirime të reja të tyre!..

*"Dhe në një pjesë të natës zgjohu me të
(me Kuranin - namazin), është e sigurt se Zoti yt
do të të ngre në një vend të lavdishëm."*

(Isra, 79)

Një Ajet

Në ajetin e mësipërm, Pejgamberit i kërkohet të zgjohet nga gjumi në një pjesë të natës dhe të falë namaz.

Ky lloj namazi është quajtur namazi i Tehexhudit nisur nga kuptimi i kësaj fjale në gjuhën arabe.

Pejgamberi (a.s.) u ka tërhequr vëmendjen sahabeve, të cilët rrinin tërë natën zgjuar për të falur namaz, duke u thënë se është një lodhje e madhe për trupin, prandaj nuk e ka parë të arsyeshme të merren tërë natën me adhurime.

Nga sa kuptohet nga ajeti në fjalë, namazi i Tehexhudit është një adhurim që i përket vetëm të Dërguarit të Allahut. Ka nga dijetarët që mendojnë se ky adhurim është mendup dhe nafile, pra një virtyt më shumë për të Dërguarin e Allahut.

Arsyeja e një mendimi të tillë është se Pejgamberit (a.s.) i janë falur të gjitha gjynahet. Natyrisht që një gjë e tillë nuk bëhet fjalë për bashkësinë

e tij. Namazi i natës është një falje e gjynaheve të tyre.

Të tjerë dijetarë kanë theksuar se namazi i natës i quajtur Tehexhud është një farz më shumë për Pejgamberin (a.s.) i shtuar mbi pesë kohët e ditës dhe ky farz i posaçëm është për të përfocuar edhe më shumë prioritetin e tij mbi bashkësinë Islame.

Nisur nga vijimi i ajetit ***"është e sigurt se Zoti yt do të të ngre në një vend të lavdishëm"***, vendi i lavdishëm është vendi ku bëhen falënderimet dhe mirësitë. Ky post i lartë i përket Pejgamberit (a.s.).

Në Ditën e Gjykimit çdo bashkësi, apo e thënë ndryshe i gjithë njerëzimi do kërkojë të shpëtojë sa më shpejt nga ajo pritje e frikshme nëpërmjet ndërmjetësimit të Profetit dhe me të shpëtuar nga kjo pritje do ta falënderojë. Makami Mahmud mund të quhet ndryshe edhe makami shefaat.

Transmetohet nga Aishja (r.a.),
se Pejgamberi -(a.s.)-, ngrihej natën dhe falte namaz

deri në enjtjen e këmbëve. Nisur nga kjo e pyeta:

"O i Dërguari i Allahut! Pse e mundon veten kaq shumë ndërkohë që Ty të janë falur të gjitha gjynahet?"

I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

"Pse të mos jem një rob falënderues?"

(Buhari, Muslim)

SHPJEGIME

Pejgamberi (a.s.) ngrihej natën dhe adhuronte Allahun deri sa këmbët i enjteshin ndërkohë që Aishja shqetësohej shumë për këtë. Ajo mendonte se Ai bënte adhurim me frikën e gjynaheve apo me dëshirën që të falej. Prandaj ia kujtoi edhe shprehjen që zë vend në hadith "Allahu t'i ka falur të gjitha gjynahet". Prandaj ajo e pyet se përderisa Allahu të ka falur të gjitha gjynahet që ke bërë dhe ato që do bësh përse e mundon veten kaq shumë? Natyrisht i Dërguari i Allahut s'mund të rrinte në heshtje. Ai iu përgjigj se po bënte vetëm detyrën e një robi për ta falënderuar me sa kishte mundësi Allahun për mirësinë e madhe të faljes.

Sipas Aishes, i Dërguari i Allahut për një kohë të gjatë ka qëndruar me orë të tëra në këmbë duke bërë adhurim dhe këtë e shijonte me një kënaqësi tepër të madhe, por me të shtuar në peshë nisi të falte namaz i

ulur. Rrinte një kohë të gjatë ulur dhe lutej, kur donte të binte në sexhde ngrihej në këmbë, pas një farë kohe ulej në ruku dhe në sexhde sërish.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. I Dërguari i Allahut, natën bënte shumë adhurim për ta falënderonte Zotin.

2. Falënderimi për mirësinë është një detyrë njerëzore.

3. Ka shumë rrugë për ta falënderuar Allahun për mirësitë e dhëna. Kjo mund të shprehet edhe me gjuhë ashtu sikurse mund të bëhet edhe me adhurim natën siç vepronte vetë Pejgamberi (a.s.).

4. Nëpërmjet kësaj, Pejgamberi (a.s.) tregonte se kjo është mënyra më e mirë për të shprehur robërinë ndaj Allahut.

Një Hadith



LUMTURIA FAMILJARE

E DREJTA E FËMIJËVE

Kalifi Omer bin Abulazazi jetonte një jetë shumë të thjeshtë dhe modeste edhe pse ishte udhëheqësi i shtetit islam që kishte shtrirë kufijtë e tij në përmasa kolosale.

Një ditë veziri i propozoi:

“Zotëri, shuma që merrni nga “thesari i shtetit (bejtu’l-mal)” duket se nuk ju mjafton. Sikur të merrni pak më shumë në mënyrë që të kurseni diçka dhe pas vdekjes suaj t’u mbetëj fëmijëve dhe nipërve tuaj për nevojat e tyre të domosdoshme?!”

Kalifi dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

“Nëse pasardhësit e mi do jenë nga të mirët (salih), nuk druham aspak për të ardhmen e tyre, sepse Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Në të vërtetë, Mbrojtësi im është Allahu, i Cili ka zbritur Librin dhe kujdeset për të mirët.” (Araf, 196)

Nuk shqetësohem aspak për sa kohë Allahu i Lartësuar është mbrojtësi dhe kujdestari i tyre në çfarëdo situatë me të cilën mund të përballen në të ardhmen.

Në të kundërt, nëse ata do jenë nga shpërdoruesit (sefi) atëherë Allahu i Lartësuar thotë për ta në Kuran:

“Mos e lini në dorë të të paafteve mendërisht pasurinë tuaj.” (Nisa, 5)

E si mund t’i lë trashëgimi diçka fëmijëve të mi pas kësaj ndalesë hyjnore?” (Ebu’l-Ûlâ Mardin, *Huzur Dersleri*, Istanbul 1966, II-III, 769-770)

Transmetohet se Lukmani i urtë ka thënë:

“Nuk është pasuri ajo që e mbledh në dorë, e lë trashëgimi për tjetër kënd, pastaj jep llogari vetë për të.”

I Dërguari i Allahut trashëgiminë më të mirë e përshkruan me fjalët:

“Asnjë baba nuk i ka lënë trashëgimi më të mirë fëmijës së tij sesa një moral të bukur.” (Tirmidhî, Birr, 33/1952)

Pra;

Pasuria më e çmuar që mund t’u lihet pasardhësve është pajisja e tyre me moralin dhe karakterin e bukur islam. Është përpjekja për t’u lënë atyre trashëgiminë e Ahiretit. Nëse edhe ata do jenë të aftë t’u lënë të njëjtën trashëgimi brezit pasardhës, kjo do të jetë një sadaka rrjedhëse duke u bërë kështu pasuria më e madhe shpirtërore.

Në ditët e sotme nuk është e mjaftueshme të jesh thjesht një nënë apo baba biologjik. Është për të ardhur keq që fëmijët tanë po edukohen nga interneti, televizioni, moda apo reklamat. Mentaliteti dhe bota shpirtërore e brezit të ri sa vjen e po tjetërsohet. Me pak fjalë, shejtani po bëhet partner i fëmijëve tanë.

Për këtë arsye, sot është e domosdoshme të përpiqemi shumë që t’u lëmë trashëgimi fëmijëve tanë një personalitet dhe karakter islam.

As’hab Kehfi (Shokët e Shpellës) e këshillonin njëri-tjetrin në mënyrë që të ruanin besimin e tyre me fjalët:

“Me të vërtetë, nëse ju zbulojnë, ata do t’ju gjuajnë me gurë ose do t’ju kthejnë (me



forcë) në fenë e tyre dhe atëherë nuk do të shpëtoni kurrsesi.” (Kehf, 20)

Sot një prind që i kushton vëmendje dhe kujdes fesë dhe besimit të fëmijës së tij duhet të mendojë e të pyesë veten:

“A mund ta ruajë besimin fëmija im nëse shoqërohet me njerëz të prishur e të shkujdesur apo nëse krijon marrëdhënie intelektuale në një hapësirë me njerëz që e mohojnë Zotin?”

Ne duhet t’u tregojmë fëmijëve tanë se jeta e vërtetë është jeta e Ahiretit. Duhet t’i bindim ata se diploma e vërtetë është arritja e kënaqësisë së Allahut. Duhet t’u mësojmë atyre se nuk kemi ardhur në këtë botë për të bërë karrierë, por për të fituar ahiretin duke e njohur Krijuesin Fuqiplotë e duke jetuar me devotshmëri.

SHQETËSIMI PËR BREZIN

Shqetësimi për brezat tek të gjithë pejgam-berët ka qenë i njëjtë:

Ibrahimi lutej me fjalët:

“O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin!” (Ibrahim, 40)

Edukimi i Ismailit nga Ibrahimi përbën një shembull të bukur se si duhet të edukojë një baba fëmijën e tij.

Babë e bir ndërtuan së bashku Qaben e Madhnueshme. U lutën së bashku. Pastruan xhaminë së bashku. Kur u urdhërua të bëhej kurban, Ismaili iu dorëzua plotësisht urdh-rit të Krijuesit Fuqiplotë.

Shqetësimi për brezin ishte tek të gjithë pejgamberët.

Zekerija iu lut Allahut të Lartësuar t’i dhuronte një pasardhës të mirë nga frika se mos familja e Jakubit do të shkatërrohej. Kështu lindi Jahja. Ai u bë shembulli ideal i një të riu islam.

Po ashtu çdo qenie e gjallë bart me vete shqetësimin për brezin e ri. Këtë të vërtetë poeti Nexhip Fazëll e shpreh me fjalët:

“Pema që nuk nxjerr sythe, s’është gjë tjetër vetëm se një dru.”

Besimtari duhet të përpiqet t’u lërë trashëgimi brezave të rinj formimin me një personalitet dhe karakter islam. Përqendrimi i shqetësimeve të prindërve vetëm për jetën e kësaj bote, e kufizon misionin prindëror. Për të zbrapsur këtë mendësi Kurani shprehet:

“Ta dini se pasuria dhe fëmijët tuaj janë sprovë.” (Enfal, 28)

LUKMANI ﷺ

Allahu i Lartësuar në lidhje me edukimin e fëmijëve dhe ndërtimin e familjes na ka ofruar edhe shembullin e Lukmanit. Emri i këtij pejgamberi apo njeriu të urtë është përmendur në Kuranin Fisnik edhe si emri i një sureje në të cilën përfshihen këshillat e tij të vyera.

Le të lexojmë dhe të meditojmë rreth këshillave të tij:

“Ne i dhamë Lukmanit urtësinë (duke i thënë): **“Falënderojë Allahun! Kush është**

*“Asnjë baba
nuk i ka lënë
trashëgimi më të
mirë fëmijës së tij
sesa një moral
të bukur.”*

(Tirmidhî, Birr, 33/1952)

falënderues, e bën për të mirën e vet dhe, kush mohon, ta dijë se vërtet Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për lavdërim.” (Lukman, 12)

Nga tre misionet e pejgamberëve, i dyti është pastrimi shpirtëror, ndërsa i treti është mësimi i Kuranit dhe mësimi i urtësisë, diturisë së thellë fetare. Nga kjo kuptojmë që arritja e urtësisë është e lidhur ngushtë fillimisht me pastrimin shpirtëror. Për këtë arsye vetëm zemrat e pastra mund të ndriçohen nga Libri (Kurani) dhe urtësia dhe ky nivel përbën shkallën më të lartë të virtyteve.

Urtësia përbën anën e padukshme të gjërave, ngjarjeve apo ndodhive.

Në kryevepra të tilla, si Methnevia i jepet shumë rëndësi urtësisë së mësimave hyjnore.

Sipas transmetimeve, i biri dhe bashkëshortja e Lukmanit ishin idhujtarë. Lukmani si mirënjohje ndaj Krijuesit Fuqiptotë për urtësinë që i ishte dhuruar, nuk u lodh së këshilluari ata me një stil shumë të butë e të mëshirshëm.

Besimtari duhet të përpiqet t’u lërë trashëgimi brezave të rinj formimin me një personalitet dhe karakter islam.

Më në fund ata u dorëzuan përballë këtij stili mëshirues, e pranuan Islamin dhe u udhëzuan. (Ebû Hajjân, el-Bahru’l-Muhît, Lukmân, 13)

Këto këshilla fillojnë me fjalët:

“Kujtoje kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar:

“O djali im!

- Mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)!

- Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe!” (Lukman,13)

Nga këto ajete kuranore mund të nxjerrim këto mësimet:

RËNDËSIA E KËSHILLIMIT

Në ajetin fisnik thuhet:

“Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!” (Nahl, 125)

Në këtë ajet janë përcaktuar tri mënyra këshillimi në varësi të bashkëbiseduesit:

1. Ata të cilët zotërojnë një shkallë të lartë perceptimi këshilloji me urtësi.

2. Njerëzit e thjeshtë këshilloji me porosi dhe fjalë të bukura.

3. Ndërsa me njerëzit që kundërshtojnë çdo gjë diskuto në formën më të bukur.

Është e nevojshme të mos heqim dorë nga predikimi dhe këshillimi. Udhëzimi natyrisht është në dorë të Allahut të Lartësuar. Çdo moment i kohës duhet vlerësuar si një mundësi e vyer e pranimit të duave, andaj duhet të lutemi pa marrë parasysh se nuk mund të dimë kohën kur duatë pranohen. Kurrë nuk duhet të humbin shpresën. Në ajetin kuranor thuhet:

“Ti përsëri këshillo, se vërtet këshilla u bën dobi besimtarëve.” (Dharijat, 55)

STILI I BUTË

Lukmani i drejtohej djalit të tij me fjalët “biri im i dashur”! Të folurit me ëmbëlsi është çelësi i zemrave, e fton atë të pranojë çdo gjë.

IDHUJTARIA ËSHTË GJYNAHI MË I RËNDË

Idhujtaria është një marrëzi dhe shkujdesje që e përhumbe njeriun deri në vendosjen e shenjës së barazisë midis Krjuesit Fuqiptotë që i dhuroi krijesave çdo mirësi e dhunti me një njeri të thjeshtë të cilin Ai ﷻ e krijoi nga hiçi. Allahu i Lartësuar nuk do ta falë një njeri që vdes me këtë mendësi dhe ai nuk do të përfitojë nga shefaati (ndërmjetësimi) i askujt.

Njeriu duhet të jetë i kujdesshëm edhe ndaj shirkut (idhujtarisë) së fshehur (të padukshme, shpirtërore). Syfaqësia dhe dëshirat egoiste të shndërruara në idhuj, janë shembuj të shirkut të padukshëm.

I Dërguari i Allahut ka thënë:

“Gjëja për të cilën frikësohem më shumë për umetin tim është idhujtaria. Me këtë fjalë nuk kam për qëllim adhurimin e hënës, diellit apo idhujve. Ajo që më frikëson mua janë veprat që bëjnë për të tjerët e jo për Allahun dhe dëshirat e fshehura (për t’u dukur).” (Ibn Maxhe, Zuhd, 21)

Në ajetin kuranor thuhet:

“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot?” (Furkan, 43)

Për shembull;

Do të ishte e rrezikshme nëse një bamirës ndërton një xhami apo vepra të ngjashme dhe kërkon të vendosë emrin e tij kur ai është ende gjallë.

Por;

Fëmijët mund ta vendosin këtë emër pas vdekjes së tij. Ky do ishte një shembull motivues për bamirësi si dhe shkak për dua dhe lutje për shpirtin e tij.

Po ashtu edhe përpjekja për të zbuluar dhe për t’u mburrur me një gjendje shpirtërore të lartë duke i atribouar vetes çdo meritë, përbën një shirk të kamufluar, të fshehtë.

Pas çlirimit të Mekës të gjitha fiset e Gadishullit Arabik filluan të pranenin islamin grupe-grupe. Për të mos i lënë shteg nefsit dhe egos në lidhje me këtë arritje dhe sukses historik, Allahu i Lartësuar zbriti ajetet e sures Nasr ku thuhet:

“Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës) dhe t’i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.”

Nisur nga kjo;

Bamirësinë, veprat e mira, edukimin e nxënësve apo arritje dhe suksese të tilla nuk duhet t’ia atribuojmë kurrë vetes, por duhet t’i vlerësojmë si një mirësi e Krijuesit Fuqiplotë.

Çështja më e rëndësishme e tasavufit është zbrapsja e unit dhe egos. Për edukimin e unit njerëzor janë vënë në praktikë metoda të shumta edukuese.

Nisur nga kjo e fundit mund të sjellim shembullin e:

Ibrahim Bin Et’hemit i cili refuzoi postin dhe ofiqet; Aziz Mhamud Hydajin i cili pas detyrës si kadi dilte të shiste mushkëri në pazar i veshur me kaftanin e tij. Junus Emresë iu desh të priste shumë para së të pranohej nga mësuesi i tij. Dijetarë të shquar si Halid Bagdadi u morën me pastrimin e tualeteve etj.

Shembuj të tillë janë tregues të metodave edukuese në shërbim të thyerjes së mendjemadhësisë dhe unit njerëzor.

TË DREJTAT E PRINDËRVE

Allahu i Lartësuar përmes këshillave të Lukmanit të përmenduar në Kuranin fisnik na bën të ditur të drejtat e prindërve dhe detyrimet ndaj tyre:

“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë.” (Lukman, 14)

Ajeti kuranor bën të ditur në mënyrë të qartë se me çfarë ndjenje dhembshurie dhe mirësie duhet t’u qasemi prindërve veçanërisht në moshën e pleqërisë:

“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuron askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti.” (Isra, 23)

Ebu Hurejre (r.a.) transmeton:

“Erdhi një burrë dhe e pyeti të Dërguarin e Allahut:

-Me kë duhet të sillem më mirë?

*Transmetohet
se Lukmani i urtë
ka thënë:*

*“Nuk është pasuri
ajo që e mbledh
në dorë,
e lë trashëgimi
për tjetër kënd,
pastaj jep llogari
vetë për të.”*

I Dërguari i Allahut tha:

“-Me nënën tënde!”

“-Po pastaj?”-pyeti burri.

“-Me nënën tënde!”- tha përsëri i Dërguari i Allahut.

“-Po pastaj?”-pyeti përsëri burri.

“-Me nënën tënde!”- tha përsëri i Dërguari i Allahut.

“-Po pastaj?”-pyeti burri.

“-Me babain tënd!”- tha i Dërguari i Allahut. (Buhârî, Edeb, 2; Muslim, Birr, 1)

Nënat fisnike meritojnë falënderime dhe lutje të përjetshme.

Sa keq!

Në ditët tona ku injoranca ka arritur kulmin, shumë prej tyre po largohen nga misioni i lartë i mëmësisë.

Në injorancën e kohëve të shkuara vajzat e vogla groposeshin të gjalla, ndërsa në injorancën e kohëve tona ato po mbyten nga xhelatet e abortit. Foshnjat po shuhën që në barkun e nënës. Fëmijët po lihen pas dore me justifikimin se prishin rehatinë e nënave. Këto janë shenja të zvenitjes së ndërgjegjes dhe zhdukjes së mëshirës nga zemrat e tyre. Nëse vërejmë edhe një mace madje është e mëshirshme ndaj të vegjëlve të saj. Stili i sotëm i jetës materialiste dhe sekulare, i ka bërë njerëzit më të egjër dhe egoistë.

Në lidhje me aktin barbar të vrasjes, Allahu i Lartësuar i tërheq vërejtjen njeriut të periudhës së injorancës po aq edhe njeriut modern duke u shprehur:

“Kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet për çfarë faji ishte vrasë; (atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur për këtë Ditë.)” (Tekvir, 8-9)

Nga ana tjetër, dërgimi i prindërve në azile kur ata arrijnë moshën e pleqërisë është pasqyrim i mungesës së mëshirës dhe ndërgjegjes së fëmijëve të tyre.

Është vërtet për të ardhur keq. Në të vërtetë një nënë apo baba që kanë nevojë për ndihmë dhe përkujdesje, në fakt janë pasuria më e çmuar për ahiretin e njeriut.

Nga ana tjetër një fëmijë i edukuar në formën më të bukur do të bëhet bastuni mbështetës i prindërve në moshën e tyre të pleqërisë dhe mbase edhe një sadaka rrjedhëse kur ata të ndahen nga kjo jetë.

Në vitet e para të Islamit disa anëtarë të së njëjtës familje e pranuan Islamin ndërsa të tjerët jo. Kësisoj, disa prindër filluan të abuzonin me të drejtën e prindërore kundër fëmijëve të tyre. Për shembull;

Kur Sad bin Ebi Vakkasi pranoi Islamin në moshën 17 vjeçare (sipas një trasmetimi tjetër 19 vjeçar) nëna e tij u zotua që nuk do t'i fliste dhe hiqte dorë nga të ushqyerit, por ai i tha që nuk do të kthehet nga kjo fe.

Nëna pasanike e Musab bin Umejrit e kërcënoi se do ta privonte nga trashëgimia e pasurisë në rast se nuk do kthehej nga Islami.

Babai i Ebu Xhendelit e lidhi atë (të birin) me zinxhirë që ta ndalonte nga emigrimi në Medine.

Ky ajet kuranor tregon mënyrën si duhet vepëruar në raste të tilla:

“Nëse ata orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri; pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t'ju lajmëroj për atë që keni bërë.” (Lukman, 15)



- Nuk kundërshtohet Krijuesi për hir të krijesave.

Adhurimi i përket vetëm Allahut të Madhëruar. Për këtë arsye nëse prindërit i detyrojnë fëmijët të bëjnë diçka në kundërshtim me vullnetin e Krijuesit Fuqiplotë atëherë bindja ndaj tyre është e ndaluar. Përtej kësaj bindja ndaj prindit është e detyrueshme.

Për shembull nëse nëna dhe babai urdhërojnë vajzën e tyre të heqë mbulesën (hixhabin) në këtë rast bindja ndaj tyre refuzohet. Fëmija nuk konsiderohet gjynahqar si rezultat i kësaj mosbindjeje. Përkundrazi, shpërblehet nga Allahu i Lartësuar për zbatimin e këtij urdhri hyjnor.

- Ecja nën gjurmët e atyre që i binden Allahut.

Në këtë urdhër hyjnor vëmendja përqendrohet tek karakteristika që ka zemra për t'u ndikuar nga bota e jashtme. Në këtë kontekst është domosdoshmëri shoqërimi me njerëz të mirë dhe largimi nga të këqinjët.

Një ajet dhe një hadith:

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra).” (Teube, 119)

“Mos u ulni në të njëjtin vend me idhujtarët dhe mos u shoqëroni me to. Nuk është prej nesh ai që rri dhe shoqërohet me to.” (Hâkim, Mustedrek, II, 141)

Gazaliu thotë:

“Ndarja e dimensioneve të përbashkëta mendore, i hap rrugë dimensioneve të përbashkëta shpirtërore.”

- Kthimi është tek Allahu.

Besimi në Ahiret (Jetën e Përtejme) është shumë i rëndësishëm. Në ajetin vijues shohim përsëri këshillat e Lukmanit a.s. drejtuar të birit, i cili i mëson atij si duhet medituari rreth Jetës së Përtejme:

“O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njeh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë.” (Lukman, 16)

- Vetëdija ndaj Ihsanit.

I Dërguari i Allahut “Ihsanin” e ka përkufizuar me fjalët:

“Adhuroje Allahun me bindjen se Ai po të sheh. Sado që ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.” (shih: Buhârî, Îmân, 37)

Lukmani është përpjekur ta brumosë të birin me bindjen se Allahu i Lartësuar është përherë pranë dhe vëzhgon në çdo moment dhe në çdo vend punët e tij.

- Meditimi është çelësi i imanit.

Lukmani e shtynte të birin të meditonte rreth qiejve dhe tokës.

Një meditim që nis nga vepra për të mbërritur tek Vepruesi, nga shkaku tek Shkaktari, nga arti tek Artisti...

Fatkeqësisht sot shkencat pozitiviste trajtohen me një metodë shumë larg këtij meditimi dhe urtësie. E vërteta është se diturinë e fal i Dituri (Allahu xh.sh.). Shkencat pozitiviste konsistojnë në përcaktimin e një tërësie rregullash të vendosura nga vetë Krijuesi Fuqiplotë.

Andaj ne duhet t'u mësojmë fëmijëve tanë shpërfaqjet e panumërta në univers të fuqisë dhe madhësisë së Allahut të Lartësuar.

“O djali im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve.” (Lukman, 17)



Mëshira

FLLADI HYJNOR

— Idris Arpat —

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Allahu e ka ndarë mëshirën në njëqind pjesë. Nëntëdhjetë e nëntë pjesë të saj i ka mbajtur pranë, ndërsa një pjesë të saj e ka zbritur në tokë. Ja, në sajë të kësaj pjese (mëshire), të gjitha krijesat sillen me mëshirë ndaj njëra-tjetrës. Madje edhe pela, e ngre këmbën e saj (për shkak të kësaj mëshire) me frikën që të mos e shkelë dhe të mos e dëmtojë (të voglin e saj kur i jep për të pirë qumësht).” (Buhari, Edeb, 19.)

Allahu, (xh.sh.), është më i Mëshirshmi i mëshiruesve. Ai është Rrahman, është Rrahim... Ai është burimi i mëshirës. Çdo mëshirë e shfaqur nga të gjitha krijesat në tokë dhe në qiell është vepër e Tij...

Mëshira është shfaqje e attributeve Rrahman/i Mëshirshmi dhe Rrahim/Mëshiruesi të Allahut të Lartësuar...

Kur çdo punë të mirë e fillojmë duke thënë “Bismil-lahi’rr-Rrahmani’rr-Rrahim”, ne kërkojmë mëshirën e Allahut Teala që në fillim të punës, duke i përmendur emrat e Tij Rrahman dhe Rrahim. Po të mos jetë mëshira e Tij, nuk mund të arrijmë asnjë mirësi qoftë në këtë botë apo qoftë në botën tjetër.

Të menduarit e këtillë, në të njëjtën kohë është një reflektim tjetër i vetëdijes së nënshtrimin ndaj Zotit (xh.xh.).

MËSHIRA ËSHTË VULA QË ALLAHU I MADHËRUAR I KA VËNË TOKËS

Mëshira është një fllad i bekuar që vjen nga Zoti (xh.sh.) dhe që ia qetëson njeriut botën e brendshme të tij...

Nëse një nënë ndjen mëshirë ndaj të voglit të saj, mund ta bëjë këtë vetëm në sajë të ndjenjës së mëshirës që Allahu Teala ia ka vendosur asaj në zemër. Një njeri që i jep ujë një qeni të etur, mund ta bëjë këtë me ndjenjën e mëshirës që Allahu i Lartësuar ia ka dhuruar atij. Në sajë të mëshirës që Ai ka vendosur në zemrat tona mund t’i puthim dhe t’i ledhatojmë fëmijët dhe nipat tanë. Nisur nga ky aspekt, mëshira është një mirësi e madhe që Allahu i Lartësuar na e ka dhuruar neve. Përveç të tjerash, edhe njeriu vetë është vepër e mëshirës së Krijuesit, sepse Rrahmani na ka mëshiruar ne. Ai na ka krijuar si njerëz, të cilët jemi krijesat më të nderuara. Nëse tani marrim dhe japim frymë në tokë si një gjallesë inteligjente dhe jo si një kërmill, gur apo pemë, kjo është në sajë të mëshirës së Tij.

EDHE LOTËT JANË PREJ MËSHIRËS...

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), e mori në krahë me dhembshuri dhe mëshirë nipin e tij që po jepte shpirt. Sytë filluan t'i rridhnin lot. Ata që gjendeshin pranë tij u bënë shumë kureshtarë dhe e pyetën:

“Çfarë janë këta lot, o i Dërguari i Allahut?” Nisur nga kjo pyetje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ishte i dërguar si mëshirë për botët, u tha:

“Këta lot janë një mëshirë që Allahu e ka vendosur në zemrat e robërve që dëshiron. Allahu mëshiron prej robërve të Tij vetëm ata që janë të mëshirshëm.” (Buhari, Merda, 9.)

ISLAMI ËSHTË FE E MËSHIRËS...

Për këtë arsye, besimtari, duke u nisur me rregullin: “Toleroje krijesën për hir të Krijuesit.” – shfaq dhembshuri dhe mëshirë kundrejt të gjitha krijesave që i ka krijuar Allahu i Madhëruar. Një besimtar që i beson Allahut Teala nuk e torturon dhe nuk ia pret fytyrën njeriut, i cili, siç e shprehëm edhe më lart, është krijesa më e nderuar. Kushdo që e bën këtë, qoftë individualisht apo qoftë në grup, nuk ka asnjë lidhje me Islamin, edhe nëse mund të ketë shpallur kalifatit Islam, sepse, me këto veprime po bëhet një vepër prej së cilës nuk janë të kënaqur Allahu dhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Këtë duhet ta dimë mirë të gjithë se mysliman është ai njeri prej të cilit janë të sigurt njerëzit e tjetër dhe për të cilin thonë: “Neve nuk na vjen dëm nga ai.”

Nisur nga ky aspekt, në Islam, nuk ka dhunë, torturë dhe barbarizëm. Madje edhe lufta e Islamit është e mbushur plot me mëshirë, sepse në luftë, sipas Islamit, nuk vriten fëmijët, gratë dhe klerikët. Kur ushtria të jetë ballë për ballë me ushtrinë armike dhe të zhvillohet lufta, prapë se prapë janë të ndaluara barbarizmat, si vrasjet për qejf apo prerja e gjymtyrëve. Në vend të këtyre, në fenë tonë sublimë, në Islam, ka gjallërim, zhvillim dhe ndërtim. Nëse u hedhim një sy çlirimeve të bëra nga Islami, vëmë re se vendet janë çliruar jo duke i varur, prerë, shkatërruar, dhunuar dhe torturuar njerëzit, por duke fituar zemrat e tyre. Këtë mund ta shikojmë edhe në luftërat që janë bërë në kohën e Resulullahut, sallallahu alejhi ve sellem. Sipas një studimi, përgjatë gjithë kohës dhjetëvjeçare të xhihadit që ka bërë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), ndërkohë që tokat islame u zgjeruan deri në dy milion kilometra katrorë, humbën jetën 250 veta nga radhët e armiqve dhe 150 luftëtarë nga radhët e myslimanëve.

Por për fat të keq, kohët e fundit po bëhen përpjekje serioze që Islami, që është feja e mëshirës, të lançohet si feja e terrorit dhe e dhunës me ndihmën

e sjelljeve të privuara nga mëshira e disa myslimanëve injorantë dhe të paditur. Në këtë mënyrë, duan që të gjithë njerëzit e botës të drejtohen nga një perceptim i gabuar. Përballë këtyre orientimeve të gabuara mund të qëndrojmë vetëm me shembujt e mëshirës.

MËSHIRA GJALLËRON, JEP JETË DHE JEP SHPIRT...

Siç e gjallëron dhe i jep jetë uji tokës së thatë, edhe mëshira i qetëson, i preh dhe u jep jetë zemrave.

Edhe vetë i Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte peygamber i mëshirës. Allahu i Lartësuar e deklaroi kështu këtë të vërtetë:

“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.” (Enbija, 107) Ai është mëshirë për botën e njerëzve, për botën e kafshëve, për botën e xhindëve, për malet dhe për gurët. Siç shprehet edhe vetë në një fjalë të tij:

“Unë jam Muhamedi. Unë jam Ahmedi. Unë jam peygamberi i mëshirës...” (Ahmed bin Hanbel, V, 405.) Një herë sahabët nuk rezistuan dot ndaj torturave të mëdha të politeistëve. Andaj i bënë këtë kërkesë të Dërguarit të Allahut (s.a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Mallkojini politeistët!” Ndërsa ai u dha përgjigje me këto fjalë që mbartnin mëshirë:

“Unë nuk jam dërguar si mallkues, por si mëshirë.” (Muslim, Birr, 87.)

Ndoshta cilësia më e qartë e tij ishte mëshira. Kjo mëshirë e tij është shfaqur më së shumti mbi umeitin. Në një ajet fisnik, Allahu i Lartësuar e cilëson atë si një peygamber të dhënë pas besimtarëve, të dhimbshëm dhe të mëshirshëm ndaj atyre dhe si një profet që i vinte rëndë kur besimtarët gjendeshin në vështirësi. (Shik. Ahzab, 6)

I GJITHË UNIVERSI KA NEVOJË PËR MËSHIRË...

Njeriu, i cili është më i nderuari prej të gjitha krijesave, ka nevojë për mëshirë. Njeriu i botës së sotme, i cili është i privuar nga mëshira, ka nevojë të madhe për mëshirë... Pothuajse në çdo vend që hedhim hapim përballemi me ngjarje barbare. Po, barbarizma në shtëpi, barbarizma në punë, barbarizma në televizor, barbarizma nëpër gazeta... Mbi të gjitha, ekzistenca e këtyre barbarizmave në shoqëritë myslimane janë një gjendje me të vërtetë pikëlluese.

Sot vëmë re se një fëmijë mysliman e ther dhe e copëton barbarisht nënën e tij. Një nënë e privuar nga mëshira, mund ta hedhë në mbeturina apo në banjë të voglin e saj të sapolindur pa e vrarë ndër-

gjegjja aspak. Ndërsa ndër situatat më të tmerrshme mund të përmendim edhe këtë: Një barbar që pohon se është mysliman, ia pret kokën me thikë një njeriu tjetër mizorisht dhe duke përmendur emrin e Allahut. Pastaj pandeh se po predikon Islamin duke ia treguar të gjithë botës kokën e prerë të atij njeriu. I shkreti... Ky nuk është Islami, të cilin ai pandeh se po e zbaton... Kjo që bën ai nuk është gjë tjetër përveçse mizori apo satanizëm, pra, rrugë e shejtanit të mallkuar. Ç'është kjo mizori kështu, o Zot! Ç'është kjo papërgjegjshmëri! Ç'është kjo fatkeqësi!

Në një hadith fisnik thuhet:

“Vetëm fatkeqi është i privuar nga mëshira.” (Tirmidhi, birr, 16.) Sa gjendje e keqe është privimi nga mëshira... Andaj, nëse nuk mëshiron, nuk do të mëshirohesh. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ishte i dërguar si mëshirë për botën, thotë:

“Allahu nuk e mëshiron atë që nuk i mëshiron njerëzit.” (Buhari, Tevhid, 2.)

Për këtë arsye, atë që është i mëshirshëm e mëshiron edhe Allahu Teala...

Nëse dëshiron që mëshira e Allahut të jetë mbi ty, duhet t'i mëshirosh krijesat. Nëse mëshiron, edhe engjëjt të mëshirojnë dhe të mbulojnë me flatrat e tyre... Në hadithin fisnik që e kemi përmendur në krye të tekstit, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“...Mëshironi ata që janë mbi tokë, në mënyrë që t'ju mëshirojnë ata që janë në qiell.” Domethënë,

duhet të mëshirosh njerëzit, kafshët, gurët, pemët, shkurtimisht, çdo gjë që ekziston, në mënyrë që edhe ty të të mëshirojnë Allahu dhe engjëjt e Tij.

EDHE KAFSHËT KANË NEVOJË PËR MËSHIRË...

Kafshët, për të cilat është harruar se mbartin shpirt, në përgjithësi torturohen, keqtrajtohen dhe dhunohen. Allahu, xhelle xhelaluhu, i ka dhënë kafshët në shërbim të njeriut. Nisur nga ky aspekt, njeriu duhet t'i trajtojë me mëshirë kafshët, por ja që në botën mizore të sotme, kafshët, të cilat janë krijesat e dashura të Allahut, gjenden ballë për ballë me barbarizmat e tmerrshme duke filluar nga të ndeshurit e tyre me njëra-tjetrën deri në ngordhje e deri te rrjepja e lëkurës së tyre në gjendje të gjallë, në mënyrë që të përfitohet sa më shumë para.

Ato shikime nuk më largohet dot nga sytë!

Ata, nën shoqërinë e muzikës dhe argëtimit, po ia rrjepnin lëkurën të gjallë një foke. Në gojë kishin cigare. Në njërën anë pinin alkool, ndërsa në anën tjetër qeshnin me të madhe. Foka akoma ishte e gjallë. Më së fundi, ia rrjepën edhe lëkurën e kokës dhe e hodhën fokën në një vend diku përpara. Foka, me një shpresë të fundit, pa majtas e djathtas me ato sytë e bukur që kishte. Ndoshta po priste ndonjë dorë të mëshirshme. Pastaj dha shpirt. Në të vërtetë, ky ishte momenti kur dha shpirt njerëzimi. Kjo vepër barbare ishte shenjë treguese e mosbesimit dhe e rezultatit të tiranisë që lind për shkak të tij.

*“Allahu e ka ndarë mëshirën në njëqind pjesë.
Nëntëdhjetë e nëntë pjesë të saj i ka mbajtur pranë,
ndërsa një pjesë të saj e ka zbritur në tokë.
Ja, në sajë të kësaj pjese (mëshire), të gjitha krijesat sillen
me mëshirë ndaj njëra-tjetrës. Madje edhe pela,
e ngre këmbën e saj (për shkak të kësaj mëshire)
me frikën që të mos e shkelë dhe të mos e dëmtojë
(të voglin e saj kur i jep për të pirë qumësht).”*

(Buhari, Edeb, 19)

Po, nëse në një zemër nuk ka besim, prej saj mund të pritët çdo lloj barbarizmi. Poeti i ndjerë thotë:

“Besimi është xhevahir, o Zot sa i madh që është!

Zemra pa besim, e cila është e ndryshkur, është thjesht një barrë!

Nëse ka besim, ka edhe mëshirë...

Nisur nga ajo që thamë më lart, ndërmjet mëshirës dhe besimit ka një lidhje të fortë. Një njeri që i beson Allahut Teala, është edhe i mëshirshëm. Besimi e bën të domosdoshme mëshirën. Barbarizmi dhe besimi nuk mund të qëndrojnë bashkë. Për këtë arsye, një besimtar që pohon se i beson Allahut, duhet të flasë me mëshirë dhe të sillet me mëshirë. Nëse sillet në mënyrë barbare, duhet ta kuptojë se besimi që ka ndaj Allahut nuk është ndonjë gjë më tepër se sa një pohim i pavlerë.

KURBAN DO TË THOTË MËSHIRË...

Ne duhet të shfaqim mëshirë edhe kur t'i therim kafshët që Allahu Teala i ka nënshtuar në shërbim ndaj nesh për të na nderuar ne.

Sipas transmetimit të ardhur nga Ibn Abbasi, (r.a.), në një ditë kurhani, i Dërguari i Allahut, alejhi's-salatu ve's-selam, po kalonte pranë një burri, i cili e kishte vendosur këmbën në barkun e deles dhe po mprehte thikën. Sapo Pejgamberi i mëshirës, (a.s.), e pa në atë gjendje, menjëherë i tha:

“A nuk do të ishte më mirë sikur ta kishe mprehur

thikën më parë? Apo dëshiron ta therësh dy herë këtë kafshë?” (Hejsemi, Mexhmau'z-Zevaid, IV, 33.)

Gjithashtu, edhe njëri prej haditheve të tij që mban erë mëshire është:

“Allahu ka caktuar që ta trajtoni mirë çdo gjë. Për këtë arsye, vrisni me mirësi kur të vrisni! Thërrni me mirësi kur të thërrni! Kur ndonjëri prej jush të vendosë për të thërrë ndonjë kafshë, le ta mprehtë thikën, ta thërrë me mirësi dhe ta rehatojë kafshën që ka therur!” (Ahmed ibn Hanbel, 4/123.)

Njerëzit, kafshët dhe natyra kanë nevojë për mëshirë. Ata duan të ndjejnë një shikim dhe një prekje të mëshirshme...

Së fundi, i gjithë universi ka nevojë për mëshirë. Për këtë arsye, ndjenjat e mëshirës duhet t'i gjallërojmë dhe t'i aktivizojmë përsëri. Ndërsa kjo e bën të domosdoshme njohjen e besimit tonë, i cili është burimi i mëshirës. Nëse dëshirojmë që në zemrën tonë të fryjnë flladet e mëshirës, duhet ta shtojmë dashurinë dhe komunikimin me besimin që kemi ndaj Allahut të Lartësuar, i cili është më i mëshirshmi i mëshiruesve dhe burimi i mëshirës.

Allahu i Madhëruar na trajtoftë jo me zemërimin, por me mëshirën e Tij! Ne i kërkojmë mbrojtje Atij nga zemërimi i Tij. Në zemrat tona na vendostë ndjenjën e mëshirës! Të gjithëve na dhëntë shikime, të folur dhe sjellje të mëshirshme! U dhëntë mëshirë edhe zemrave që janë të privuara nga mëshira! Amin!...



PËRSE JEMI **KRIJUAR**?

— Doç. dr. Mustafa Karabaxhak —

Të gjithë e kanë një qëllim. Edhe ata që janë zullumqarë, edhe ata që janë të mëshirshëm. Edhe shejtanët, edhe engjëjt. Edhe ata që vrasin, edhe ata që vriten. Edhe të uriturit dhe të vetmuarit shkojnë pas një qëllimi, edhe të çmendurit që nuk dinë të ngopen. Edhe ata që kolonizojnë, edhe ata që kolonizohen absolutisht e kanë një qëllim. Domethënë, kjo botë madhështore është pothuajse një depo qëllimesh. Në këtë depo gjendet çdo lloj qëllimi. Aty ka çdo lloj qëllimi edhe për më të keqin, edhe për më të mirin. Qëllimet kanë shkaqet, justifikimet dhe pretekstet e tyre. Edhe për vrasjet barbare ka shkaqe plot, edhe për butësinë dhe drejtësinë.

Cili është qëllimi dhe preteksti i një zullumqari? Po qëllimet dhe shkaqet e një dijetari, të një të dhunuari dhe një të pafajshmi? Cili është qëllimi i shejtanëve? Cili është qëllimi i engjëjve? Cili është qëllimi i njerëzve të uritur, i njerëzve që kanë të

ftohtë, i njerëzve që nuk kanë shtëpi dhe i jetimëve? Cili është qëllimi i njerëzve të pangopur, të çmendur, të hutuar, barbarë dhe koprracë? Cili është qëllimi i atyre që shkaktojnë prishje e trazira, i atyre që e prishin paqen dhe i shkelin të drejtat e të tjerëve dhe i atyre që dëshirojnë ta shkatërrojnë njerëzimin e drejtësinë? Cilat janë qëllimet dhe justifikimet e kolonialistëve, shkatërrimtarëve, të degraduarve, injorantëve, të shkujdesurve dhe të atyre që u nënshtrohen dëshirave vetjake?

Një milingonë apo një gjinkallë e ka një qëllim dhe shkak. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për dhelprat, vampirët, përbindëshat dhe sorkadhet. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për zogjtë, ujqërit, qengjat, gomarët, mushkat, sorrat, bletët dhe bilbilat. Çdo qenie e vazhdon jetën e saj gjithmonë rreth një qëllimi dhe shkak, por në fund çdo jetë mbaron, sepse edhe jeta, edhe vdekja e kanë një qëllim dhe shkak. E gjithë çështja është që të kemi qëllimin që do Allahu i Madhëruar. Ky qëllim është adhurimi i Tij. Krijuesi i Lartësuar thotë: *“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”* (Dhariaj, 56)

Allahu Teala na pyet, në mënyrë që të kuptohet me qartë kjo e vërtetë: *“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?”* (Kijame, 36) Ndërsa gjendja e atyre që shkatërrohen duke u mbytur në një mendim të tillë, shprehet përsëri kështu në ajetin fisnik:

“Sa e sa vendbanime, banorët e të cilëve kanë qenë mohues, i kemi shkatërruar; e pas tyre kemi ngritur popuj të tjerë! Kur e ndienin dënimin Tonë, ata iknin me të shpejtë. Mos ikni! Kthehuni atje, në luksin tuaj dhe në pallatet tuaja, se ju do të pyeten.” Ata do të thonë: *“Mjerë ne, me të vërtetë, kemi qenë keqbërës!”* Këto rënkime të tyre nuk pushuan, derisa Ne i palosëm si drithë i korrur. Ne nuk e kemi krijuar qiellin dhe Tokën e ç’gjendet në mes tyre, për të luajtur (pa qëllim). Sikur të donim argëtim, Ne do ta bënim me gjërat pranë Nesh (si engjëjt, hyritë etj.), nëse do të bënim diçka të tillë. Por Ne e godasim të pavërtetën, me të vërtetën, e cila e shkatërron atë dhe ajo zhduket. Dhe, mjerë për ju, për atë që i vishni (Allahu!) Atij i përket gjithkush që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ata që janë tek Ai (engjëjt), nuk ngurrojnë për të adhuruar Atë e nuk ndiejnë lodhje, por e lavdërojnë (Atë) natën dhe ditën, pandërprerë.” (Enbija, 11-20)

Allahu i Lartësuar na fton për seriozitet. Ai na paralajmëron edhe në ajetet të tjera, në mënyrë që

ta vlerësojmë jetën jo si një lojë, por si një stinë mbjelljeje dhe korrijeje:

“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t’u zbavitur! Ne i kemi krijuar ato me qëllim të plotë, por shumica e tyre nuk e dinë. Me të vërtetë, Dita e Gjykimit, është e caktuar për të gjithë ata. Atë Ditë, i afërmi nuk mund ta ndihmojë aspak të afërmin e as ata vetë nuk do t’i ndihmojë kush, me përjashtim të atyre që i ka mëshiruar Allahu. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe Mëshirëplotë. Pema e Zekkumit do të jetë ushqim i gjynahqarit. Si tunxh i shkrirë ajo do të vlojë në barkun e tij, ashtu si vlon uji i nxehtë. (Engjëjve do t’u thuhet): *“Rrëmbejeni atë dhe çojeni në mes të zjarrit flakërues! Pastaj, për dënim, hidhni mbi kokën e tij ujë të valuar* (duke i thënë): *“Shijojë këtë, o njeri “i fuqishëm” dhe “fisnik”! Ja, ky është dënimin për të cilin ju dyshonit!”* (Duhan, 38-50)

Sikundër kësaj: *“Punëdrejtët, me të vërtetë, do të jenë në vend të sigurt, midis kopshteve dhe burimeve, të veshur në petka mëndafshi të hollë dhe armaç, të ulur përballë njëri-tjetrit. Po, kështu do të jetë, dhe Ne do t’i martojmë ata me hyri sybukura. Aty do të kërkojnë çfarëdo frutash që të dëshirojnë e do të jenë të sigurt. Atje nuk do ta provojnë më vdekjen, përveç vdekjes së parë dhe Ai do t’i shpëtojë prej dënimit të zjarrit flakërues. Kjo do të jetë dhunti prej Zotit tënd. Kjo është fitorja madhështore!”* (Duhan, 51-57)

Ne duhet ta mësojmë në çdo aspekt se çfarë është jeta e kësaj bote, në mënyrë që ta kuptojmë këtë shpëtim dhe ta fitojmë atë. Nëse veprojmë kështu, kjo botë nuk do të jetë një mejdan shkujdesjeje dhe zullumi. Pra, çfarë është jeta e kësaj bote? Ja përkufizimi që i bën Allahu Teala: *“Jeta e kësaj bote nuk është asgjë tjetër, veçse lojë dhe zbavitje...”* (Muhamed, 36) Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë:

“Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin! Kur hipin në anije, ata i luten Allahut me devotshmëri të singertë, por kur Ai i sjell në tokë shëndoshë e mirë, menjëherë ata i veshin Atij ortakë (në adhurim), për të mohuar atë që u kemi dhënë Ne dhe për t’u kënaqur. Por shpejt do ta marrin vesh!” (Ankebut, 64-66)

Por këtë duhet ta dimë tani. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar na e përkufizon në mënyrë edhe më të detajuar se çfarë është jeta e kësaj bote: *“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë,*

dëfrim e zbulurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme. Prandaj rrekuni me njëri-tjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka, që është e përgatitur për ata që i kanë besuar Allahut dhe të dërguarve të Tij. Ajo është mirësia e Allahut, që Ai ia jep kujt të dojë; e Allahu ka mirësi të pafund. S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër (Leuhi Mahfûdh) më parë se ta krijojmë atë.

**“Vallë, a mendon
njeriu se do të mbetet
pa përgjegjshmëri?”**

(Kijame, 36)



Kjo për Allahun është vërtet e lehtë! (Këtë paracaktim e kemi bërë) **që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë. Allahu nuk i do kryelartët mburravecë.**” (Hadid, 20-23)

Nëse flasim në bazë të këtyre ajeteve fisnike, shumë njerëz jetojnë, por nuk e njohin jetën. Ata nuk e perceptojnë jetën me atë që ka pasur përpara dhe me atë që do të vijë pas saj. Për shkak të kësaj, nuk e kuptojnë siç duhet dhe nuk e vlerësojnë dot atë. Si rezultat, e çojnë dëm jetën, amanetet dhe mirësitë. Ata mendojnë se e njohin jetën jo sipas kësaj të vërtetë hyjnore dhe themelore, por sipas vrojtimeve të tyre. Por ja që, për ta njohur dhe kuptuar jetën në mënyrë të saktë, ka tri të vërteta themelore:

- Krijimi
- Jeta dhe vdekja
- Vdekja dhe ringjallja

Njeriu, sipas formimit apo joformimit në boshitin e këtyre tri të vërtetave themelore, nxjerr në pah gjithë ata opinione, mendime, qasje, vlerësime, etj., në lidhje me jetën. Ata që e shpjegojnë jetën duke e nënvlerësuar të vërtetën e vdekjes, mbyten në qorrsoakakë dhe përkufizime të tjera. Ndërsa ata që nuk e nënvlerësojnë, i gjejnë rrugët e mrekullueshme të shpëtimit edhe nëse gjenden në mes të qorrsoakakëve. Edhe ata që e shpjegojnë vdekjen duke mos e pranuar të vërtetën e ringjalljes, pandehin se një gjë e tillë nuk ekziston dhe e bëjnë jetën sikur të ishte një fabrikë ndëshkimi për shkak të papërgjegjësisë së tyre. Papërgjegjshmëria e të theksuarit se nuk do të vijmë më në këtë botë, vazhdimisht sa vjen e shtohet prej shkatërrimit të humbjes në formën e çmendurive të pafundme të çdo lloji të shkujdesjes dhe zullumit që bëhet duke mos e marrë parasysh llogarinë e madhe që do të jepet në botën e përhershme.

Të mos dalluarit e këtij shkatërrimi është zgjedhja për t'u zhytur në dëfrim e argëtim që janë si një drogë për mendjen dhe për ta harruar jetën, vdekjen dhe jetën pas vdekjes ndërmjet zhurmave të dëfrimit. Padyshim se kësaj është e pamundur t'i thuhet jetë në kuptimin e vërtetë, sepse në një vend ku krijimi nuk njihet në formë të saktë, jeta nuk është një fitim, por një humbje. Në një pikë ku jeta nuk është një fitim, vdekja nuk është një shteg për takimin me Zotin në një botë tjetër më të madhe, por është një kurth ndëshkimi prej të cilit nuk mund të shpëtohet. Në një situatë kur vdekja nuk është shteg për t'u takuar me Zotin (xh.xh.), ringjallja nuk është lindja e diellit të një mëngjesi mirësish të

veçanta dhe shpërblimesh të pafundme, por është rrokullisje në mes të flakëve të një tragjedie të përhershme. Dita kur ringjallja nuk është mëngjesi i shpërblimeve të pafundme, është dita kur çdo gjë ka marrë fund për njeriun. Sa ditë e keqe është kjo ditë e cila nuk mund të kompensohet!

Kjo nuk është e vërteta e jetës. Jeta nuk është për t'u shkatërruar në këtë lloj mënyre. Pse? Sepse të preokupuarit për ta gjetur shkakun e krijimit dhe për ta kuptuar atë në këtë aspekt, është çelësi i përgjigjes më të saktë. Pa e pasur atë çelës, njeriut asnjë derë nuk i hapet plotësisht. Nuk i hapet as dera e besimit, as dera e mendimit dhe as dera e medimit. Përderisa të mos hapen këto dyer, njeriu e shikon të panevojshme përgatitjen edhe për vdekjen të cila po afrohet hap pas hapi. Ai e nënvlerëson këtë, madje edhe për ta biseduar. Për këtë arsye, nuk e vlerëson çfarëdo që i thuhet për jetën pas vdekjes duke pandehur se di çdo gjë rreth kësaj çështjeje. Ai i shtrembëron turinjtë edhe kundrejt të vërtetave më të mëdha dhe më të dhimbshme. Për ato mendon sikur të jenë përralla boshe, aventura të panevojshme që kanë ngelur në të kaluarën, që të bezdisin kur bisedohet rreth tyre dhe që e bëjnë të thotë: "Aman, a përsëri për këto do të flasim?" Ndërkohë ato janë një realitet absolut që e presin atë me të gjithë tmerrin e tyre. Pra, është pikërisht pragu i një të ardhmeje të vështirë dhe të tmerrshme ku do ta gjejë veten e tij pas një hapi që do ta hedhë. Por kjo është e vështirë t'u shpjegohet atyre të cilëve nuk ngrihen dot nga djepi i shkujdesjes ndaj Zotit (xh.sh.). Pikërisht siç ka ndodhur edhe në këtë shembull të mëposhtëm:

Një person po ikte me gjithë fuqinë që kishte. Ai po vraponte pa marrë parasysh se çfarë mund t'i dilte përpara, kodër apo mal. Nuk ndalej, edhe pse i nguleshin gjembat në këmbë, edhe pse gurët ia kishin vlarë gjunjët, edhe pse ferrat ia kishin gjakosur fytyrën. Po vraponte duke mos pasur problem asnjë gjë, asnjë hall dhe asnjë pengesë. Jo, nuk po vraponte, por po arratisej, sepse nga prapa kishte një përbindësh të egër. Përbindëshi po i vërsulej nga pas si i çmendur dhe e kishte bërë dynjanë tym, në mënyrë që ta kapte dhe ta shqyente. Edhe burri i shkretë po vraponte si i çmendur ngado që i shkonin sytë. Ai po arratisej drejt një shprese të panjohur pa e ditur se si mund të shpëtonte. Tëmthi pothuajse po i plaste prej ulërimeve drithëruese që i kishte shumë afër. Edhe mushkëritë pothuajse po i pëlcitnin prej frikës. Çfarë të bënte? Ai nuk kishte rrugëzgjidhje tjetër përveçse të vraponte dhe të arratisej. Edhe mendja pothuajse do t'i ikte prej frikës se



"Sigurisht që atë ditë banorët e Xhenetit nuk do të mendojnë për gjë tjetër, veç lumturisë së tyre. Ata dhe gratë e tyre do të jenë në hije, të mbështetur në ndenjësë të lartuara. Për ata do të ketë aty fruta dhe çdo gjë që dëshirojnë. "Paqe!" do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë."

(Jasin, 55-58)

mos po e kapte përbindëshi. Ai po vraponte shpejt si era, por prapë se prapë përbindëshi sa vinte dhe po i afrohej. Fryma e zjarrtë e përbindëshit të egër përsëri ishte pas tij. Këmbët i kishte bërë si flatra për shkak të përpëlitjeve nga frika dhe po vraponte sikur po fluturonte. Ndërsa nga njëra anë po i përgjërohej Zotit (xh.sh.):

"O Zot! Të përgjërohem që të më mbrosh nga ky përbindësh i egër që më është vënë pas! Ti je fuqia e vetme që mund të më mbrojë nga ai në këtë luginë të shkretë. Të përgjërohem o Zot! Mos më bëj ushqim për të! Më jep një mrekulli dhe më mbro! Tani jam i pambrojtur sa një milingonë. Tani kam nevojë për mirësinë Tënde si një tokë e shkretë. Më ndihmo o Zot!"

Ai po vraponte aq shpejt, saqë nuk e shihte dot vendin. Në fakt, nuk kishte mundësi ta shikonte. Befas pa diçka. Çfarë të ishte vallë? Mos! Atij i kishte dalë përpara një pus i thellë dhe i gjerë. Ai nuk ndaloi. Në fakt, nuk mund të ndalonte dot. Për këtë arsye, u hodh menjëherë në pus. Papritur e ndjeu veten në zbrazëti. Mendoi: "Nëse bie në fund, do të bëhem copë-copë." Pastaj i mbylli sytë

duke thënë me vete: “Domethënë se kështu paska qenë caktimi hyjnor!”

Aman, mos vallë do të përplasej në fund të pusit të thellë dhe të errët? Pikërisht në atë moment, ndodhi diçka e jashtëzakonshme. Falënderimi i takon Zotit (xh.sh.)! Me sa dukej, Zoti ia kishte pranuar lutjen e sinqertë, sepse ai nuk ra në fund të pusit. Si rezultat i Urtësisë hyjnore, në murin e pusit kishte qenë një degë e trashë sa krahu e cila nuk ishte as afër fundit, as afër grykës së tij. Rënia e burrit të shkretë rastisi në atë degë jetike. Kështu ai shpëtoi në momentin e fundit pa u përplasur në fund të pusit. Ai ishte i habitur. Frika që përjetoi e kishte tmerruar. E hodhi shikimin poshtë, por ç’të shihte? Atje ishte plot e përplot me gjarpërinj. Kur pa lart, përbindëshi i egër po e priste atje. Për këtë arsye, u kap edhe më fort pas degës ku po qëndronte. Pastaj e falënderoi Zotin (xh.sh.), duke thënë: “O Zot! Ti më shpëtove prej një vdekjeje të tmerrshme! Falënderimet e pafundme qofshin për ty!”

Kur shikonte dimensionet e rrezikut në të dyja anët, situata në të cilën gjendej i dukej si një lumturi e veçantë. Edhe pse ishte i vështirë, i parehatshëm dhe i mundimshëm të qëndruarit në një degë të trashë sa krahu, atë e kënaqte fakti që ishte larg të dyja tragjedive. Të paktën, ishte i sigurt nga rreziku që e priste sipër. Gjithashtu ishte i sigurt edhe nga rreziku që e priste poshtë përderisa të mos binte. Për këtë arsye, mori frymë i qetë. Të dridhurat filluan t’i kalonin. Dega në të cilën ishte mbajtur nuk ishte e dobët sa të këputej lehtë. Ajo kishte disa gjethe shumë të bukura. Veçanërisht kur kaloi në anën e degës që dukej si fron dhe që ishte e përshtatshme për të qëndruar, e mblodhi veten mirë. Shqetësimi i kaloi. Pastaj vuri re se pranë tij po rridhte një ujë qelibar. Ai piu derisa u ngop. Uji ishte aq i mirë, sa nuk ngopeshe me të. Si të ishte ujë i keutherit apo i

zemzemit. Papritur pa edhe disa zogj që gjendeshin pak më përpara tij. Ky ishte një vend mjaft i bukur. Pothuajse si një xhenet i vogël. Ai e vështroi të gjithë vendin me plot mahnitje. Një bukuri si kjo në një pus të tillë! Të gjitha ato mirësi, me të vërtetë ishin magjepsëse. Në ato momente pa edhe një hoje mjalti pranë tij që mund ta arrinte me lehtësi. E zgjati dorën me shumë oreks dhe pëshpëriti: “O Allah! Sa gjëra të bukura paske krijuar në këtë vend!”

Më së fundi, burri i shkretë e mori veten mirë pas ngrënies së mjaltit në atë vend të ngushtë, por që i dukej si xhenet. Ai e harroi edhe përbindëshin që e priste të dilte sipër, edhe gjarpërinjtë dhe ezhdërlanë që prisnin të binte poshtë. Në këtë mënyrë, filloi të ndjehej shumë në qejf. Tashmë nuk kishte asnjë shqetësim.

Ndërkohë ai ishte ndërmjet dy rreziqeve të mëdha. Mbi të gjitha, ishte shfaqur një mi dhe kishte filluar të brente degën ku po qëndronte ai. Në një moment, burri i shkretë e pa miun, por mendoi se miut do t’i thyheshin dhëmbët nga kjo degë e fortë pasi ta kafshonte një apo dy herë. Në këtë mënyrë, e nënvlerësoi atë. Ngaqë vazhdimisht nuk e shikonte miun prej gjetheve, nuk e kuptoi dot se çfarë kishte bërë dhe se sa e kishte brejtur degën. Ndoshta do ta kuptonte, por e kishte humbur kaq shumë veten prej shijes së mjaltit që po hante, saqë nuk donte ta prishte qejfin e tij. Për këtë arsye, ai sillej si i verbër, edhe pse miu dalëngadalë po e brente degën dhe nuk i jepte rëndësi zhurmës së brejtjes. Ai vazhdonte të hante mjaltë ndërmjet cicërimave të zogjeve.

Ndërkohë, rreziqet që e prisnin ishin në të njëjtën gjendje. Koha po pakësohej për gjetjen e rrugëzgjdhjes. Ai duhej të merrte masa edhe për rrezikun që ishte lart, edhe për rrezikun që ishte poshtë. Nëse do ta kalonte kohën me kënaqësinë që i jepte



të ngrënë e mjaltit si një i dehur ndërmjet cicërimave, më së fundi nuk do t'i ngelte asnjë gjë për të bërë. Pra, do të ndodhte ajo që do të ndodhte. Për këtë arsye, një bilbil i tha me të madhe: "O ti njeri i shkujdesur! Eja në vete! A nuk e shikon se miu e ka brejtur mirë degën nga e cila varet jeta jote? Nëse nuk merr masa, do të rrokullisesh në gropën e ndëshkimit. Largoji sytë nga ujërat, gjethet dhe mjalti, shikojë litarin e shpëtimit që është zgjatur nga një anë që nuk mund ta arrijë përbindëshi që gjendet sipër, pra, nga një pemë e cila i ka kapluar qiejt dhe kapu fort te ai! Pastaj lartësohu në një atmosferë ku mund të shpëtosh plotësisht!"

A e dëgjoi vallë burri i shkretë këtë paralajmërim apo nuk e dëgjoi dot? Çfarë ndodhi aty? Përgjigjet e këtyre pyetjeve gjenden te secili prej nesh. Ndërkohë, ndryshimi ndërmjet atyre që e dëgjojnë dhe marrin masa dhe atyre që nuk e dëgjojnë dhe sillen si të shurdhër, është sa malet. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

"Sigurisht që atë ditë banorët e Xhenetit nuk do të mendojnë për gjë tjetër, veç lumturisë së tyre. Ata dhe gratë e tyre do të jenë në hije, të mbështetur në ndenjese të lartuara. Për ata do të ketë aty fruta dhe çdo gjë që dëshirojnë. "Paqe!" do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë." (Jasin, 55-58) Ndërsa për të shkujdesurit që janë larg kësaj mirësie, shprehet:

"(Ndërsa keqbërësve Allahu do t'u thotë): "Veçohuni sot ju, o kriminelë! Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuronit djallin, se ai është vërtet armik i hapët i juaj, por të më adhuronit vetëm Mua?! Kjo është rruga e drejtë. Sigurisht që ai (djalli) ka shpënë në humbje një mizëri prej jush; vallë a nuk po mendoni?! Ky është Xhehenemi, që ju ishte premtuar. Di-

**"Punëdrejtët,
me të vërtetë,
do të jenë në vend të
sigurt, midis kopshteve
dhe burimeve, të
veshur në petka
mëndafshi të hollë dhe
armaç, të ulur përballë
njëri-tjetrit..."**

(Duhan, 51-52)

gjuni tani në të, sepse kurrë nuk besuat!" (Jasin, 59-64)

Siç shihet, ata që nuk jetojnë apo që jetojnë sipas qëllimit të krijimit, kanë cilësi të rëndësishme që i ndajnë në banorë të Xhehenemit apo banorë të Xhenetit. Allahu i Lartësuar i radhit kështu ata:

"Ti çuditesh (pse ata s'të besojnë), ndërsa ata të përqeshin (pse çuditesh). Kur u drejtohen këshilla, ata nuk ua vënë veshin. Kur shohin një mrekulli, ata e nxisin njëri-tjetrin për t'u tallur dhe thonë: "Kjo s'është gjë tjetër, veçse një magji e kulluar!" (Ata

thonë): **"Vallë, kur të vdesim dhe të bëhemi eshtra e pluhur, a thua njëmend do të ringjallemi? Edhe paraardhësit tanë të lashtë?" Thua ju: "Po dhe do të jeni të poshtëruar!"** Ai (zëri i bririt të ringjalljes) **do të jetë një zë i vetëm dhe të gjithë** (mohuesit e ringjallur) **do të shohin** (se ç'do të bëhet me ta) **dhe do të thonë: "Mjerë për ne, kjo është Dita e Gjykimit!" Po, kjo është Dita e Gjykimit, të cilën ju e keni përgënjeshtuar!"** (Saffat, 12-21)

"Dhe njëri prej tyre do të thotë: "Unë kam pasur një shok, i cili më thoshte: "Vallë, edhe ti je nga ata që besojnë se, kur të vdesim e të bëhemi eshtra e pluhur, do të japim llogari vërtetë!"" - A doni ta shikoni (atë që më qortonte për shkak të besimit tim)?" Dhe ai do të shikojë poshtë dhe do ta shohë atë në mes të Zjarrit flakërues e do t'i thotë: "Për Allahun! Për pak më shkatërrove edhe mua. Po të mos ishte dhuntia e Zotit tim, edhe unë do të isha në zjarr (bashkë me ty)". (Banorët e Xhenetit do të thonë:) "A nuk do të vdesim më, përveç vdekjes së parë? Dhe as nuk do të dënohemi?" Vërtet, kjo është fitorja më e madhe! Për diçka të tillë, le të përpiqen punëtorët!" (Saffat, 51-61)

Zoti na e mundësoftë të gjithëve këtë! Madje, përgjithmonë... Amin!..



ME ZEMËR TË PASTËR

dhe faje t bardh

— Nurten Selma Çevikollu —

Siç janë të nevojshëm uji, ajri dhe ushqimi për të jetuar edhe besimi është ushqimi shpirtëror themelor më i nevojshëm për jetën. Besimi është burimi i lumturisë dhe qetësisë shpirtërore për njeriun. Po në të njëjtën kohë, besimi është e vetmja rrugë që u vë rregull sjelljeve të pakontrolluara dhe të çrregullta, që i vendos në ekuilibër ato sjellje me një përputhshmëri dhe harmoni të madhe dhe që ka një plan e synim të shenjtë. Besimi është alternativa e vetme prej së cilës njeriu nuk mund të heqë dorë. Ai është fitimi më i madh për njeriun.

Besimi është pikërisht si një lule. Ai nuk e mban brenda aromën e mrekullueshme të tij, por e shpërndan rreth e rrotull. Edhe sjelljet e mira të njeriut janë një lloj shenje e reflektimit të besimit, pra, e shpërndarjes rreth e rrotull e asaj erës së mrekullueshme. Zemrat që mbartin besim përhapin qetësi shpirtërore dhe lumturi në mjedisin ku je-

tojnë. Prania e atyre i qetëson zemrat e njerëzve të tjerë.

Besimi nuk përbëhet nga qëllime të mira që nuk shndërrohen në aksion. Në besim ka reflektime madhështore nga Allahu, azza ve xhelle. Ato janë veprat e mira dhe sjelljet e drejta që e shpien robin drejt përsosmërisë. Besimi nuk bën pa vepra. Një besim i thatë, i cili nuk mbështetet dhe nuk ushqehet me vepra të mira, vjen një ditë dhe shuhet. Në besim ka një aksion pozitiv. Rezultatet e arritura jo nëpërmjet besimit, nuk janë nga Allahu, por janë nga shejtani dhe djalli i mallkuar.

Njeriu nuk është një krijesë e krijuar pa ndonjë qëllim. Ai ka një Krijues. Ai është Allahu Teala. Poseduesi absolut i gjithësisë, Allahu i Madhëruar, i ka dhënë njeriut mendje dhe vetëdije duke e stolisur me pajisjet më të mrekullueshme. Pastaj e ka obliguar që t'i besojë Atij. Njeriu, i cili ka ardhur

në këtë botë duke mbledhur stolitë (pajisjet) më të bukura, sprovohet në forma të ndryshme përgjatë jetës së tij në këtë dynja. Në Kuranin Fisnik thuhet kështu në lidhje me këtë të vërtetë:

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë.” (Ankebut, 2-3) Njeriu nuk është sjellë pa ndonjë synim në këtë botë. Përkundrazi, ai është dërguar në dynja me një synim hyjnor dhe qëllim sublim. Gjithashtu, njeriu nuk është lënë pa përgjegjshmëri. Allahu Teala thotë në Kuran:

“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?” (Kijame, 36)

Çdo njeri, brenda rrjedhave të kohës në këtë botë që e quajmë jetë, është i detyruar ta konceptojë lidhjen ndërmjet besimit dhe sprovës në ngjarjet që i ndodhin. Nëse kjo nuk kalohet me sukses, atëherë, humbja është e pashmangshme. Njeriu, si një krijesë e ndryshme nga të gjitha të tjerat, është krijuar me një synim. Krijuesi i Lartësuar thotë:

“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!” (Mu’minun, 115) Kur Allahu i Madhëruar ia ka treguar njeriut këtë të vërtetë të shenjtë, ka njoftuar se njeriu nuk është krijuar pa ndonjë qëllim, se në fund do të kthehet te Zoti (xh.sh.) dhe do të japë llogari për ato që ka vepruar. Ndërsa qëllimin e vërtetë të krijimit të njeriut e shpjegon me këtë ajet fisnik:

“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” (Dharijat, 56)

Atëherë, e vërteta e qartë është kjo se njeriu, i cili është krijuar me qëllimin për të adhuruar Krijuesin e Lartësuar, nuk ka kapital tjetër përveçse jetës së tij. Ndërsa jeta është një proces që mbaron shpejt aq sa hap e mbyll sytë. Çdo gjallesë do të qëndrojë në këtë botë provizore aq kohë sa i është caktuar. Atij që i vjen koha, që një ditë do t’i vijë patjetër, sigurisht se do të shpërngulet nga kjo botë. Për këtë nuk ka asnjë zgjidhje. Jeta e kësaj bote është e limituar dhe e kufizuar. Ndërsa jeta e ahiretit është e pafundme dhe e pakufishme, domethënë, e përhershme. Jeta e vërtetë është jeta e ahiretit, e cila, siç e theksuam më lart, është e përhershme. Ky ajet fisnik na e shpjegon mjaft qartë këtë të vërtetë:

“Allahu ia shton furnizimin kujt të dojë dhe ia

pakëson kujt të dojë. Jobsimtarët i gëzohen jetës së kësaj bote, por jeta e kësaj bote në krahasim me botën tjetër është vetëm kënaqësi kalimtare.”

(Ra’d, 26) Çdo gjë që gjendet në jetën e kësaj bote, shkon drejt vjetërimit, plakjes dhe shkatërrimit. Faqet e kalendarit të jetës bien një nga një. Andaj, ata të cilët e lidhin zemrën me këtë botë të përkohshme dhe e harxhojnë kapitalin (jetën) e tyre për hir të kënaqësive të dynjasë duke e neglizhuar jetën e botës së përhershme, ndërkohë që gjendja është e atillë, me të vërtetë do të jenë prej atyre që janë mashtruar.

Kjo botë pothuajse është si një mysafirhane, në të cilën të gjithë janë të mirëpritur për një kohë të caktuar. Ndërsa njeriu sprovohet me shumë gjëra në këtë mysafirhane të dynjasë, në të cilën gjendet. Këtë ka shumë ajete fisnike që e vërtetojnë:

“Ne do t’ju vëmë në provë ju, derisa t’i njohim ata midis jush, që luftojnë (në rrugën e drejtë) dhe durojnë, e derisa të provojmë ato që thuhet për veprat tuaja.” (Muhammed, 31) Gjithashtu, edhe në një ajet tjetër thuhet:

“Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni.” (Enbija, 35) Atëherë, synimi i vetëm i njerëzve të mençur duhet të jetë arritja e lumturisë së përhershme duke i kaluar me sukses sprovat e kësaj bote.

Në Librin tonë të Shenjtë, pra, në Kuranin Fisnik, flitet rreth sjelljeve dhe veprave që priten nga njeriu për t’i shfaqur e për t’i bërë. Aty janë vendosur urdhra dhe rregulla në lidhje me sjelljet e njeriut dhe janë dhënë këshilla që i sigurojnë qetësi e lumturi atij përgjatë jetës në këtë botë. Allahu i Madhëruar thotë:

“Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, për t’i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta e, për t’i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë.” (Nexhm, 31) Allahu Teala na njofton se çdo çështje do të shtjellohet me drejtësi në ditën e shpërblimit dhe të ndëshkimit:

“Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo veprë, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrrë sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.” (Enbija, 47)

Këto të vërteta të shenjta na tregojnë se njeriu duhet ta marrë seriozisht jetën e kësaj bote dhe

se besimi mbart përgjegjësi. Për këtë arsye, besimi e bën të domosdoshme veprën. Njeriu e ka kusht që të jetë prej të devotshmëve, në mënyrë që t'i pranohen veprat të cilat do t'ia paraqesë Zotit (xh.xh.).

Çfarë do të thotë kjo?

Kjo do të thotë:

Veprat duhet të bëhen me sinqeritet dhe dëlirësi. Veprat e mira në rrugën e drejtë janë depozitat e kapitalit më të veçantë, i cili i shpie robërit në xhenet.

Përgjatë udhëtimit të jetës në këtë vend, të cilin e quajmë dynja, njeriut mund t'i ndodhin shumë gjëra të bukura e të shëmtuara, të mira e të këqija. Në këtë proces të përkohshëm, pikëllimet dhe brengat e njeriut nuk janë të përhershme siç nuk janë të atilla edhe gëzimet. Secila prej këtyre vjen në jetën e njeriut me një kohë të caktuar

dhe pastaj ikën e shkon. Vështirësitë, sëmundjet, dëshpërimet, mangësitë, pamundësitë, aksidentet, vdekjet dhe çdo gjë tjetër, janë nga një shkak për sprovimin e njerëzve. Xheneti është vendi të cilin do ta fitojnë ata që i kalojnë sprovat me sukses. Xheneti është një kënaqësi e pafundme, por ja që çdo gjë e ka një çmim. Gjërat pa çmim janë të pavlefshme. Andaj edhe xheneti nuk është aq i lirë. Xheneti është i rrethuar me vështirësi, ndërsa xhehenemi është i rrethuar me gjëra që i pëlqejnë nefsit. Në këtë rrugë ka mjaft alternativa që duken si të sakta, por që janë të gabuara. Dëshirat vetjake, kurthet e shejtanit, frymëzimet negative të shoqërisë, joshja e kësaj bote, padrejtësitë e ndryshme të të padrejtëve, etj., janë vështirësi që njerëzit duhet t'i mposhtin. Çdo vështirësi kalohet me besim. Besimi e bën të lehtë çdo gjë të vështirë. Ja pra, jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër përveçse një provë e tillë.

Ndërkohë që çdo njeri, i cili ecën në vijën e kaderit që i përket atij përgjatë jetës së kësaj bote, patjetër sprovohet me gjërat që i janë caktuar. Andaj, ajo që na takon neve për të bërë është që t'i kuptojmë drejt këto ngjarje dhe të shfaqim sjellje në përputhje me urtësinë e tyre. Ajo që na takon të bëjmë kundrejt çdo lloji ngjarjeje që na duket si negative është që të veprojmë me durim, të kërkojmë mbështetje nga Allahu, t'i nënshtrohemi Atij, të jemi të kënaqur ndaj caktimit të Zotit (xh. sh.) dhe ta falënderojmë Atë sa më shumë të jetë e mundur. Domethënë, neve na takon që të dalim në audiencën e Allahut të Madhëruar me zemër të pastër dhe fytyrë të bardhë. Çdo ngjarje që njeriut i duket si e keqe, është një e mirë e veçantë që e afron atë te Zoti (xh.sh.), sepse në llogarinë hyjnore asnjëherë nuk ka gjë të keqe.

Lus Allahun Teala që mirësitë dhe bukuritë të na e ndriçojnë rrugën përgjatë gjithë jetës sonë!



“FLAMURI I ARBËRIT” I JERONIM DE RADËS

PËR REVISTËN “DRITA” TË SHOQËRISË SË STAMBOLLIT

— Gëzim Puka | Gjovalin Çuni —

Lëvizjet letrare, faktet kulturore, ideologjitë e shekullit XIX, në rrafshin letrar dhe politik, mund të vëzhgohen dhe ndiqen në zhvillimin e tyre kompleks, përmes leximit të disa organeve periodike më përfaqësuese të këtij shekulli që solli në skenë Rilindjen tonë kombëtare. Nga vrojtimi i këtyre periodikëve, që përbëjnë edhe kujtesën tonë kulturore, del qartë jo vetëm profili i fenomeneve shoqërore, politike, religjioze, shkencore dhe letraro-artistike, por njëkohësisht informohemi për grupet e intelektualëve dhe redaksitë që i dhanë jetë, i organizuan dhe i bënë me vlerë. Këto revista dhe gazeta përfaqësojnë në mënyrë konkrete frymën e punës të kësaj periudhe mbi temat e gjera të shqiptarisë së asaj kohe.

Duke shfletuar gazetën “Fiamuri Arbërit” (La bandiera dell’ Albania), që sipas gazetarit Blendi Fevziu, shënon ringjalljen e shtypit të vërtetë shqiptar¹ dhe që doli nën kujdesin e një prej figurave më të spikatura të Rilindjes, Jeronim de Radës, na ra në sy një shkrim që përcjell një frymë të veçantë. Në numrin 12 të datës 30 tetor 1884 gazeta “Fiamuri Arbërit”, përcillte përmes editorialit të saj me titull “Laijm i ljuumun” (Notizia felice) një sihariq.

“Dual ndo est sa të daalj Constantinopol jatë Dittare skjipe Dritta. Chejo e ardhur na axen te stënëmit

te puna e rend t’i përjermi të dimen e vettëghees Catundit t’ëën”.²

De Rada ndërsa përshëndeste më gëzim simotrën e re të Shoqërisë së Stambollit, bënte thirrje “... për të përfutur jo vetëm nga përmbajtja, por edhe nga gjuha e kësaj reviste. Tek ajo edhe ne gjejmë me kënaqësi të madhe shumë fjalë, që duke qenë të veçuar, i kemi harruar”, shkruante ai, “...dhe na kujtohet se ca kohë më parë, zotërinjtë që botojnë “Dritën” na patën thënë se kishin besim se do të vinte dita që, gjuha e cila ashtu si edhe ne vetë, rronte e përndarë andej e ketë, do të mblidhej e do të bashkohej.”³

Po le t’i kthehem përsëri argumentit. Përse i gëzohej De Rada gazetës së Stambollit?

Së pari, po promovojë një organ i ri shqiptar në kryeqendrën e Perandorisë Turke, Stamboll dhe së bashku më gazetën që ai drejtonte u bënë promovues të gazetarisë shqiptare, nxitën dhe frymëzuan krijimin e medias kombëtare⁴, duke u bërë kështu zëdhënësit e çështjes kombëtare shqiptare.

Fillimi i fletorizmit në Stamboll lidhet me autoritetin e Sami Frashërit⁵ dhe më vonë me Jani Vreton, njëri prej anëtarëve të “Komitetit Qendror për Mbrotjtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare”, krijuar në Stamboll më 1877, si dhe me lejen e Portës

së Lartë të vitit 1879, që lejonte “botimin e një organi të shtypit kulturor e arsimor shqiptar”⁶.

Më 10 gusht 1884 nisi të qarkullojë e përkohshmja “Drita”. Që nga numri i dytë (diku del i tretë) revista mori emrin “Dituria”. Me një orientim të gjerë pedagogjik, kulturor, shkencor, letrar dhe shoqëror⁷, motoja e revistës ishin idetë iluministe të Rilindësve “me mndritë mendjen e njerëzve, përmes lëvrimit të gjuhës shqipe”.

E përkohshmja “Drita-Dituria” përmes shkrimeve të ndryshme “diturake” dhe krijimtarisë letrare të Naimit, hodhi bazat e teksteve shkollore, por edhe të edukimit të shqiptarëve me elemente gjuhësore dhe kulturore.

Në aspektin publicistik “Fiamuri Arbërit” dhe “Drita-Dituria”, mund të cilësohen si vijuese dhe plotësuese të njëra-tjetrës në mjedisin shqiptar jashtë Shqipërisë. Secila nga ato në zhvillimet e shtypit të Rilindjes i takojnë nënndarjeve të ndryshme kohore. Sipas historianëve të gazetarisë Hamit Boriçi dhe Mark Marku, “Fiamuri Arbërit”, i takon nënndarjes së parë të shtypit shqiptar të viteve 1843-1883, ndërsa “Drita-Dituria” përcaktohet të jetë revista e parë e nënndarjes së dytë të shtypit shqiptar të viteve 1884-1896.⁸

Na befason fakti se De Rada në shkrimin e tij e komplimenton qëndrimin e Portës së Lartë ndaj këtij organi të ri të shtypit, siç ishte “Drita – Dituria”. Ja si e parashtron De Rada këtë qëndrim në rreshtat e këtij editoriali. “Në anën tjetër me ngazëllim për Dritën e madhe, të botuar në Stamboll, gjë që tregon se Porta e Lartë nuk është ajo mjegull që nuk lejon diellin e Shqipërisë, ashtu siç e bëjnë të duket zyrtarët e këqij të saj”.

De Rada i gëzohej daljes së një reviste a gazete shqipe, edhe për faktin se ai vetë e kuptonte se burimet financiare të periodikëve shqiptarë ishin të kufizuara. Si të tilla, ata kishin jetë të shkurtër. Ai i lumturohej daljes së çdo reviste që trajtonte problemet shqiptare, por tek shqiptarët e Stambollit, De Rada synonte të gjente trajtimin e saktë të të gjitha çështjeve, si dhe mundësitë e qarkullimit të gazetave për lexuesit e paktë në Shqipëri. Ai e kuptonte se zhvillimi i shtypit duhej të shoqërohej patjetër me lindjen e lexuesit, e kjo e fundit me zhvillimet kulturore që nisnin nga qendra drejt periferisë.

Tek ky “*lajm i ljuumun*”, De Rada do të gjente të justifikuar edhe mundin personal në zhvillimin e periodikëve shqiptarë, si një mundësi e rritjes së ndërgjegjes kombëtare përmes lëvrimit të gjuhës shqipe. Duke bërë bilancin e punës së tij në këtë drejtim në letrën drejtuar De Gubernatis në vitin 1893, ai shkruante: “Kur ndërpreva i rraskapitur “Fjamurin e Arbrit” efektet e tij në tokën mëmë ishin tepër të dukshme; një gazetë shqiptare “Drita”

ishte krijuar në Konstandinopojë, një tjetër “Shqiptari” krijohej në Bukuresht. Në Athinë u krijua një Komitet për kultivimin e gjuhës shqipe dhe sulltani autorizonte bashkësinë brenda shteteve të tij të hapte shkolla në gjuhën shqipe.”⁹

Së dyti, në kontekstin kohor, Stambolli ishte qendra kryesore e shqiptarëve për krijimin e një alfabeti të unifikuar të gjuhës shqipe dhe i përhapjes së kulturës dhe diturisë brenda territorit shqiptar.

Tek “*Lajm i ljuumun*”, të cilit po i referohemi në këtë shkrim, De Rada nuk harron të na kujtojë përpjekjet e deriatëhershme për t’i gjetur shqipes shkronjat e duhura, por në të njëjtën kohë, ai vlerëson edhe përpjekjet e të tjerëve në këtë lëmë.

Ishte koha kur krahas përfshirjes në jetën politike, De Rada përpiqej për hartimin e një alfabeti e më pas të fjalorit të shqipes. Në përpjekjet për t’i dhënë shqipes “...një sistem grafik sa më të arsyeshëm dhe të pranueshëm”¹⁰ në periudhën e viteve 1834-1897, ai kishte paraqitur disa variante alfabetesh¹¹. Në vitin 1871 kishte botuar edhe një gramatikë të gjuhës shqipe “*e dalë me emrin e djalit të tij Zefit, por e hartuar prej tij*”.¹² Pak kohë më vonë nën kujdesin e tij do të zhvilloheshin dy kongreset gjuhësore shqiptare, në vitin 1895 në Koriliano Kalabro dhe në vitin 1897 në Lugro.¹³

Rilindësit kishin lidhje të forta, ndikime tek njëri-tjetri, por edhe kundërshti, të cilat u munduan që t’i përcillnin edhe përmes shkrimeve publicistike.

Dihet tashmë ndikimi letrar që ushtroi De Rada tek vepra e Naimit. Rilindësit përkrahën tezën e De Radës mbi prejardhjen pellazgjike të shqipes, ndërsa Samiu i çmonte shumë punët që ai bënte.

Në një letër dërguar nga Stambolli më 20 gusht 1881, “Burrit të Ndritur të Mëmëdheut” shkruhet: “Kemi kënduar këngët që ke mbledhurë e punërat që ke bërë Zotëri e Juaj në gjuhënë tënë për kombi tënë, dhe e kemi pëlqyer shumë, sikundër edhe gramatikënë e zotit të ndërqurë djalit të zotërisë sate Z. Xhuzep Radës, të cilit i gëzohemi edhe e përqafojmë vëllazërisht”.¹⁴

Kundërshtitë rridhnin ndonjëherë edhe nga moskuptimi i saktë i objektivave të Rilindjes nga De Rada. Mes kundërshtive ishin vlerësimet për alfabetin e Stambollit dhe debati për gjuhën letrare. Në letërkëmbimet e fillimit të viteve 1881, me vëllezërit Frashëri, duken qartë mosmarrëveshjet për krijimin e një alfabeti unik dhe të një gjuhe letrare të përbashkët. Përkundrajt vlerësimeve që Sami Frashëri i bënte alfabetit të Stambollit, De Rada e cilësonte atë “*të përzier me shkronja sllave, ndoshta me latine dhe greke*”.¹⁵

Të njëjtin qëndrim mbante edhe ndaj idesë së Sami Frashërit për një gjuhë letrare të përbashkët “*të pandarë e të njëjtë e të begatë*.”¹⁶ De Rada mendonte

se në përgjithësi gjuha shqipe ishte ruajtur më mirë në ngulimet arbëreshe se sa në atdheun mëmë.¹⁷ Në letrën drejtuar Kamardës më 25 qershor 1865, ai i shkruante: “Atdheu mëmë mbeti në duart e të huajve që e shkelen më këmbë dhe e shfrytëzuan: ne u strehuam në vende të mbrojtura dhe shpëtuan.”¹⁸

Por pavarësisht konsideratave ndonjëherë edhe kundërshtuese, De Rada duke mos iu larguar botë-kuptimit fetar të kultivuar në familje, e interpretoi si vullnet hyjnor dhe shpërblim nga Zoti punën e bërë për mbajtjen e Fiamurit të Arbërit, si dhe “daljen e periodikëve të tjerë shqiptarë e lejimin e mësimin të shqipes në rajonet që i përkisnin Turqisë.”¹⁹

Së treti, përsa i takon problemit kombëtar, De Rada i bashkohet synimeve politike të rilindësve të kohës, sigurimit të autonomisë të shqiptarëve brenda Perandorisë. Sipas tij shqiptarët pa asnjë përkrahje, duhet të gjejnë tek Perandoria Osmane mbështetjen e duhur, ashtu sikurse edhe kjo e fundit duhet të këtë besim tek shqiptarët.

Çështja kombëtare kishte filluar të propagandohej në Stamboll. Patriotët e njohur shqiptarë, nëpunës në Stamboll, por edhe funksionarë të lartë të Perandorisë me origjinë shqiptare, përpiqeshin për identitetin kombëtar dhe perspektivën e një shteti të ardhshëm.

De Rada dhe lëvizja kulturore e arbëreshëve të Italisë, të cilën ai e udhëhoqi për 50 vjet, ishte përpjekja më e rëndësishme kulturore dhe politike për Rilindjen Kombëtare të shqiptarëve në gjysmën e parë të shekullit XIX.

Në artikullin “*Laijm i ljuumun*” shfaqen pikëpamjet e De Radës, i cili i rikthehet edhe njëherë çështjes së synimeve grabitqare të shteteve fqinje ndaj tërësisë territoriale të Shqipërisë, të institucionalizuar përmes idesë së Federatës Ballkanike. “*Sot mbetet vetëm Greqia dhe ndonjë shoqe e saj me dëshira të*

këqija, e cila jo në ëndërr, por në zgjendërr punon për keq përmes gazetave të saj për testamentin e Turqisë”.

Këtë fakt e thekson biografi dhe studiuesi Jup Kastrati në monografinë “Jeronim de Rada-jeta dhe vepra”, ku vihet në dukje qasja analizuese dhe e zgjuar e De Radës për planet shoviniste të fqinjëve.²⁰

“*Laijm i ljuumun*” i botuar në “Fiamuri Arbërit” të datës së largët 30 tetor 1884, na ndërmend se këto gazeta, qarqet dhe sferat e kulturës që ato përfaqësonin, lindën dhe u rritën, si një nevojë idealiste e njerëzve që qëndronin prapa tyre.

Natyrshëm historiografia jonë i ka përcaktuar si rilindësit e vërtetë të këtij kombi, për vetë faktin se nuk e pretendonin domenin e kulturës. Është kjo arsyeja që ata nuk qenë përjashtues, por përkrahës të fuqishëm, të zellshëm deri në sakrificë ndaj njëri-tjetrit.

BIBLIOGRAFI:

- De Radës në 100 - vjetorin e vdekjes. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 2003, 425 f.
- BORIÇI, Hamit; MARKU, Mark: *Historia e shtypit shqiptar 1*, Shtëpia botuese “Ufo University Press”, Tiranë, 2007, 256 f.
- Buletin i Universitetit Shtetëror, Seria e Shkencave Shoqërore, Tiranë, nr. 1/ 1959, f.
- FEVZIU, Blendi: *Histori e shtypit shqiptar: 1848-2005*, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë, 2005, 188 f.
- “Fiamuri Arbërit” (La bandiera dell’Albania) nr. 12, datë 30 tetor 1884.
- KASTRATI, Jup: *Jeronim de Rada: jeta dhe veprat*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1979, 238 f.
- PETROTA, Gaetano: Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare, Shtëpia botuese “Almera”, Tiranë, 2008, 624 f.
- OSMANI, Tomor: *Udha e shkronjave shqipe*, Shtëpia botuese “Idromeno”, Shkodër, 1999, 576 f.

■ **REFERENCAT:** 1) Shih: “Ringjallja e shtypit të vërtetë shqiptar i takon edhe njëherë protagonistit të parë të tij, Jeronim de Radës. Arbëreshi i parë tashmë i famshëm, në moshën 69-vjeçare, filloi botimin e gazetës së dytë të jetës së tij, asaj më kryesore, “Fiamuri Arbërit” (La bandiera dell’Albania).” Fevziu, Blendi: *Histori e shtypit shqiptar: 1848-2005*, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë, 2005, f. 16. 2) “Fiamuri Arbërit” (La bandiera dell’Albania) nr. 12, datë 30 tetor 1884. 3) Kostallari, Androkli: “*Rreth pikëpamjeve të Jeronim de Radës për formimin e gjuhës letrare të kombit shqiptar*”, “De Radës në 100- vjetorin e vdekjes”, Akademia e Shkencave të Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2003, f. 212. 4) Boriçi, Hamit; Marku, Mark: *Historia e shtypit shqiptar 1*, Shtëpia botuese “Ufo University Press”, Tiranë, 2007, f. 91. 5) Po aty, f. 91. 6) Boriçi, Hamit; Marku, Mark: *Historia e shtypit shqiptar 1*, Shtëpia botuese “Ufo University Press”, Tiranë 2007, f. 91. Po aty, f. 92. 8) Po aty, f. 30 9) Skiro, Xhuzep: “*Shqipëria ideale e Jeronim De Radës*”, “De Radës në 100- vjetorin e vdekjes”, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2003, f. 108 10) Osmani, Tomor: *Udha e shkronjave shqipe*, Shtëpia botuese “Idromeno”, Shkodër, 1999, f. 320-338. 12) Po aty, f. 254. 13) Petrotta, Gaetano: Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare, Shtëpia botuese “Almera”, Tiranë, 2008, f. 253. 14) Kastrati, Jup: *Zef De Rada dhe gramatika e tij*. Në: Buletin i Universitetit Shtetëror, Seria e Shkencave Shoqërore, Tiranë, nr. 1/ 1959, f. 96. 15) Osmani, Tomor: *Udha e shkronjave shqipe*, Shtëpia botuese “Idromeno”, Shkodër, 1999, f. 337. 16) Kostallari, Androkli: *Rreth pikëpamjeve të Jeronim de Radës për formimin e gjuhës letrare të kombit shqiptar*, De Rada në 100-vjetorin e vdekjes. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2003, f. 208. 17) Po aty, f.208. 18) Po aty, f. 204. 19) Skiro, Xhuzep: “*Shqipëria ideale e Jeronim De Radës*”, “De Radës në 100- vjetorin e vdekjes”, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2003, f. 112. 20) Shih: “Duke njohur synimet grabitqare të shovinistëve fqinjë, që kishin për qëllim ta copëtonin atdheun tonë, De Rada i qartë politikisht dhe konsequent në çështjen e ruajtjes së tërësisë tokësore shqiptare, nënvizonte faktin e njohur historikisht, se Federata Ballkanike bënte plane të këqija në dëm të interesave kombëtare. “Ideja e parë e Federatës Ballkanike lindi në mendjen gënjeshtare të Greqisë. Këtë ide e përkrahin edhe të përkohshmet e Italisë. Zemrat tona janë të helmua shumë nga një qëndrim kaq armiqësor””Kastrati, Jup: *Jeronim de Rada: jeta dhe veprat*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1979.



SI DUHET TË REAGUJME NDAJ PROVOKIMEVE?

— Naim Driaj —

Të gjithë ne jemi dëshmitarë, se çfarë shkruhet në gazetat e përditshme për ne, për gjithë myslimanët, e dimë se çfarë flitet në televizionet tona. Të gjithëve na dhemb zemra për situatën në të cilën ndodhemi. Por ne duhet t'i lutemi Allahut që ta përmirësojë gjendjen tonë. O Zot bashkoi zemrat tona, o Zot mos fut përçarje në zemrat tona, o Zot përmirësojë gjendjen tonë”.

Çdo besimtarë ndihet keq, kur shikon se e keqja po triumfon dhe e drejta nuk duket as kund. Nuk është habi ta ndjesh diçka të tillë, sepse këtë e kanë ndjerë njerëz më të mirë se ne, e kanë ndjerë profetët e Zotit bashkë me

besimtarët. Aq ngushtë e kanë parë veten sa që kanë thënë:

“O Zot kur do të vijë ndihma Jote”! Allahu (xh.sh) thotë: “Ndihma e Zotit është shumë afër”.¹ dhe pastaj ka ardhur ndihma e Zotit.

Ky umet nuk mund të zhduket kurrë. Ai mund të dobësohet dhe të pasojë disfata, por përsëri forcohet dhe kthehet edhe më i fortë se ç’ishte më parë. Kjo pasi ky umet mban në tokë fjalën e fundit të Allahut, Kuranin. Allahu (xh. sh) thotë: “Vërtet, Ne e kemi shpallur Kuranin

1. Bekare, 214

dhe Ne do ta ruajmë atë me siguri”.² “Ne do t’i ndihmojmë të dërguarit Tanë dhe besimtarët.”

³ Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Gjithsesi kjo fe do të arrijë aty ku ka arritur nata dhe dita.

Feja islame ka kaluar shumë kriza qysh nga lindja e saj, por pas çdo krize ka dalë edhe më e fortë se ç’ ishte më parë. Këtë na e dëshmon vetë historia. Me vdekjen e Hatixhes dhe Ebu Talibit, dy njerëzit të cilët e përkrahnin dhe e mbrojnë më tepër Pejgamberin (a.s) torturat dhe përndjekjet ndaj myslimanëve u shtuan edhe më shumë. Por, në këtë kohë Allahu i madhëruar i urdhëroi myslimanët të emigronin për në Medine, ku shpëtuan nga politeistët e Mekës.

Në ditët e sotme ajo që na gëzon shumë neve si myslimanë është rizgjimi i rinisë islame, të cilën e shohim në çdo vend.

Si duhet të reagojmë ndaj provokimeve? Reagimi ynë më i mirë është reagimi që na ka mësuar Allahu (xh.sh) në suren El-Asr e cila ka zbritur në Meke dhe ka tre ajete.

1- Pasha kohën! Koha-ky thesar kaq i çmuar që shumëkush nuk ia di vlerën është problemi më i madh që duhet të preokupojë çdo mysliman në ditët e sotme.

2- Me të vërtetë, njeriu është në hubje,

3- Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë një-tjetrit durimin.⁴

Një nga dijetarët e islamit ka thënë: “Sikur myslimanët të meditonin dhe të thelloheshin në kuptimin e kësaj sureje do ju mjaftonte atyre”.

Imam Shafiu ka thënë: “ Sikur njerëzve mos t’u kishte zbritur sure tjetër përveç kësaj sureje do ju mjaftonte atyre”.

1.Reagimi ynë më i mirë është duke njohur, mësuar dhe kuptuar fenë tonë siç duhet. Mys-

limani duhet të pajiset me dituri të saktë nga e cila rrjedh edhe besimi i saktë. Hapi i parë i reagimit është me dituri fetare dhe shkencore.

2. Duhet të punojmë me diturinë sepse dituria pa punë nuk ka vlerë. Duhet të bëhemi shembull në çdo punë. Duhet që ta ringjallim praktikisht jetën e Pejgamberit (a.s) në moral, sjellje, komunikim durim etj. Ky do të ishte reagimi ynë më i mirë i mundshëm.

3. Duhet ti ftojme njerëzit në fenë e Allahut duke i këshilluar të vërtetën. Atëherë do të ndryshojë gjendja jonë. Energjinë dhe pasurinë që kemi duhet ta përdorim në rrugë të Allahut.

Tek Imam Maliku (r.a) ka ardhur një delegacion nga Iraku dhe i kanë thënë: “O Imam! në vendin ku ne jetojmë janë përhapur shumë besëtytni dhe shumë gjëra që janë në kundërshtim me islamin” Si të veprojmë? Imam Maliku (r.a) nuk u ka thënë atyre merruni me ata mos i lini pa përgjigje por u ka thënë: Përhapeni synetin e Profetit (a.s) se ata do të dështojnë.

Allahu i Lartësuar për Profetët thotë: “Ata shpejtonin në vepra të mira”.⁵ Dhe duke folur për cilësitë e robërve të Tij të devotshëm Allahu (xh.sh) thotë: “Ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët”.⁶

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush thërret për në udhëzim, ai do të ketë shpërblimin e të gjithë atyre që do ta ndjekin, duke mos u pakësuar atyre asgjë nga shpërblimet që meritojnë. E ai që thërret për në humbje, ai do të ketë gjynahet e të gjithë atyre që do ta ndjekin, duke mos u pakësuar atyre asgjë nga gjynahet që meritojnë”.⁷

4. Duhet të bëjmë durim në të gjitha aspektet si p.sh ndaj akuzave që na bëhen etj.

Allahu (xh.sh) thotë: “Përfundimi (i mirë) është për (të devotshmit) ato që ruhen nga të këqijat”.⁸

2. Hixhr, 9

3. Gafir, 51

4. Sa më shumë që koha kalon, aq më tepër njeriu i afrohet humbjes, nëse nuk plotëson katër kushte që kanë të bëjnë me përsosjen e tij personale dhe përsosjen e të tjerëve: besimi tek Allahu dhe te gjithëcka që Ai ka urdhëruar të besohet, kryerja e veprave të mira, qofshin këto vepra fizike apo shpirtërore, këshillimi i të tjerëve me këtë të vërtetë dhe këshillimi i tyre që të durojnë në përpjekjen e tyre për t’iu përmbytur urdhrave të Allahut dhe për të duruar sprovat e dhembshme dhe të vështira që mund të ketë paracaktuar Ai.

5. Enbija, 90

6. Mu’minun, 61

7. Muslimi

8. Kasas, 83

6 ARSYE TË VLEFSHME PËRSE DUHET TË KUFIZONI

Karbohidratet

Karbohidratet janë pjesë ushqyes të rëndësishëm për mbarëvajtjen e funksioneve në organizëm

Ato i gjejmë në formën e sheqernave, fibrave dhe niseshtejesë natyrale.

Karbohidratet i japin organizmit glukozë e cila transformohet në energji që shfrytëzohet në maksimum nga i gjithë organizmi, nga koka tek këmbët.

Nga ana tjetër, sasia e konsumuar e karbohidrateve është e një rëndësie kyce për shëndetin.

SASIA E DUHUR DITORE E KARBOHIDRATEVE PËR ORGANIZMIN

Ekspertët thonë se nëse njeriu kryen një jetë aktive, atëherë duhet të sigurohet që 40% e kalorive të marra në ditë të jenë karbohidrate, 30% proteinë dhe 30% yndyrna.

Në përgjithësi, 500-800 kalori duhet të vijnë nga një ose disa burime karbohidratesh.

Kjo përkthehet në 150-200 gramë karbohidrate në ditë.

Sasia e karbohidrateve ditore është në varësi edhe të llojit të përzgjedhur.

Për shembull nëse jeni tifozë të orizit keni përballë dy alternativa.

Orizi i bardhë konvertohet në sheqer direkt sapo hyn në organizëm ndërsa orizi kaf është i pasur me

fibër që ngadalëson përthithjen e karbohidrateve.

Njeriu mund të konsumojë një sasi të ulët por sërish të shëndetshme të karbohidrateve pa vënë në rrezik shëndetin.

Sasia më e ulët dhe e lejuar e karbohidrateve është 50 gramë në ditë. Kjo sasi plotësohet mirë në një racion tërshërë me një gjysëm banane.

Nëse ju konsumoni më pak se 50 gramë, atëherë do të pësoni rënie të ndieshme të energjisë në trup.

BURIMET E MIRA DHE TË KËQJA TË KARBOHIDRATEVE

Burimet më të shëndetshme të karbohidrateve janë ushqime të papërpunuara siç janë drithërat e plota, frutat, perimet dhe bishtajoret, si thjerrëzat, fasulet.

Ato e furnizojnë trupin me vitamina, minerale dhe fibër.


Burimet më të pasëndetshme të karbohidrateve janë: buka e bardhë, ëmbëlsirat, pijet e gazuara dhe çdo ushqim tjetër i përpunuar.

Këto karbohidrate nxisin shtimin në peshë, diabetin dhe sëmundjet e zemrës.

6 ARSYE TË VLEFSHME PËRSE DUHET TË KUFIZONI KARBOHIDRATET JO TË SHËNDETSHME

Studiuesit e kësaj teme thonë se kufizimi i karbohidrateve jo të shëndetshme, të cilat gjenden tek ushqimet e papërpunuara dhe përgjithësisht nuk ofrojnë fibër, e ndihmon njeriun ta ketë më të lehtë të:

- humbasë kilogramët e tepërt
- ketë energji afatgjatë
- ketë muskuj më të fortë,
- jetë i/e ngopur më gjatë e të mos ketë fryrje të stomakut,
- jetë më pak i rrezikuar ndaj diabetit
- ketë një zemër më të fortë.





LIDHJA MES ARTRITIT DHE OSTEOPOROZËS TEK GRATË

Në të gjithë botën 1 në 3 gra dhe 1 në 5 burra preken nga ndonjë sëmundje e kockave apo lloje të artritit.

Kjo i bën gratë numrin më të madh të personave të prekur nga këto probleme.

Sipas ekspertëve tek gratë shëndeti i kockave mund të jetë shumë delikat për shkak të ndryshimeve që ndodhin në trup.

Ndër kockat që preken dhe dobësohen më shpejt janë ato të qafës, kyçeve dhe shtyllës kurrizore.

Kjo mund të shkaktojë dhimbje të vazhdueshme mesi, qafe, ndryshime në strukturën e trupit apo vështirësi në lëvizje.

Shkaktar për këtë dhimbje mund të jenë një mori arsyesh të cilat dëmtojnë përkohësisht ose përfundimisht kockat tuaja. Dy prej tyre janë: artriti dhe osteoporoza.

ÇFARË ËSHTË ARTRITI?

Artriti është një term që grupon më shumë se 100 sëmundje dhe çrregullime të ndryshme autoimmune që shkaktojnë dhimbje, ngurtësim dhe enjtje të kyçeve dhe nyjeve.

Sëmundjet autoimmune zakonisht kanë të bëjnë me një sistem imunitar që sulmon organizmin.

Një sulm i tillë kryhet nga rruazat e bardha të gjakut që në vend se të sulmojnë bakteret dhe infeksionet, godasin indet e shëndetshme rreth kyçeve.

Format më të përhapura të artriti janë: osteoartriti, reumatizma dhe fibromialgja.

Secila prej sëmundjeve në fjalë ka shenja dhe simptoma karakteristike por që në disa raste ndërthuren me njëra tjetrën.

ÇFARË ËSHTË OSTEOPOROZA?

Osteoporoza është një sëmundje, simptomat e së cilës shfaqen atëherë kur është shumë vonë.

Kjo është një nga arsyet më të rëndësishme përse duhet të rrisni dozat e kalçiumit për të shmangur komplikimet në fazat e tjera të jetës.

Osteoporoza njihet si sëmundje e heshtur.

Ajo gërren kockat duke shkaktuar një dëm të pariparueshëm.

Dendësia kockore pakësohet ndjeshëm, ndërkohë që njeriu është i prirur të pësojë fraktura të shumta për shkak të brishtësisë së kockave.

Këto fraktura ndodhin kryesisht në kyçe dhe në ije.

Megjithatë, me ushqimet e duhura e sidomos të pasura me kalçium ju mund ta shmangni atë.

Shkaktarët e kësaj sëmundjeje janë: plakja, mbi-pesha, faktorët genetikë dhe nivelet e ulta të kalçiumit.


Gratë janë katër herë më të rrezikuara nga kjo sëmundje se burrat.

CILA ËSHTË LIDHJA MES ARTRITIT DHE OSTEOPOROZËS?

Ekspertët e fushës thonë se këto dy sëmundje lidhen ngushtë me njëra tjetrën, sepse për bazë kanë inflamacionin i cili në mënyrë të pashmangshme kërcënon shëndetin e kockave.

Nga ana tjetër, njerëzit që marrin medikamente kundër artritit mund të përballen me një rrezik të shtuar të predispozitës së osteoporozës.

Steoridët janë disa medikamente që rekomandohen kundër artritit dhe reumatizmit të cilat hollojnë kockat, ndërsa ilaçe të tjera për mbrojtjen e stomakut mund të ulin përthithjen e kalçiumit, i cili është thelbësor për fortësinë dhe dendësinë e tyre.





KUR MAKINAT ELEKTRIKE DO TË KUSHTOJNË SA ATO STANDARDE?

Nuk do të ketë shumë arsye për të blerë një makinë me një motor me djegie të brendshme pas vitit 2025,” tha një nga analistët e UBS-së.

Prodhimi i makinave elektrike do të kushtojë njësoj si prodhimi i makinave me motorë me djegie të brendshme deri në vitin 2024, gjë që do të përshpejtojë ndjeshëm kalimin në përdorimin e makinave me bateri, sipas një studimi të ri nga banka e investimeve UBS.

Kërkimi që u krye u bazua në analizën e baterive nga shtatë prodhuesit më të mëdhenj. Ai tregoi se çmimi i baterisë është midis një të katërtës dhe dy të pestave të kostos së të gjithë automjetit dhe ato prodhohen pothuajse ekskluzivisht nga kompanitë e Azisë Lindore si Koreja e Jugut LG Chem, Panasonicu japonez dhe rivali kinez CATL.


Rezultatet e sondazhit tregojnë se kostot e baterisë pritet të bien nën 100 dollarë për kilovat orë deri në vitin 2022, gjë që mund të jetë moment historik në industrinë e automobilave, sepse pas kësaj mund të presim që prodhuesit të zhvendosin shumë nga burimet e tyre në prodhimin e makinave elektrike.

“Në të vërtetë nuk do të ketë shumë arsye për të blerë një makinë me një motor me djegie të brendshme pas vitit 2025,” tha një nga analistët e UBS-së.

Ndonëse entuziastët e automjeteve elektrike kohët e fundit kanë argumentuar se kostoja totale e përdorimit të makinave elektrike është tashmë e barabartë ose edhe më e ulët se ajo e automjeteve klasike për shkak të çmimeve më të ulëta të karburantit dhe kostove më të ulëta të mirëmbajtjes, kostot fillestare më të larta akoma sprapsin një numër të madh të konsumatorëve.

Për shembull, Volksëagen Golf i ri kushton rreth 22,400 euro, ndërsa ID-3, automjeti i parë elektrik i Golf-it për tregun masiv, do të kushtojë mbi 33,000 euro.

Sidoqoftë, nëse parashikimet nga ky studim rezultojnë të sakta, shpejtësia e kalimit në automjete elektrike pas vitit 2024 mund të jetë dukshëm më e lartë sesa optimistët më të mëdhenj parashikuan dhjetë vjet më parë.





TELESKOPI I NASA-S ZBULON PRANINË E UJIT NË HËNË

Njëmbëdhjetë vjet më parë, tri anije kozmike ndryshuan përgjithmonë pamjen tonë për Hënën.

Të dhënat e mbledhura nga udhëtarët robotikë treguan se sateliti i vetëm natyror i Tokës nuk ishte një shkretëtirë e thatë, me pluhur, siç besonim prej kohësh.

Anija kozmike morën treguesin kimik të ujit. Shkencëtarët nuk mund të ndanin treguesin kimik për të thënë përfundimisht se sa ishte uji "molekular", lëndët që ne i njohim si H₂O dhe sa ishte hidroksil, një molekulë që është një atom hidrogjeni më pak se të bëhet ujë.

Zbulimet në vitin 2009 bënë që shkencëtarët të dyshonin se shumica e "ujit" të hënës ishte hidroksil, sepse është termikisht më i qëndrueshëm se uji molekular.

Të hënën, dy studime, të botuara në revistën Nature Astronomy, rishkruajnë edhe një herë historinë e ujit të hënës.

Në studimin e parë, shkencëtarët ekzaminuan fytyrën e hënës në rreze infra të kuqe. Ata përcaktuan se është kryesisht H₂O që ekziston në sipërfaqen hënore, në vend të hidroksil.

"Zbulimi është shumë unik për ujin molekular", thotë Shuai Li, një shkencëtar planetar në Universitetin e Hawaii dhe bashkautor në një nga studimet e reja.

Prania e ujit u zbulua në sipërfaqen e ndriçuar të hënës, ku molekula do të ekspozoheshin ndaj rrezatimit UV dhe ku temperaturat luhaten në mënyrë dramatike midis agimit, mesditës dhe muzgut. Është disi e habitshme, por është përfundimtare.

"Bazuar në njohuritë tona, nuk mund të jetë asgjë tjetër", thotë Li.

Li ka kërkuar për ujë në sipërfaqen e Hënës për vite me radhë dhe ishte pjesë e një ekipi shkencëtarësh të përfshirë në zbulimin e akullit të ujit në polet e hënës në 2018.

Akulli ishte bllokuar në rajone të hijezuara përgjithmonë të sipërfaqes hënore që kurrë nuk marrin rrezet e diellit. Në studimin e dytë, një ekip tjetër studiuesish sugjerojnë që akulli i ujit mund të jetë edhe më i përhapur, ekzistues në hije mbi sipërfaqen e hënës.

Një nga çelësat për zbulimin ishte Observatori Stratosferik për Astronominë Infra të Kuqe, ose SOFIA, një Boeing 747 i porositur me një teleskop të instaluar në pjesën e pasme të trupit të saj të avionit.

Avioni, i operuar nga NASA dhe DLR, Qendra Hapësinore e Gjermanisë, fluturon me gati 43,000 metra. Gjatë fluturimit, ai hap një çelës në pjesën e pasme, duke drejtuar teleskopin e tij drejt qiellit dhe duke studiuar kozmosin në dritën infra të kuqe.

Duke e kthyer teleskopin e SOFIA-s në Hënë në vitin 2018, ekipi hulumtues zgjodhi dy sipërfaqe të ndriçuara nga dielli: njëra në gjerësinë gjeografike të lartë afër kraterit Clavius dhe një tjetër që ishte më afër ekuatorit.

Uji përbëhet nga dy atome hidrogjeni dhe një atom oksigjeni. Kur drita godet ujin molekular, atomet thithin energjinë, përkulen pak dhe lëshojnë dritën përsëri. Drita e emetuar është shumë specifike për ujin molekular, dhe nuk ka asnjë material tjetër që shfaq një tregues të ngjashëm të dritës.

Prania e ujit është zbuluar rreth kraterit Clavius dhe shkencëtari Li thotë se duhet të përpunohen disa mijëra kilogram regolit hënor për të marrë 1 litër ujë. Por mënyra se si krijon dhe mirëmban ujin në sipërfaqen e tij është një enigmë e re.

Sipërfaqja hënore është e prirë për bombardime nga mikro-meteorët, rrezet kozmike dhe era diellore, dhe ekipi sugjeron që uji ka gjasa të jetë bllokuar nga mjedisi ekstrem.



Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË

“Thuaju (o Muhamed):
“Nëse ju e doni Allahun,
atëherë më ndiqni mua,
që Allahu t’ju dojë
dhe t’jua falë gjynahet!
Allahu është Falës i Madh
dhe Mëshirëplotë”.

(Al Imran, 31)